



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

ÓMENAXHIMI I BURIMEVE UJOREÓ



Publik: Ky dokument është pronësi e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ai përmban informacion publik dhe qëllimi i tij është transparenca tek palët e interesuara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin nr. 154/2014, óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, specifikisht neni 34, pika (b), sikurse promovimi i përmirësimeve në sektorin publik, në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi dhe menaxhimin e shëndetshëm të 3 E-ve. Çdo citim i këtij dokumenti të bëhet referuar burimit të tij zyrtar.



P Ë R M B A J T J A

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT	4
1.1 Konteksti i problemit social.....	4
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës.....	5
1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë.....	6
2. SUBJEKTET NËN AUDITIM	7
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	7
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	14
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	16
2.4 Pësja në buxhet.....	18
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia.....	23
2.6 Skema e analizës së programit auditues.....	24
2.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore.....	25
3. DETAJET E AUDITIMIT	26
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	26
3.2 Objektivi i auditimit.....	28
3.3 Pyetjet e auditimit.....	28
3.4 Fushëveprimi i auditimit.....	28
4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE.....	29
A ka qenë efiçiente veprimtaria e institucioneve përgjegjëse drejt menaxhimit të integruar të burimeve ujore për periudhën 2018-2021?.....	29
4.1 A ekziston një kuadër ligjor dhe rregullator i plotë dhe me ndarje të qarta të roleve dhe përgjegjësi mes aktorëve të përfshirë?	29
4.1.1 A kanë hartuar dhe miratuar institucionet përgjegjëse politika të duhura për menaxhimin e burimeve ujore, sipas roleve përkatëse?.....	29
4.1.2 A janë aktet nënligjore të përditësuara dhe në koherencë me kuadrin ligjor kryesor për menaxhimin e burimeve ujore?.....	35
4.2 A është mbështetur veprimtaria e institucioneve përgjegjëse me buxhete të mjaftueshme?.....	43
4.2.1 A është siguruar mbështetja e duhur financiare nga buxheti i shtetit në funksion të objektivave përkatëse?.....	43
4.2.2 A i kanë shërbyer të ardhurat dytësore të krijuara nga AMBU, përmirësimit të menaxhimit të ujit?.....	50
4.3 A kanë garantuar institucionet përgjegjëse mbikëqyrje të plotë ndaj përdoruesve të burimeve ujore?.....	59
4.3.1 A janë koordinuar midis tyre institucionet përgjegjëse lidhur me procesin e monitorimit të burimeve ujore?.....	59
4.3.2 A kanë në dispozicion strukturat e kontrollit dhe inspektimit të burimeve ujore logjistikën e nevojshme dhe burimet njerëzore dhe a janë koordinuar midis tyre për realizimin e detyrave kontrolluese dhe inspektuese?.....	64
5. PËRMBLEDHJE.....	79
6. GRUPI I PUNËS.....	81
7. ANEKSI.....	82

LISTA E SHKURTIMEVE

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
ZABU	Zyra e Administrimit të Burimeve Ujore
SKMBIU	Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore
PMBU	Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor
MIBU	Menaxhimi i integruar i burimeve ujore
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
3 E	Efektivitet, Ekonomicitet, Eficiencë
PKMM	Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit
RGJM	Raporti i Gjendjes në Mjedis


1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT

1.1 KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL

Uji është thelbësor për zhvillimin ekonomik, shëndetin human dhe mjedisin. Qeveritë kudo në botë janë duke hasur sfida të mëdha në menaxhimin efektiv të burimeve ujore. Problemet janë të llojeve të ndryshme dhe komplekse, krahas aksesit të ujit me cilësi të mirë, konkurrenca për përdorime dhe përdorues të ndryshëm të ujit është duke u rritur kudo në botë. Veç kësaj, kërkohen investime të mëdha për të mirëmbajtur dhe përmirësuar infrastrukturën e ujit¹.

Uji është një nga substancat më të zakonshme në tokë duke qenë se ai mbulon 71 % të sipërfaqes së Tokës. Siç tregohet dhe në Grafikon nr. 1, 96.5 % e sasisë totale të ujit gjendet në dete dhe oqeanet, 1.7 % në ujëra nëntokësore, 1.7 % në akullnaja dhe akuj të tjerë në Antarktidë dhe Groenlandë dhe pjesa tjetër në lumenj e liqene, si dhe një sasi shumë e vogël prej 0.001 % janë avujt e ajrit në re.²

Grafiku nr. 1 Shpërndarja e ujit në Tokë



Burimi: MOOC, Auditing Water Issues SAI of Estonia

Uji është burim natyror strategjik për Shqipërinë. Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore (MIBU) përkufizohet si një proces që nxit zhvillimin dhe menaxhimin e bashkërenduar të ujit, tokës dhe burimeve përkatëse, për të rritur në maksimum mirëqenien ekonomike dhe sociale, në mënyrë të barabartë dhe pa kompromentuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve jetësore. Shqipëria është e pasur me burime ujore, me tetë lumenj të mëdhenj, tre liqene të lundrueshme ndërkufitare, një numër të madh dhe të çmuar ligatinash si dhe burime nënujore të bollshme. Megjithëse burimet ujore janë shpërndarë në të gjithë vendin, shpërndarja e tyre përgjatë territorit nuk është në mënyrë të njëtrajtshme. Shqipëria konsiderohet si një vend me ujë të bollshëm dhe me burime ujore të rinovueshme që llogariten afërsisht deri në 41.7 km³/vit, nga të cilat 65% burojnë brenda vendit dhe 30% janë ujëra nëntokësore. Burimet e ujit përbëhen nga ujërat sipërfaqësorë (lumenjtë) dhe akuiferët (ujërat nëntokësorë). Në rastin e Shqipërisë, burimet ujore sipërfaqësore brenda vendit rriten nga flukset hyrëse nga vendet fqinje. Ujërat sipërfaqësorë përfshijnë lumenjtë, liqenet, rezervuarët dhe lagunat. Rreth 150 përrenj të vegjël formojnë tetë lumenj të mëdhenj në Shqipëri.

¹ https://www.oecd-ilibrary.org/environment/oecd-studies-on-water_22245081

² <https://sisu.ut.ee/water/book/export/html/19738>

Këto përfshijnë Bunën (41 km), Drinin (285 km), Matin (115 km), Ishmin (74 km), Erzenin (109 km), Shkumbinin (181 km), Semanin (281 km), dhe Vjosën (272 km), të cilët rrjedhin në drejtim jug-lindje-veri-perëndim në drejtim të detit Adriatik. Lumenjtë kanë një rrjedhë stinore të parregullt të cilat kulmojnë në dimër ose në fillim të vjeshtës. Tre liqene të mëdhenj dhe 247 liqene të vegjël mbulojnë gjithsej 4% të territorit të vendit. Tre liqenet e mëdha (Ohri, Prespa dhe Shkodra) janë ndërkufitare. Liqenet ndikohen nga ndryshime të forta natyrore, dhe nga ndërhyrjet intensive dhe të pakontrolluara të njeriut. Liqeni i Ohrit dhe liqeni i Prespës janë liqenet më të mëdha tektonike në Evropë dhe i përkasin pellgut ujëmbledhës të Drinit, i cili derdhet në detin Adriatik. Sipërfaqja e liqenit të Ohrit është 358km², nga të cilat 249km² i përkasin Maqedonisë dhe 109km² Shqipërisë. Vetë liqeni ka një gjatësi maksimale prej rreth 30km, me thellësi maksimale prej 289m dhe një thellësi mesatare prej 164m. Rajoni i Prespës përfshin dy liqene të ndërlidhura ndërmjet tyre: Prespa e Vogël dhe Prespa e Madhe të cilat janë rrethuar nga ekosisteme malore. Të dy liqenet së bashku formojnë pjesën më të thellë të një baseni të brendshëm malor i cili nuk ka një pikë rrjedhjeje natyrore (burim) në sipërfaqe. Dërdhja e ujit bëhet vetëm nëpërmjet një lidhje nëntokësore nga Liqeni i Madh i Prespës drejt Liqenit të Ohrit. Sipërfaqja aktuale e të dy liqeneve është afërsisht 301km². Shqipëria ka gjithashtu rreth 626 rezervuarë të cilët janë ndërtuar më së shumti përgjatë lumenjve, dhe që kanë një kapacitet grumbullues prej 5.6 miliardë m³ që përdoret për ujtje, mbrojtje kundër përmbytjeve dhe prodhimin e energjisë elektrike. Afërsisht 97% e prodhimit të përgjithshëm të brendshëm të energjisë elektrike prodhohet nga hidrocentralet përgjatë lumenjve të Drinit, Matit dhe Bistricës. 50% e tokës bujqësore që prodhon rreth 80% të produktit bujqësor në vend ujitet nga këto burime ujore.³

Cilësia e ujit

Cilësia e ujit i referohet karakteristikave kimike, fizike, biologjike dhe radiologjike të ujit. Cilësia përshkruan gjendjen e ujit duke marrë parasysh speciet që gjenden brenda tij dhe/ose çdo nevojë apo qëllim njerëzor. Shumë qeveri (përfshirë dhe ajo shqiptare) kanë vendosur standarde të cilësisë së ujit kundrejt të cilave mund të vlerësohet përputhshmëria. Standardet më të zakonshme të përdorura për të vlerësuar cilësinë e ujit kanë të bëjnë me shëndetin e ekosistemeve, sigurinë e kontaktit me njerëzit dhe ujit të pijshëm. Standardet e cilësisë së ujit shpesh vendosen duke marrë parasysh përdorimin e ujit (konsumin njerëzor, përdorimin industrial) dhe veçmas për ujin e ambientit (lumenj dhe liqene). Programet kombëtare të monitorimit mjedisor zakonisht mbulojnë monitorimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.⁴

Në Kapitullin 27 óMjedisi dhe ndryshimet klimatikeó, Progres Raporti i BE-së për Shqipërinë ndalet dhe evidenton disa problematika që lidhen me menaxhimin e ujërave. Edhe pse citohet se Shqipëria ka treguar përmirësime në këtë drejtim, progres i limituar është bërë sa i përket përafrimit të legjislacionit vendas me óacquisó në drejtim të menaxhimit të ujërave. Rekomandimet e Progres Raportit të 2020 kanë ngelur ende në fuqi në Progres Raportin e 2021 ku në veçanti theksohet se Shqipëria duhet të harmonizojë më tej kuadrin ligjor me direktivat e BE-së, të përforcoje dhe të bëjë përpjekje më të mëdha sa i përket përmirësimit të cilësisë së ujërave si dhe të fuqizojë buxhetin në drejtim të agjencive dhe strukturave përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore.⁵

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion

³ Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, fq. 15,20,24,25.

⁴ <https://sisu.ut.ee/water/book/12-water-pollution>

⁵ COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT Albania 2021 Report

shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficiensa dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

Në linjë me prioritetet e përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022 për auditimet e performancës, si: *fokusimi në çështje makro-ekonomike, krahas atyre mikro-ekonomike apo fokusimi në auditime procesi më shumë sesa auditime institucionit*⁶, etj., KLSH ndërmori auditimin e Menaxhimi i burimeve ujore. Si një ndër çështjet dhe problematikat kryesore me të cilat vendi ynë është ballafaquar në vitet e fundit, KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me menaxhimin e burimeve ujore nga institucionet përgjegjëse sa i përket veprave, aktiviteteve dhe subjekteve private apo edhe publike të cilat përdorin burimet ujore për qëllime të ndryshme, si dhe të japë rekomandime për të përmirësuar situatën aty ku është e mundur.

1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë

Lidhur me tematika deri diku të ngjashme, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka realizuar disa auditime të ndryshme përgjatë viteve si më poshtë:

- Auditim performance me temë *ÓPërmbytjet në Parandalimi, Mbrojtja, Gadishëmria* bazuar në programin e auditimit nr. 786/6, datë 12.10.2018, i cili konkludoi me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 224 datë 20.12.2018. Ky auditim u ushtrua në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile.
- Auditim performance me temë *ÓNdodhja akustike* bazuar në programin e auditimit nr.1431/8, datë 12.03.2019, i cili konkludoi me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.31 datë 30.07.2019. Ky auditim u ushtrua në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në Bashkinë Tiranë;
- Auditim performance me temë *ÓCilësia e ajrit* bazuar në programin e auditimit nr. 682/4, datë 06.10.2017, i cili konkludoi me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.203, datë 29/12/2017. Ky auditim u ushtrua në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, dhe në Institutin e Shëndetit Publik.
- Auditim performance me temë *ÓCilësia e ujit të pijshëm për konsumatorët* bazuar në programin e auditimit nr. 93/2, datë 25.04.2018, i cili konkludoi me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 242, Datë 21/12/2018. Ky auditim u ushtrua në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare e Ujësjetës Kanalizime, Ndërmarrjet e Ujësjetës Kanalizime Sh.A. të shpërndara në 12 qarqet: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Institutin e Shëndetit Publik si dhe strukturat rajonale të shëndetit publik të shpërndara në 12 qarqet: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë

⁶ Strategjia e Zhvillimit Institucional 2018-2022 KLSH, fq. 39

Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë; Bashkitë në 12 qarqet: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë.

- Auditim performance me temë ôNdodja e deteveô bazuar në programin e auditimit nr. 442/2, datë 21.10.2019. Ky auditim u ushtrua në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit; Agjencinë Kombëtare të Bregdetit me katër Drejtoritë Rajonale, që monitoron bregdetet në Velipojë, Shëngjin, Tale (Lezhë), Gjiri i Lalzit, Durrës, Golem, Vlorë, Dhërmi, Himarë, Borsh, Sarandë; Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me Drejtoritë Rajonale Mjedisore në 12 qarqet e vendit Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), është krijuar me VKM nr. 221, datë 26.4.2018 ôPër organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujoreô (ndryshuar me VKM nr. 361, datë 6.5.2020) bazuar në Ligjin nr. 111/2012, ôPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreô, i ndryshuar. Misioni i AMBU është mirëqeverisja e burimeve ujore me qëllim përmbushjen e të gjitha nevojave jetësore, duke mbajtur në vëmendje qëndrueshmërinë e ekosistemeve, duke nxitur konkurrueshmërinë e përdorimeve dhe prioritizimin drejt përfitueshmërisë ekonomike. AMBU organizohet në nivel qendror dhe në nivel baseni ujqor nëpërmjet Zyrrave të Administrimit të Baseneve Ujore (ZABU), degë të saj, në përputhje me basenet ujore të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

1. AMBU, referuar zhvillimit, rregullimit dhe financimit të sektorit të ujqit, ka këto përgjegjësi dhe detyra:

a) Në lidhje me politikat, strategjitë, planet, programet dhe projektet për zhvillimin e sektorit:

- i. përcakton vizonin drejt të cilit duhet të orientoheq qeverisja e integruar e burimeve ujore;
- ii. analizon situatën e burimeve ujore, identifikon nevojat me qëllim përcaktimin e prioriteteve, vlerëson propozimet dhe kryen fizibilitetin e tyre;
- iii. harton, zbaton dhe monitoron dokumentin e politikave të sektorit, Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, si dhe plane, programe e projekte që synojnë menaxhimin e integruar të burimeve ujore, ruajtjen sasiore dhe cilësore, në bashkëpunim dhe koordinim me organet, entet, institucionet e specializuara në fushën e ujërave, në nivel qendror e vendor.

b) Në lidhje me rregullimin e sektorit të ujqit:

- i. identifikon dhe vlerëson nevojën për hartimin e legjislacionit në lidhje me menaxhimin e burimeve ujore;
- ii. harton dhe propozon aktet që rregullojnë marrëdhëniet juridike në fushën e menaxhimit të burimeve ujore dhe ndjek miratimin e tyre;
- iii. bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore kur përmbajta e tyre ndikon në menaxhimin e burimeve ujore;
- iv. monitoron zbatimin dhe ndikimin e kuadrit ligjqor si dhe sugjeron përmirësime sipas nevojës;
- v. bashkërendon punën për harmonizimin e kuadrit ligjqor të sektorit me *acquis* të BE-së;
- vi. mbështet hartimin e kuadrit rregullator për administrimin dhe mbrojtjen e ujërave ndërkufitare dhe ndjek zbatimin e tyre, duke përfshirë marrëveshjet e konventat ndërkombëtare;

vii. i propozon Këshillit Kombëtar të Ujit (KKU) miratimin e akteve rregullatorë për menaxhimin e burimeve ujore në kompetencë të KKU-së sipas ligjit dhe kur është e nevojshme propozon shfuqizimin apo anulimin e akteve;

viii. përfaqëson Këshillin Kombëtar të Ujit në procese gjyqësore dhe monitoron çështjet gjyqësore në nivel të basenit ujor.

c) Në lidhje me aspektin ekonomiko-financiar të sektorit:

i. drejton procesin për optimizimin e shfrytëzimit të burimeve ujore drejt përfitueshmërisë ekonomike, në përputhje me parimet, prioritetet në përdorim dhe nevojat e vendit, si dhe me kriteret për ruajtjen dhe mbrojtjen sasiore e cilësore të burimeve ujore;

ii. vlerëson kosto-përfitimet ekonomike të përdorimeve të burimeve ujore, bazuar në parashikimin afatgjatë të ofertë-kërkesës për ujë për nevoja të ndryshme, si dhe propozon tarifat për përdorimet e ndryshme të ujit dhe për shpenzimet administrative;

iii. vlerëson nevojën për financim të sektorit, identifikon burimet e financimit dhe bashkëpunon me aktorë vendas ose të huaj për sigurimin e financimeve për veprimtarinë ekonomike të burimeve ujore, si dhe menaxhon programet e asistencës financiare për to;

iv. ndjek procesin e menaxhimit të integruar të burimeve financiare dhe monitoron përdorimin e fondeve përkundrejt planifikimit, në përputhje me parimin e eficiencës, transparencës dhe shpërndarjes së drejtë të burimeve, si dhe ngritjes e mirëmbajtjes së inventarit të përditësuar të të gjitha programeve të asistencës financiare e të projekteve.

2. AMBU ka këto përgjegjësi dhe detyra mbi drejtimin e sektorit të ujit:

a) Projekton sistemin e miradministrit të burimeve ujore (aktivitetin, organizimin, ndërveprimin me institucionet e aktorët) dhe garanton funksionalitetin, performancën dhe eficiencën e tij.

b) Organizon strukturën e sistemit në përputhje me fushën e përgjegjësisë dhe aktivitetin, kuadrin strategjik dhe politikat e qeverisë, informacionin dhe njohuritë mbi sektorin, standardet që duhet të arrihen për aktivitetin dhe operimin e sistemit, sfidat dhe problematikat ekzistuese që paraqet sektori i ujit në Shqipëri.

c) Përcakton objektivat për sektorin dhe identifikon treguesit për vlerësimin e arritjes së tyre, vlerëson performancën e përdorimit të burimeve ujore përkundrejt objektivave dhe nivelit të përmbushjes së treguesve, si dhe ndërmerr nisma për përmirësimin e performancës.

ç) Projekton, ndërton, mirëmban dhe përditëson sistemin e integruar të informacionit në sektorin e ujit (me elemente thelbësore: Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore, Inventari Kombëtar i Burimeve Ujore/Zonave të Mbrojtura Ujore, Regjistri Kombëtar i Lejeve, Autorizimeve e Koncesioneve të lëshuara nga organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore), duke garantuar aksesin dhe shkëmbimin e të dhënave sipas ligjit.

d) Drejton dhe bashkërendon punën për gjenerimin, grumbullimin dhe përditësimin e të dhënave cilësore dhe sasiore të burimeve ujore, informacionit për Kadastrën Kombëtare të Ujit nga institucionet përgjegjëse (duke kërkuar prej tyre të dhëna teknike, informacion, analiza apo mbështetje tekniko-konsultative).

dh) Përcakton normativa, standarde, kërkesa, kritere dhe praktika të unifikuara për ruajtjen, përdorimin, rehabilitimin dhe përmirësimin e burimeve ujore, duke bashkëpunuar sipas ligjit me çdo ministri apo institucion përgjegjës.

e) Mban të dhënat/data bazat tematike të sektorit dhe orienton e mbështet kërkimet, studimet, publikimet me karakter shkencor e teknik sipas ligjit.

ë) Është përgjegjës për marrëdhëniet ndër-institucionale dhe garanton angazhimin e aktorëve duke ngritur sistemin e ndërveprimit (mban data baza, dokumente, manualë, plane, teknika, raporte mbi komunikim-ndërveprimin e aktorëve, ndjek ngritjen e komisioneve, komiteteve apo grupeve të punës për çështje që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore), në mënyrë të integruar, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

f) Drejton dhe bashkërendon punën me ministrinë e linjës për të gjitha proceset integruese në Bashkimin Evropian, për sa i përket sektorit të ujit.

3. AMBU ka këto përgjegjësi dhe detyra mbi menaxhimin e sektorit të ujit:

a) Planifikon, ekzekuton, kontrollon punën dhe garanton që produktet apo shërbimet janë të duhurat, në kohë, brenda buxhetit, në sasinë dhe cilësinë e kërkuar:

i. Integron kërkesat për realizimin e një produkti optimal, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, të qëndrueshëm dhe të sigurt.

ii. Analizon progresin, vlerëson devijimet në raport me objektivat, standardet dhe planin e menaxhimit, si dhe menaxhon ndryshimet e nevojshme në program e në burime;

b) Harton dhe ndjek zbatimin e të gjitha planeve të menaxhimit të kërkuara nga ligji, nëpërmjet zyrave të administrimit të baseneve ujore, në bashkëpunim me strukturat shtetërore përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi, si dhe aktorët e tjerë.

c) Menaxhon dhe koordinon procesin e programimit, zbatimit dhe monitorimit të nismave/projekteve/programeve të administrimit të burimeve ujore në bashkëpunim me ministrinë e linjës, institucionet qendrore e vendore, donatorë dhe partnerë të tjerë zhvillimorë.

ç) Kryen menaxhimin e përgjithshëm sipas ligjit të organeve të administrimit të burimeve ujore, njësisë të qeverisjes vendore, organeve dhe strukturave përgjegjëse të ministrive, institucioneve shtetërore e aktorëve përkatës për marrjen e masave dhe zbatimin e legjislacionit në sektorin e ujit.

4. AMBU ka këto përgjegjësi dhe detyra mbi operimin e sektorit të ujit:

a) Planifikon, zbaton, ndjek, garanton optimizimin e përdorimit të burimeve njerëzore, materiale, aseteve të nevojshme për kryerjen e proceseve të punës për menaxhimin e burimeve ujore.

b) Realizon të gjitha proceset e punës, pjesë e ciklit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, si dhe bashkërendon e kontrollon punën e zyrave të administrimit të baseneve ujore.

c) Realizon projektimin, ekzekutimin, vënien në punë dhe shfrytëzimin e produkteve të kërkuara, si dhe garanton cilësinë, certifikon, lëvtron dhe akumulon përfitimet e produktit të realizuar.

ç) Ndjek zbatimin e proceseve të punës për burimet ujore nga ministrinë përkatëse dhe bashkëpunon me to, sipas detyrimeve e kërkesave specifike të kuadrit ligjor.

d) Ushtron funksionet e sekretarisë teknike të KKU-së, organizon mbledhjet, përgatit materialet dhe formalizon vendimmarrjen e KKU-së. *Pranon kërkesat dhe shqyrton dokumentacionin tekniko-ligjor të paraqitur nga subjektet fizike dhe juridike që kërkojnë miratim, në parim, për nisjen e një procedure koncesioni, për leje, për autorizim për përdorim burimi ujor, për veprimtari ndërtimore në brigje, për veprimtari në shtratin e burimit ujor dhe shkarkime të lëngshme, si dhe bën propozimet përkatëse në Këshillin Kombëtar të Ujit ose në Këshillin e Basenit Ujor, sipas kompetencave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për miratimin e veprimtarisë përkatëse.*

dh) Ndjek dhe monitoron zbatimin e kushteve e të kriterëve të përcaktuara në lejet/autorizimet e dhëna për përdorimin e ujit, si dhe ndërmerr masat ndaj subjekteve që gjenden në shkelje.

dh/1. I propozon KKU-së dhe/ose KBU-së rishikimin, pezullimin, shfuqizimin ose anulimin e lejeve, autorizimeve.

e) Siguron mbledhjen e të ardhurave nga tarifat e përdorimit të ujit dhe pagesat për shpenzimet administrative, nëpërmjet zyrave të administrimit të baseneve ujore apo marrëveshje me të tretë dhe i derdh në buxhetin e shtetit.

ë) Mbledh, strukturon, përpunon, akseson dhe administron të dhëna sasiore e cilësore mbi burimet ujore dhe i vë ato në dispozicion të institucioneve në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.

f) Promovon dhe sensibilizon mbi rëndësinë e burimeve ujore, nxit pjesëmarrjen e përdoruesve të ujit dhe komunitetit në përdorimin e ekonomizuar të ujit, përmes fushatave ndërgjegjësuere, botimeve, publikimeve, konferencave, seminareve, forumeve apo konsultimeve.

5. Mbështetur në detyrat e përcaktuara në ligj, Zyra e Administrimit të Baseneve Ujore (ZABU) ka këto detyra administrative dhe kompetenca territoriale:

a) Në lidhje me Këshillin e Basenit Ujor (KBU):

i. ushtron funksionet e sekretariatit teknik dhe organizon mbledhjen e KBU-së;

iii. *I propozon KBU-së rishikimin, shfuqizimin ose anulimin e vendimeve, që nuk kanë të bëjnë me dhënien e lejeve dhe të autorizimeve;*

iv. përfaqëson Këshillin e Basenit Ujor në çështjet gjyqësore.

b) Ndjek zbatimin e vendimeve të KBU-së dhe KBU-së, si dhe përmbushjen e detyrimeve financiare të përdoruesve të burimeve ujore brenda basenit përkatës pavarësisht nga organi që ka miratuar veprimtarinë.

c) Zbaton të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë ligjore të përcaktuara për ZABU-në si dhe nxit e sensibilizon pjesëmarrjen e përdoruesve të ujit.

ç) Në nivel baseni dhe sipas ligjit, harton dhe përditëson planet e menaxhimit, inventarët e burimeve ujore, përgatit raporte apo opinione, bën vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave, analizën ekonomike të përdorimit, analiza pas monitorimeve të kryera nga subjektet e kontraktuara, harton programin e masave, plotëson regjistrin kombëtar me licencat/ autorizimet/lejet/koncesionet e lëshuara.

d) Gjeneron dhe monitoron të dhëna sasiore e cilësore mbi burimet ujore nëpërmjet ngritjes, administrimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të stacioneve të monitorimit.

Referuar VKM nr. 696, datë 30.10.2019 óPër përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre, territori i Republikës së Shqipërisë, në funksion të menaxhimit të burimeve ujore, ndahet në shtatë basene ujore (Fig. nr.1), si më poshtë vijon:

a) baseni ujor Drin-Bunë;

b) baseni ujor Mat;

c) baseni ujor Ishëm;

ç) baseni ujor Erzen;

d) baseni ujor Shkumbin;


dh) baseni ujor Seman;

e) baseni ujor Vjosë.

Për çdo basen ujor funksionon Zyra e Administrimit të Basenit Ujor e cila siç është cituar dhe më sipër kryen funksionet e sekretariatit Teknik dhe organizon mbledhjet e KBU. Sipas VKM-së⁷ së mësipërme, Baseni Ujor Drin Bunë administrohet nga ZABU Drin Bunë me seli në Shkodër. Baseni Ujor Ishëm, Erzen dhe Mat administrohet nga ZABU Ishëm, Erzen, Mat me seli në Tiranë. Baseni Ujor Shkumbin, Seman administrohet nga ZABU Shkumbin, Seman me seli në Fier. Baseni Ujor Vjosë administrohet nga ZABU Vjosë me seli në Vlorë.


⁷ VKM nr. 696, datë 30.10.2019 óPër përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre

Fig. nr. 1. Harta e baseneve ujore




Burimi: VKM Nr. 696, datë 30.10.2019, Shtojca 1

Figura nr. 2. Organigrama e AMBU



Burimi: AMBU

Figura nr. 3. Organigrama e ZABU-ve



Burimi: AMBU


2. **Agjencia Kombëtare e Mjedisit** e krijuar me anë të VKM nr. 568, datë 17.7.2019 óPër krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisitó bazuar edhe në Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, óPër mbrojtjen e mjedisitó, i ndryshuar. AKM-ja ka për mision mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit si një pasuri jetike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, përdorimin e matur dhe racional të natyrës e të burimeve të saj në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. AKM-ja ka këto funksione kryesore:

1. Sigurimin e performancës mjedisore;
2. Kërkimin dhe dijen mjedisore;
3. Vlerësimin e impaktit mjedisor dhe licencimin;
4. Inspektimin dhe kontrollin tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.

Në lidhje me inspektimin dhe kontrollin e veprimtarive lidhur me sektorin e mjedisit dhe ujërave, AKM ka për detyrë:

- a) përgatitjen e raporteve periodike mbi vlerësimin e mjedisit;
- b) përgatitjen dhe ndjekjen e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit;
- c) sigurimin e kontrollit shtetëror të mbrojtjes së mjedisit siç parashikohet në legjislacionin në fuqi;
- ç) kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve përmes një programi tematik mbi bazë risku, të miratuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore, siç parashikohet në ligj dhe në legjislacionin e posaçëm në fuqi;
- d) sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të mjedisit dhe ujërave.

Figura nr. 4. Organigrama e AKM



Burimi: AKM

3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural bazuar në Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Brendshëm me nr.4276 Prot., datë 02.06.2021 ka për mision konceptimin dhe implementimin e politikave shtetërore për çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural, sigurinë ushqimore e mbrojtjes së konsumatorit, peshkimit dhe akuakulturës. Ndër të tjera MBZHR kujdeset për ngritjen dhe menaxhimin e sistemeve të ujitjes. Nëpërmjet Drejtorisë së Administrimit të tokës dhe ujërave dhe Sektorit të Programeve dhe Administrimit të Ujitjes dhe Kullimit, MBZHR ka për qëllim menaxhimin e qëndrueshëm dhe efektiv të sistemeve ujitëse. Lidhur me këtë, ky Sektor ka një sërë përgjegjësisish për ujitjen si më poshtë:

- Planifikon, drejton koordinon dhe monitoron aktivitetet që realizohen nëpërmjet programit të menaxhimit të infrastrukturës së ujitjes, për rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes;
- Monitoron aktivitetin e ujitjes pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit. Mbikëqyr infrastrukturën e ujitjes nga ana teknike;
- Organizon dhe koordinon trajnimin e strukturave të përfshira në ofrimin e shërbimit të ujitjes.
- Propozon dhe ndjek transferimin e sistemeve të ujitjes te bashkitë;

- Harton dhe propozon për miratim akte ligjore dhe nënligjore në funksion të mbarëvajtjes dhe përmirësimit të menaxhimit të ujitjes, ndjek, kontrollon dhe përgjigjet për zbatimin e tyre;
- Ndjek ecurinë e ujitjes nga bashkitë në mënyrë të vazhdueshme duke përgatitur evidencat analizat dhe propozimet përkatëse;
- Jep mendim dhe promovon nevojat dhe teknologjitë bashkëkohore të ujitjes në vend.
- Planifikon buxhetin dhe mbikëqyr funksionimin e Drejtorive të ujitjes në procesin e operimit, mirëmbajtjes dhe rehabilitimit të infrastrukturës së ujitjes.

2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

- Ligji nr. 111/2012 óPër Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujorë ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018.
- Ligji nr. 24/2017 óPër administrimin e ujitjes dhe të kullimit.
- Ligji nr. 53/2020 óPër disa ndryshime të Ligjit Nr.10431, date 09.06.2011 óPër Mbrojtjen e Mjedisit,ó i ndryshuar,
- Ligji nr. 12/2015 óPër disa ndryshime në Ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011 óPër Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisó,
- Ligji nr.52/2020 óPër disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 óPër Lejet e Mjedisitó.
- Ligji nr. 10433, dt.16.06.2011 óPër Inspektimin në Republikën e Shqipërisëó .
- Ligji nr. 9115 dt. 24.07.2003 óPër trajtimin e ujërave të ndoturaó të ndryshuar.
- Ligji nr. 8905, datë 06.06.2002 óPër mbrojtjen e mjedisit detaró.
- Ligji nr. 9103, datët 10.07.2003 óPër mbrojtjen e Liqeneve Ndërkufitareó i ndryshuar dhe në të gjitha aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të këtyre akteve ligjore.
- VKM nr .73, datë 07.02.2018 óPër miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujorë, 2018ñ2027ó
- VKM nr. 849, datë 4.11.2020 óPër miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujqor Drin Bunëó
- VKM nr. 453, datë 10.6.2020 óPër miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujqor Semanó.
- Vendim i KKK Nr.6 datë 12.06.2019 óPër Miratimin e Rregullores së Këshillit të Basenit Ujqoró.
- VKM nr. 696, datë 30.10.2019 óPër përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujqore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyreó.
- VKM nr. 993, datë 9.12.2020 óPër miratimin e tarifave të përdorimit të ujit të ujërave ndërkufitar, pagesat administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyreó.
- VKM nr.1122, datë 30.12.2020 óPër miratimin e kërkesave, kushteve, procedurave, fondeve të nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e kadastrës kombëtare të burimeve ujqoré.
- VKM nr. 550, datë 15.07.2020 óPër miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin në parim, për dhënien me koncesion të burimit ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e lumit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqërues, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes, të formularëve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë të tyreó.

- VKM nr. 1015, datë 16.12.2020 óPër përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.
- VKM nr. 221, datë 26.4.2018 óPër organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore ndryshuar me VKM nr. 361, datë 6.5.2020.
- VKM nr. 1014, datë 16.12.2020 óPër miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative për kërkesat për përdorimin, shkarkimin e ujit dhe ndërtimin e objekteve e veprave ujore.
- VKM nr. 656, datë 31.10.2018 óPër përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore ndryshuar me VKM nr. 559, datë 31.7.2019, nr. 612, datë 29.7.2020, nr. 901, datë 18.11.2020; nr. 322, datë 2.6.2021
- Urdhër i KM nr. 152 datë 1.10.2018 óPër miratimin e strukturës dhe të organikes së agjencisë së menaxhimit të burimeve ujore, i ndryshuar.
- VKM nr. 662 datë 21.09.2016 óPër miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta.
- VKM nr. 876, datë 14.12.2016 óPër miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative
- VKM nr. 437, datë 17.5.2017 óPër krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë.
- Rregullore nr.4276.prot., datë 02.06.2021 óPër organizimin dhe funksionimin e brendshëm të MBZHR.
- VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 óPër transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe administrimit të ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit.
- VKM nr. 345, datë 22.5.2019 óPër miratimin e strategjisë kombëtare të ujitjes dhe kullimit 2019-2031.
- VKM nr. 568 datë 17.07.2019 óPër krijimin, mënyrën e organizmin dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit
- Urdhri i KM nr. 23, datë 03.02.2020 óPër Miratimin Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.
- VKM nr. 127, datë 11. 02. 2015 óPër Kërkesat për Përdorimin në Bujqësi të Llumrave të Ujërave të Ndotura.
- VKM nr. 360, Datë 29.4.2015 Për Miratimin e Listës së Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm dhe Përcaktimin e Masave për Prodhimin, Importimin, Vendorsjen në Treg dhe Përdorimin e Tyre
- VKM nr.1189, date 18.1.2009, óPër rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit.
- VKM nr.177, datë 31.03.2005, óPër normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse.
- VKM nr.686, datë 29.07.2015 óPër miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis(VNM) dhe procedurës së Transferimit të Vendimit të Deklaratës Mjedisore.
- VKM nr. 247, date 30.04.2014 óPër përcaktimin e rregullave, të kërkesave e procedurave për informimin e pjesëmarrjen e publikut në vendimarrjen mjedisore.
- Udhëzimin e përbashkët nr.7938, datë 17.07.2014 të Ministrisë së Mjedisit dhe Nr.10442/1, datë 31.07.2014 të Ministrisë së Financës óPër përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e V.N.M.-së.
- Programi Kombëtar i Monitorimit në Mjedis për vitet 2018,2019,2020, 2021.
- Raportet e Gjendjes në Mjedis për vitet 2018, 2019, 2020.

- OECD, Studimet për ujin: Një komizë për financimin e menaxhimit të burimeve ujore, 2012;
- Iniciativa për ujin e BE-së: Financimi i menaxhimit të burimeve ujore, rasti i Afrikës Jugore.

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.

Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore

Me anë të VKM-së nr. 73 datë 7.2.2018 u miratua Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027. Procesi i zhvillimit të Strategjisë së Menaxhimit të integruar të Burimeve Ujore (SIMBU) për Shqipërinë është hartuar në mënyrë të tillë që të ofrojë një kornizë për administrimin gjithëpërfshirës të burimeve ujore, në të cilin të gjitha palët e interesit, duke përfshirë edhe sektorin privat, shoqërinë civile dhe komunitetet përdoruese, pavarësisht nga gjinia, të luajnë një rol aktiv. Strategjia integron objektivat e politikave ekzistuese shqiptare duke marrë parasysh rreziqet që pritet të vijnë nga ndryshimet klimatike bazuar në katër ÷shtylla strategjike: ÷ujë për njerëzit, ÷ujë për ushqim, ÷ujë për industrinë dhe ÷ujë për mjedisin. SKMIBU fillon me një përshkrim të kushteve aktuale të burimeve ujore dhe të përdorimit aktual të ujit në vend, duke përfshirë kuadrin ligjor dhe institucional. Përmes analizave dhe konsultimeve, janë përcaktuar çështjet dhe mangësitë përkatëse që pengojnë menaxhimin e integruar të burimeve ujore. Për përmbushjen e këtyre mangësive, SIMBU përcakton 5 objektiva strategjike⁸ që kërkojnë një vëmendje të veçantë:

1. *Sasia e ujit*: sigurimi i një përdorimi të drejtë dhe të qëndrueshëm të të gjitha burimeve ujore, që i shërben të gjitha interesave nëpërmjet aplikimit të akteve edhe nën-akteve ligjore kombëtare, të cilat transpozojnë direktivat përkatëse të BE-së;
2. *Cilësia e ujit*: sigurimi i një cilësie të mirë të ujit të të gjitha burimeve ujore, duke arritur statusin e ÷gjendjes së mirë të ujit deri në vitin 2027, nëpërmjet aplikimit të akteve edhe nën-akteve ligjore kombëtare, të cilat transpozojnë direktivat përkatëse të BE-së;
3. *Rreziqet nga uji*: ulja e rreziqeve që vijnë nga uji (përmbajtje dhe thatësira) përmes menaxhimit dhe investimeve, që i shërben të gjitha interesave, nëpërmjet aplikimit të akteve edhe nën-akteve ligjore kombëtare, të cilat transpozojnë direktivat përkatëse të BE-së;
4. *Informacion për ujin*: sigurimi i modeleve dhe të dhënave të njohura gjerësisht si të besueshme rreth ujit dhe klimës për të gjitha palët e interesit dhe dhënia e këshillave qeverisë për hartimin e politikave për ujin duke u bazuar në institucionet respektive të cilat i zotërojnë këto të dhëna;
5. *Administrimi i ujit*: menaxhimi i ujit në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, në shërbim të gjitha interesave duke ofruar përfitime social-ekonomike të barabarta nga përdorimi i ujit dhe përfshirje në vendimmarrje për brezat e ardhshëm, sipas parimeve të politikave mjedisore dhe ujore MIBU dhe të BE-së.

Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore

Me anë të VKM-së nr. 1122 datë 30.12.2020 ÷Për miratimin e kërkesave, kushteve, procedurave, fondeve të nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin, përditësimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore u krijua Kadastra e cila është një platformë elektronike që administrohet nga AMBU dhe në të cilën gjendet baza e të dhënave elektronike për burimet ujore. Baza e të dhënave shtetërore për burimet ujore ndahet për:

- a) Ujërat sipërfaqësorë;
- b) Ujërat nëntokësorë;

⁸ *Shënim*: Edhe pse Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore përcakton 5 objektiva strategjike, në nënkapitullin 3.4 përcaktohet qartë se cilët prej këtyre objektivave strategjike do të jenë në fokusin e këtij auditimi dhe cilët jo.

- c) Ujërat detar;
- ç) Strukturat e ujit;
- d) Përdorimin e ujit;
- dh) Mbrojtjen e ujit;
- e) Zonat e mbrojtura ujore;
- ë) Monitorimin e ujit;
- f) Monitorimin meteorologjik;
- g) Modele të tjera.

Kadastra menaxhohet dhe përditësohet nga AMBU, nëpërmjet sistemit dhe arkivit elektronik. Të gjitha institucionet, entet dhe subjektet e tjera publike ose jo publike që merren me menaxhimin e burimeve ujore, detyrohen të caktojnë një përfaqësues të përhershëm që mban marrëdhënie me AMBU, duke raportuar në mënyrë periodike çdo tre muaj mbi ecurinë e përditësimit me të dhënat në kadastrë. AMBU në cilësinë e administratorit të kadastrës kryen këto funksione:

- a) është përgjegjës për sigurimin e vazhdueshmërisë së pandërprerë dhe mirëfunksionimin e kadastrës;
- b) mbikëqyr e monitoron veprimet që kryhen në kadastrë;
- c) është përgjegjës për strukturën e bazës së të dhënave dhe administrimin e saj;
- ç) ka të drejtë të ndryshojë apo anulojë nivelin e aksesit të një përdoruesi pa njoftim, kur vëren se ai nuk zbaton rregullat e përdorimit ose dyshohet se po i shkakton dëm sistemit në përgjithësi;
- d) harton udhëzime dhe manual për përdoruesit e sistemit;
- dh) bën propozime për avancimin e programeve të përdorura dhe avancimin e sistemit në përgjithësi në konsultim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
- e) krijon dhe administron nivelet e aksesit në kadastrë.

Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit përcakton treguesit kryesorë të gjendjes, të ndikimit dhe të trysnisë në ajër, në ujëra sipërfaqësore e nëntokësore, në tokë, në zonën bregdetare, në detet, pyjet e në larinë biologjike. Për çdo tregues mjedisor, që matet apo llogaritet, ai përmban emrin e tij, mënyrën e përcaktimit, metodën e matjes dhe vendin e marrjes së mostrës, shpeshtësinë dhe njësinë e matjes, mënyrën e përpunimit dhe të paraqitjes së të dhënave. Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit është një dokument që përgatitet çdo vit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Ai synon të ndihmojë autoritetet kombëtare shqiptare që po përdorin një sistem të integruar të monitorimit mjedisor, që mbulon të gjithë komponentët: ajrin, ujërat, tokën, pyjet dhe biodiversitetin në formën e një seti stacionesh monitorimi për secilin komponent, e shoqëruar me një set indikatorësh për të cilat duhet raportuar.

Raporti i Gjendjes në Mjedis

Bazuar në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit përgatitet Raporti i Gjendjes së Mjedisit i cili është një dokument që përgatitet çdo vit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe ku paraqiten, komentohen dhe analizohen treguesit mjedisorë (përfshirë edhe ujërat), si dhe jepen rekomandimet për përmirësimin e gjendjes së mjedisit. Qëllimi kryesor i vlerësimit të gjendjes së mjedisit është që të kuptohen pasojat ose ndikimet në mjedis që vijnë nga sektorë të ndryshëm dhe të identifikojë mënyrat për të minimizuar ndikimet negative. Monitorimi i treguesve të dukurive natyrore e të cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe të biodiversitetit kryhet nga institucione monitoruese të specializuara,⁹ duke lidhur me ta kontrata, në bazë të procedurave të konkurrimit, që vlerësojnë profilin e secilit, përvojën e kualifikimin e stafit, pajisjet e aparaturat që disponon, si dhe projektin e tij për monitorimin të paraqitur për konkurrim. Shpenzimet operative për monitorimin e dukuri

⁹ VKM nr.1189, datë 18.11.2009 óPër rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e PKMMô

ve natyrore dhe të cilësisë së mjedisit, për përpunimin e treguesve mjedisorë, si dhe për kontrollin e saktësisë së tyre, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, i miratuar për këtë qëllim.

2.4 Peshë në buxhet

ÓEkziston një nevojë e qartë dhe urgjente që qeveritë në mbarë botën të forcojnë dimensionin financiar të menaxhimit të burimeve ujorë¹⁰. Për të siguruar menaxhim të integruar efektiv dhe eficient të burimeve ujore, praktikë më të mira vënë fokusin tek mbështetja financiare e nevojshme, duke e konsideruar si faktor kyç në arritjen e objektivave të politikës. Ó... për të përballuar sfidat që lidhen me menaxhimin e integruar të ujërave duhen të angazhohen fondet e nevojshme me qëllim administrimin e politika më komplekse të ujit, për të rehabilituar, operuar dhe mirëmbajtur asetet ekzistuese dhe për të investuar në infrastrukturë të re.¹¹ “Rastet studimore konfirmojnë se në një numër vendesh (si të OECD-së ashtu edhe jo të OECD-së), menaxhimi i burimeve ujore nuk arrin të aksesojë fondet e nevojshme, për të arritur objektivat e politikave.”¹² Për vet rëndësinë që ka mbështetja financiare në menaxhimin efektiv dhe eficient të burimeve ujore, eksperiencia e vendeve të tjera ka treguar se, nëse funksionet e integruara nuk financohen siç duhet (pra nuk mundësojnë krijimin e mjedisit të favorshëm për menaxhimin e ujërave), rezultatet shumë shpejt do të shfaqen në formën e një investimi jo-të plotë dhe jo-eficiente në ekonominë e gjerë të ujit.¹³ Sikurse është trajtuar edhe më herët, menaxhimi i integruar i burimeve ujore është një prioritet strategjik i vendit tonë dhe politikat për të janë parashtruar në dokumentin ÓStrategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujorë (në vijim SKMIBU). Në këtë dokument strategjik, miratuar me VKM nr.73., datë 07.02.2018, mungesa e financimeve trajtohet si një nga sfidat kryesore të vendit tonë, për arritjen e objektivave të synuar në menaxhimin e integruar të ujërave. ÓMangësitë financiare: Mobilizimi dhe akordimi i financimeve për sektorin ujor në mënyrë efikase, transparente dhe në kohë është një mangësi e dukshme. Parimet e BE-së për politikën e mjedisit, siç janë parimet “ndotësi paguan” dhe “përdoruesi paguan”, si dhe pagesa për shërbimet mjedisore janë përfshirë në rregullore. Parimi ‘ndotësi paguan’ dhe ‘rikuperimi i kostos’ paraqesin një sfidë në këtë kohë.¹⁴

Ndërsa, referuar dokumentit strategjik, pasoja kryesore e mangësive financiare është varësia që ka skema nga buxheti i shtetit. ÓPër aq kohë sa nuk ka rikuperim të kostove në këtë nivel ka ende një mangësi financiare për t’u mbuluar nga subvencionet shtetërore dhe financimet e mundshme ndërkombëtare.¹⁵

Në planin e veprimit të SKMIBU-së, janë parashikuar aktivitetet e nevojshme për tu ndërmarr me qëllim menaxhimin e integruar të ujërave, afatet kohore brenda të cilëve duhet të realizohen veprimet, si dhe kostot për secilin prej tyre. Me qëllimin analizimin e detajuar të politikave dhe aktiviteteve të fokusit të këtij auditimi të cituara në kapitujt e mëposhtëm, grupi i punës ka identifikuar fondet e nevojshme, (referuar planifikimit të institucioneve përgjegjëse), për të mbështetur arritjen e rezultateve të synuara, të parashikuara në dokumentin strategjik kombëtar.

¹⁰ OECD, Studimet për ujin: Një kornizë për financimin e menaxhimit të burimeve ujore Shkurtimisht, 2012, fq.1

¹¹ OECD, Studimet për ujin: Një kornizë për financimin e menaxhimit të burimeve ujore Shkurtimisht, 2012, fq.2

¹² OECD, Studimet për ujin: Një kornizë për financimin e menaxhimit të burimeve ujore Shkurtimisht, 2012, fq.3

¹³ Iniciativa për ujin e BE-së: Financimi i menaxhimit të burimeve ujore, rasti i Afrikës Jugore, 2002, fq.8

¹⁴ VKM 73 date 07.02.2018 : Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, fq. 81

¹⁵ VKM 73 datë 07.02.2018 : Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, fq. 82

Tabela nr 1 . Fondet e nevojshme për cështjen objekt auditimi, për periudhën 2018-2021

A1. Sasia e Ujit					
Nr.	Objektivat	Produktet	Institucioni	Afati i zbatimit	Kosto (mln lekë)
1	Menaxhimi i burimeve ujore në nivel basin. I lidhur me cilësinë.	Hartimi dhe realizimi i planit vjetor të të ardhurave nga subjektet që përdorin burimet ujore. Përgatitja e raporteve periodike financiare realizimin vjetor të të ardhurave.	AMBU	2018-2020	52.30
		Përgatitja e akteve ligjore dhe nën-ligjore për menaxhimin e ujërave		2018-2020	26.30
		Hartimi i raportit financiar për grumbullimin e të ardhurave		2018-2022	28.30
		Raporte vlerësimi dhe masash mbi monitorimin e procedurës së pajisjes me leje të përdoruesve të burimeve ujore		2018-2019	33.00
		Regjistri kombëtar i lejeve të burimeve ujore		2018	58.40
		Studim hidrologjik për shfrytëzimin e shtretërve të lumenjve		2018	102.00
		Hartimi i PMBU Shkumbin		2019	5.60
		(A1) Total për objektivin strategjik “Sasia e Ujit”			AMBU
A2. Cilësia e Ujit					
Nr.	Objektivat	Produktet	Institucioni	Afati i zbatimit	Kosto (mln. lekë)
1	Përcaktimi i gjendjes së ujit me cilësi të mirë.	Raport monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	AMBU	2018-2020	179.18
		Zhvillimi i një data baze digjitale për matjen e cilësisë së ujërave 2018-2021		2018-2021	89.8
		Vlerësimi i laboratorëve ekzistues; përcaktimi i vendeve më të përshtatshme dhe plani i akreditimi		2018-2021	700
(A2) Total për objektivin strategjik “Cilësia e Ujit”			AMBU	2018-2021	968.98
A4. Informacion për Ujin					
Nr.	Objektivat	Produktet	Institucioni	Afati i zbatimit	Kosto (mln lekë)
1.	Përcaktimi i sistemeve të monitorimit të ujit	Zhvillimi i kadastrës së ujit në formën e një sistemi GIS: Kadastra e ujit do të përbëhet nga një bazë të dhënash për burimet e kërkuara të Gjeo-Referencuara AMBU	AMBU	2018-2020	43.2
2.	Kontrolli i planeve ..për mbrojtjen ndaj ndryshimeve klimatike	Stacione të monitorimit për cilësinë e ujërave sipërfaqësorë	Ministria Mjedisit (AKM)		44.3
		Raporte monitorimi për treguesit në programin mjedisor	Ministria Mjedisit (AKM)		75.2
(A4) Total për objektivin strategjik “Informacion për ujin”			AMBU	2018-2020	162.7
A5. Menaxhimi i Ujit					
Nr.	Objektivat	Produktet	Institucioni	Afati i zbatimit	Kosto (mln lekë)
1.	Arritja e përputhshmërisë së plotë me parimet e BE-së për ujin dhe mjedisin	Hartimi dhe miratimi i akteve ligjore dhe nënligjore në përbushje të detyrimeve të ligjit nr.111/2012 "Për menaxhimin e burimeve ujore" dhe në kuadër të përafrimit të Legjislacionit Kombëtar me atë Evropian	AMBU	2018-2020	26.3
2.	Sigurimi i përfshirjes publike dhe debatit të informuar (nën qeverisjen e ujit)	Kryerja e detyrave funksionale të drejtorisë përkatëse të AMBU-së në funksion të këtij objekti A	AMBU	2018-2020	87.6
3.	Vendosja e koordinimit ndërsektorial	Kryerja e detyrave funksionale të drejtorisë përkatëse të AMBU-së në funksion të këtij objekti	AMBU	2018	87.6
		SKMIBU	AMBU		24.3
4.	Praktika e integritetit dhe transparencës	Kryerja e detyrave funksionale të drejtorisë përkatëse të AMBU-së në funksion të këtij objekti	AMBU	2018-2020	87.6
5.	Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të menaxhimit të uji	Identifikimi i një sërë masash prioritare për të përmirësuar efencën e menaxhimit të burimeve ujore, si analizat dhe gjendjen fizike të burimeve ujore në basen, inventarin e burimeve ujore, Drini-Buna, Semani dhe Vjosa.	AMBU	2018-2020	229
		Kryerja e detyrave funksionale të drejtorisë përkatëse të AMBU-së në funksion të këtij objekti	AMBU	2018-2020	87.6
(A5) Total për objektivin strategjik “Menaxhimi i Ujit”			AMBU	2018-2020	630
Total fondet e nevojshme për menaxhimin e integruar të burimeve ujore			AMBU	2018-2021	2067.6 ¹⁶

Në tabelën e mësipërme janë paraqitur vlerat monetare të nevojshme (referuar SKMIBU) për realizimin e objektivave/nën-objektiva strategjikë objekt auditimi, detajuar si më poshtë:

1. Për objektivin strategjik óSasia e ujitô, është përlogaritur mbështetja financiare e nevojshme për nën-objektivin strategjik “Menaxhimi i burimeve ujore në nivel baseni (gjithashtu i lidhur me cilësinë)”¹⁷, fokus i këtij auditimit;
2. Në përlogaritje është përfshirë edhe mbështetja financiare e nevojshme (sipas SKMIBU) për objektivin strategjik óCilësia e Ujitô, duke qenë se ai përbëhet nga vetëm një nën-objektiv strategjik, i cili është fokus i këtij auditimi,
3. Gjithashtu, për objektivin strategjik óInformacione për ujinô, është përlogaritur mbështetja financiare e nevojshme për nën-objektivin strategjik óPërcaktimi i sistemeve të monitorimit të ujit”, fokus i këtij auditimit
4. Në përfundim, është përlogaritur edhe mbështetja e nevojshme monetare, për të realizuar aktivitetet fokus i këtij auditimit, pjesë e objektivit strategjik óMenaxhimi i burimeve ujoreô, me nën-objektivat : óArritja e përputhshmërisë së plotë me parimet e BE-së për ujin dhe mjedisinô¹⁸; óSigurimi i përfshirjes publike dhe debatit të informuar (nën qeverisjen e ujit)ô; óVendosja e koordinimit ndër-sektorial dhe planifikimô; óPraktika e integritetit dhe transparencësô dhe óMonitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të menaxhimit të ujitô¹⁹

Referuar Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, me qëllim arritjen e objektivave strategjik për menaxhimin e integruar të burimeve ujore fokus i këtij auditimi (detajuar në tabelën e mësipërme), mbështetja totale financiare e nevojshme për periudhën 2018-2021 ishte 2,067,600,000 lekë, për aktivitete me institucion përgjegjës AMBU-në dhe AKM.

Krahas fondeve të nevojshme (parashikuar në dokumentin strategjik) për arritjen e objektivave të vendosur me qëllim menaxhimin e integruar të burimeve ujore, grupi i auditimit ka identifikuar edhe fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit dhe realizimin e tyre, për periudhën nën auditim.

AMBU, si institucioni me rol kyç në sistemin e menaxhimit të integruar të ujërave, gjatë periudhës 2018-2021, ka planifikuar dhe realizuar vlerat e mëposhtme buxhetore.

Tabela nr. 1: Buxheti plan dhe fakt i AMBU-së, për periudhën 2018-2021

000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Total 2018-2021
1	Buxheti plani AMBU	60,671	203,230	178,900	185,650	628,451
	% ndryshimit të planit		235%	-12%	4%	-
2	Buxheti fakt AMBU	32,784	123,716	136,657	160,112	453,269
	% ndryshimit të faktit		277%	10%	17%	-
3	Realizimi i buxhetit ²⁰ (%)	54%	61%	76%	86%	72%

Burimi: AMBU, Përpunoi: Grupi i auditimit

Në total, gjatë periudhës 2018-2021 buxheti i planifikuar për AMBU-në, ka qenë në vlerën 628,451,000 lekë, ndërsa buxheti është realizuar në masën 72% e planit të rishikuar (ndryshe 453,269,000 lekë). Nga analizimi i të dhënave të buxhetit të AMBU-së, vërehet se në vlerë

¹⁶ Shënim i grupit të auditimit: Totali (A1)+(A2)+(A4)+(A5)

¹⁷ Shënim i grupit të auditimit: Nuk është fokus i auditimit aktiviteti për përfshirjen e direktivave të BE-së dhe adaptimin e problematikave të ndryshimeve klimatike, SKMIBU, fq.133.

¹⁸ Shënim i grupit të auditimit: Nuk është fokus i auditimit aktiviteti óProgrami i infrastrukturës bashkiake II, për qytetet Kamëz, Lushnjë, Berat, Kuçovë, Fier dhe Sarandë: trajnime dhe konsulencëô fq.140.

¹⁹ Shënim i grupit të auditimit: Nuk është fokus i auditimit aktiviteti óRaport monitorimi i kontratave koncesionare...ô dhe óKrijimi, funksionimi, përgjegjësitë dhe detyrat e komisionit të të posaçëm për administrimin e ujërave ndërkufitareô.

²⁰ Buxheti Fakt/ Buxheti Plan të Rishikuar.

absolute buxheti i AMBU në vitet 2019-2021 ka pësuar një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2018, kjo edhe për faktin se në vitin 2018 ende një pjesë të konsiderueshme të funksioneve që sot kryhen nga AMBU, i ka pasur realizuar MBZHR.

Për të pasur një pasqyrim të plotë të fondeve të akorduara për temën objekt auditimi, grupi i auditimit kërkoi informacion edhe për fondet e planifikuara e të realizuara nga MBZHR në vitin 2018, për programin e ujërave që deri në atë vit ishte administruar nga Ministria (viti i fundit përpara kalimit të kompetencave tek AMBU). Gjatë periudhës 2018-2021 MBZHR ka administruar edhe Programin e Ujitjes dhe Kullimit, por duke qenë se nuk është aktivitet fokus i këtij auditimi, fondet e parashikuara dhe realizuara për të, nuk janë përfshirë në përlogaritje.

Tabela nr. 2: Buxheti i programit “Administrimi i Ujit” të MBZHR, kundrejt buxhetit total MBZHR, 2018

000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	Programi “Administrim Uji” MBZHR-Plan	172,180	NA	NA	NA
2	Programi “Administrim Uji” MBZHR- Fakt	167,433	NA	NA	NA
Realizimi i programit “Administrimi i Ujit”		97%	-	-	-
3	Buxheti total MBZHR-Plan	9,254,196	9,102,838	10,535,244	13,372,191
“Administrim uji” plan/Buxheti total MBZHR plan		1.8%	-	-	-

Burimi: MBZHR, përpunoi Grupi i auditimit

Mbështetur në të dhënat e buxhetit të MBZHR-së, për vitin 2018, fondet e planifikuara për programin buxhetor óAdministrimi i ujitó, ishin 172,180,000 lekë, ndërsa realizimi i tyre ishte në vlerën 167,433,000 lekë, ose 97% e planit të rishikuar.

Në vijim të analizimit, grupi i auditimit ka identifikuar fondet e planifikuara (dhe realizuara) për aktivitetet fokusi të këtij auditimi, të cilat kryhen nga AKM, si një aktor tjetër i rëndësishëm në sistemin e menaxhimit të integruar të ujit. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten fondet e planifikuara dhe të realizuara nga AKM për kryerjen e aktiviteteve objekt auditimi.

Tabela nr. 3: Buxheti për ujin i AKM, kundrejt buxhetit total të AKM për periudhën 2018-2021

000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	Buxheti i ujit AKM -Plan	7,689	6,649	6,754	4,905
Ndryshimi i buxhetit të planif. për ujin (%AKM)			-14%	2%	-27%
2	Buxheti i ujit AKM- Fakt	7,606	5,559	6,575	4,734
Realizimi i buxhetit për ujin (%AKM)		99%	84%	97%	97%
4	Buxheti total AKM- Plani	70,060	75,650	115,722	161,599
5	Buxheti total AKM- Fakti	67,951	67,951	96,952	137,321
Pesha e buxhetit për ujin /buxhetit total -Plan (% AKM)		11%	9%	6%	3%
Pesha e buxhetit për ujin /Buxhetit total -Fakt(%AKM)		11%	8%	7%	3%

Burimi: AKM, Përpunoi: Grupi i auditimit

Mbështetur në të dhënat e buxhetit të AKM-së, vërehet se në vlerë absolute fondet e planifikuara të AKM-së për kryerjen e detyrave funksionale të saj lidhje me inspektimin dhe monitorimin e ujërave (të përcaktuara në VKM nr. 1189 dt. 18.11.2009 óPër rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisitó), kanë pësuar rënie vit pas viti, ku në vitin 2018 kanë qenë planifikuar 7,689,000 lekë, ndërsa në vitin 2021 kanë qenë parashikuar 4,905,000 lekë. Në total, buxheti i AKM-si planifikuar për inspektimin dhe kontrollin e ujit, është realizuar në nivele të larta.

Të njëjtin trend, si edhe fondet e planifikuara, ka pasur edhe pesha relative e fondeve të angazhuar për aktivitetin e AKM-së (fokusi i auditimit), krahasuar me buxhetin total të vetë institucionit. Pesha relative e fondeve të AKM-së, të angazhuara për inspektimin dhe kontrollin e ujërave, ka

pësuar rënie viti pas viti, ku në vitin 2018 fondet e akorduara për to zinin 11% të buxhetit të Agjencisë, kundrejt 3% që zinin në vitin 2021.

Tabela nr. 4: Tabela përmbledhëse e fondeve të akorduara për ujë, kundrejt buxhetit të shtetit.


000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Total 2018-2021
1	Buxheti plan për ujë AMBU, MBZHR, AKM	240,540	209,879	185,654	190,555	826,628
2	Buxheti fakt për ujë AMBU, MBZHR, AKM	207,823	129,275	143,232	164,846	645,176
Realizimi i buxhetit për ujë		86%	62%	77%	87%	-
3	Buxheti i Shtetit Total plan shpenz.	464,702,000	486,677,000	549,374,000	592,801,000	-
Buxheti plan për ujë / buxhetin e shtetit total		0.052%	0.043%	0.034%	0.032%	-
Buxheti i nevojshëm sipas SMU						2,067,600

Burimi: AKM, Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga analizimi i të dhënave të buxhetit total të planifikuar për realizimin e aktiviteteve lidhur me çështjet e ujit objekt auditimi që AMBU, AKM dhe MBZHR kryen, vërehet se, mbështetja financiare për to ka pësuar rënie ndër vite, ku në vitin 2018 në vlerë absolute janë alokuar 240,540,000 lekë, krahasuar me 190,555,000 lekë që u alokuan në vitin 2021. Në total për periudhën 2018-2021 janë angazhuar 826,628,000 lekë nga 2,067,600,000 lekë të parashikuara si të nevojshme në SKMIBU. Të njëjtin trend ka pasur edhe pesha relative e çështjes nën auditim, ku në vitin 2018 fondet e alokuara për të zinin 0,052% të buxhetit të shtetit, krahasuar me 0.032% që zinin në vitin 2021.

Grafiku nr. 2: Trendi i fondeve të angazhuara për çështjen nën auditim, në vlerë absolute dhe relative (kundrejt buxhetit të shtetit)



Burimi: AMBU, AKM, MBZHR, Përpunoi: Grupi i auditimit

Ndërsa politikat e vendit janë të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm, mbështetja financiare e ulët dhe e paqëndrueshme e sistemit të menaxhimit të burimeve ujore, përmban riskun e fondeve të pamjaftueshme për të siguruar arritjen e objektivave.

2.5 Përkufizimet dhe terminologjia²¹

Në kuptim të këtij auditimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

“Basen ujqor” është sipërfaqja e tokës prej ku, përmes një numri përrrenjqsh, lumenjqsh apo edhe liqenesh, të gjitha rrjedhat sipërfaqësore derdhen në një lumë, i cili derdhet në det, në një grykëderdhje të gjerë të vetme, në një deltë apo në një lumë tjetër.

“Burime ujqore” janë të gjitha ujërat e brendshme detare, ujërat territoriale, vija bregdetare, zona ekonomike ekskluzive, shelfi kontinental, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse, reshjet atmosferike, nën juridiksionin dhe kontrollin e Republikës së Shqipërisë.

“Burimet ujqore gjeotermale” janë ujërat që kanë temperatura vazhdimisht më të larta se temperaturat mesatare vjetore atmosferike të rajonit, me efektin e temperaturës së nëntokës, në varësi të strukturës gjeologjike, që mund të përmbajnë materiale të shkrira dhe gaz në një sasi më të lartë se burimet ujqore përrreth, ku uji, avujt dhe gazi natyrshëm shpërthejnë ose nxirren nga vendet ku ato mbahen nëpërmjet ngrohjes nga nëntoka ose nga shkëmbinjtë e thatë dhe të nxehtë, nëpërmjet strukturave nëntokësore të modifikuara nga njeriu.

“Burimet ujqore minerale dhe termominerale” janë ujërat e ngrohta dhe të ftohta natyrore që ndodhen natyrshëm në thellësi të ndryshme të nëntokës e në kushte të përrshtatshme gjeologjike, që ndodhen ose janë nxjerrë në sipërfaqe të tokës më vete nga një ose shumë burime, që janë të përcaktuara nga përmbajtja e tyre minerare apo komponentë të tjerë, të tillë si uji i pijshëm, uji kurativ dhe emra të ngjashëm.

“Eutrofikim” është pasurimi i ujit me përbërës ushqyes, veçanërisht me komponime azotike ose fosforike që shkakton zhvillim të shtuar të algave dhe llojeve më të larta bimore, që krijojnë prishje të padëshirueshme të baraspeshës së organizmave të pranishëm në ujë dhe të kualitetit të këtij uji.

“Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujqore” përmban inventarin publik ku regjistrohen të gjitha dhënat për ujërat nëntokësore, ujërat sipërfaqësore dhe zonat e mbrojtura.

“KKU” është Këshilli Kombëtar i Ujit.

“Kontrollet e shkarkimeve” janë kontrollet që kërkojnë një kufi specifik të shkarkimit, për shembull një vlefhtë kufi të shkarkimit ose ndryshe specifikimin e kufijve apo kushteve mbi efektet, natyrën ose karakteristika të tjera të një emisioni ose kushtet operationale, të cilat ndikojnë në shkarkimet.

“Kufijtë territorialë të menaxhimit” janë kufijtë artificialë të miratuar për arsye menaxhimi, brenda të cilëve përrfshihen një ose më shumë basene apo pjesë basenesh hidrografike.

“Liqen” është një trup me ujëra të brendshme sipërfaqësore dhe nëntokësore të qëndrueshme.

“Lumë” është një trup ujqor i brendshëm, me ujë, që në pjesën më të madhe të tij rrjedh mbi sipërfaqen e tokës, por që në një pjesë të rrjedhës së tij mund të rrjedhë edhe nën tokë.

“Ndotës” është çdo substancë e rrezikshme që shkakton ndotje, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 óPër mbrojtjen e mjedisit.

“Ndotje” është futja e drejtpërdrejtë ose jo, si rezultat i veprimtarisë së njeriut, e substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë apo zhurmës në ajër, ujë apo tokë, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për cilësinë e mjedisit ose shëndetin e njeriut, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësojë dhe të ndërhyjë në shërbimet e përdorimet e tjera të ligjshme të mjedisit, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 óPër mbrojtjen e mjedisit.

“Normë e cilësisë së mjedisit për ujërat” është përqendrimi i një substance ndotëse të veçantë ose i një grupi substancash ndotëse në ujë, në sedimente ose në biotë.

“Normë e cilësisë së ujërave nëntokësore” është norma mjedisore, teknike dhe shëndetësore që shprehet si përqendrim i një substance ndotëse të veçantë apo i një grupi substancash ndotëse ose si tregues i ndotjes së ujërave nëntokësore.

“Normë teknike e shkarkimit në mjedis” janë kufijtë e vlerave dhe të përqendrimeve të parametrave fiziko-kimikë të ujërave të ndotura industriale, të cilat derdhen në sistemin e

²¹ Shënim: Për përkufizimet janë përdorur Ligjin nr. 111/2012 Për menaxhimin e integruar të burimeve ujqore, ói ndryshuar, Ligji nr. 24/2017, óPër administrimin e ujitjes dhe kullimit dhe Ligji nr. 10433, dt.16.06.2011 óPër Inspektimin në Republikën e Shqipërisë

kanalizimeve publike, sipas kuptimit të dhënë në vendimin nr. 1340, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave OPër miratimin e rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës - kanalizimeve.

“Përdorues” është çdo rreth, bashki, komunë, fshat, shoqatë e përdoruesve të ujit, ndërmarrje shtetërore apo private, person fizik dhe juridik, që merret me eksplorimin, prodhimin, përdorimin e burimeve ujore, shkarkon, trajton apo kryen çdo lloj aktiviteti tjetër në fushën e menaxhimit të ujërave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

“Përdorim i ujit” janë shërbimet e ujit, si eksplorimi, prodhimi, përdorimi i burimeve ujore, shkarkimi, trajtimi apo kryerja e çdo lloj aktiviteti tjetër në fushën e menaxhimit të ujërave, duke pasur një impakt të rëndësishëm mbi statusin e ujit.

“Rrjedhje minimale ekologjike” është regjimi i rrjedhjes në një trup ujqor sipërfaqësor, shtrat lumor, basen ujqor apo zonë bregdetare, e nevojshme për të ruajtur një qëndrueshmëri të ekosistemit natyror dhe përfitimeve të tyre.

“Status ekologjik” është shprehja e cilësisë së strukturës dhe funksionimit të ekosistemeve ujore, që lidhen me ujërat sipërfaqësore dhe klasifikohet në përputhje me akte të veçanta ligjore.

“Status i ujërave nëntokësore” është shprehja e përgjithshme e statusit të një trupi ujqor nëntokësor, që përcaktohet nga statusi referuar limiteve të sipërme të standardit, siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi.

“Status i ujërave sipërfaqësore” është shprehja e përgjithshme e gjendjes së një trupi ujqor sipërfaqësor, që përcaktohet nga gjendja e tij ekologjike, cilësore dhe kimike më e varfër.

“Status sasior” është shprehja e masës, në të cilën një trup ujqor nëntokësor ndikohet nga nxjerrjet e drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta.

“Standarde të cilësisë mjedisore” është përqendrimi i ndotësve të veçantë ose i grupit të ndotësve në ujë, sedimente ose biota, i cili nuk duhet të tejkalohet, me qëllim mbrojtjen e shëndetit njerëzor dhe të mjedisit.

“Shkarkim në ujë” janë shkarkimet në trupat ujqorë, ku përfshihen shkarkimet në rrjetin e tubacioneve të ujërave të ndotura dhe të shiut.

“Shkarkime industriale” janë mbetjet e lëngshme, të cilat prodhohen pas proceseve të ndryshme industriale, me rrezik kontaminimi ose ndotjeje të mjedisit ku ato shkarkohen.

“Trajtim i kombinuar” është kontrolli i shkarkimeve dhe derdhjeve në ujërat sipërfaqësore, sipas mënyrës së trajtimit të përcaktuar në akte nënligjore të veçanta.

“Trup me ujëra nëntokësore” është ai formacion gjeologjik që ka aftësinë e ujëmbajtjes në një vëllim dhe kusht të caktuar dhe që përbën një akuifer.

“Trup ujqor artificial” është trupi ujqor sipërfaqësor i krijuar nga veprimtaria njerëzore, si rezervuar, depo ruajtjeje, kanal, pellg për rritje peshku.

“Trup ujqor sipërfaqësor” është një element i dallueshëm dhe i rëndësishëm i ujërave sipërfaqësore, p.sh. një liqen, rezervuar, përrua, lumë ose kanal, një pjesë e një përroi, lumi ose kanal, ujëra të përkohshme ose një shtrirje e ujit bregdetar.

“Ujërat e ndotura industriale” janë të gjitha ujërat e përdorura që shkarkohen nga mjediset që përdoren për të zhvilluar veprimtari tregtare ose industriale, të cilat nuk janë ujëra të përdorura shtëpiake apo rrjedha të ujërave të shiut.

“Ujërat e ndotura shtëpiake” janë ujërat e përdorura nga zonat rezidenciale dhe sektori i shërbimeve, që e kanë origjinën kryesisht nga metabolizmi i njeriut dhe veprimtaritë e sektorit shtëpiak.

“Ujërat e ndotura urbane” janë ujërat e përdorura shtëpiake ose një përzierje e ujërave shtëpiake me ujëra të ndotura industriale dhe rrjedhat nga ujërat e shirave.

“Uji i përdorur industrial” është uji i prodhuar nga proceset e ndryshme industriale, i cili mund të jetë me rrezik kontaminimi apo ndotjeje për mjedisin në të cilin ai shkarkohet.

“Ujëra bregdetare” janë ujërat sipërfaqësore, të cilat ndodhen në brendësi të një vije imagjinare, e cila është e baraslarguar në secilën nga pikat e saj 1 milje detare nga pjesa e jashtme e pikës më të afërt të vijës bazë dhe që shërben si referim për të përcaktuar shtrirjen e ujërave territoriale dhe që shtrihen eventualisht deri në kufirin e jashtëm të ujërave transitore.

“Ujëra nëntokësore” janë të gjitha ujërat që ndodhen nën sipërfaqen e tokës apo kanë dalje të drejtpërdrejta në sipërfaqen e tokës në formën e burimeve natyrore.

“Ujëra sipërfaqësore” janë ujërat e brendshme, me përjashtim të ujërave nëntokësore, ujërat e

përkohshme, ujërat bregdetare dhe ujërat territoriale.

“Sistem ujitjeje” është një rrjet kanalesh ujitëse, së bashku me veprat përkatëse hidroteknike, rezervuarët, digat, strukturat devijuese, stacionet e pompave, rrugë, ndërtesa të furnizuara nga një kanal parësor ose një rezervë ujore parësore, për ujitjen e një sipërfaqeje toke. Sistemi i ujitjes përfshin edhe tokën bashkëngjitur me kanalet e ujitjes, e cila është mbajtur nën pronësinë e shtetit për sigurimin e aksesit në kanale të tilla.

“Kanal kryesor ujitës” është kanali ujitës që transporton ujë nga një lumë, përrua, rezervuar ose burime të tjera ujore drejt një ose më shumë sistemeve ujitëse dhe çdo stacioni pompimi mbi ose të lidhur me këtë kanal.


“Rezervuar” është rezervë artificiale uji, formuar nga akumulimi ose bllokimi i ujit me anë të një dige.

“Inspektim” është çdo formë kontrolli që organi publik kryen për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit.

“Inspektorati shtetëror” është institucioni qendror i ngarkuar me një apo disa funksione inspektimi në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore.

2.6 Skema e analizës së programit auditues

Skema 1: Modeli Input në Output



2.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore

Gjatë fazës studimore, stafet përgjegjëse të AMBU, AKM dhe MBZHR i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë pyetësorëve të dërguar nga grupi i auditimit, ndërsa për plotësimin e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar që lidhet me vjeljen e të dhënave plotësuese mbi

subjektet, kërkuar më shumë kohë në përgjigjet e tyre kjo edhe për shkak të kompleksitetit të çështjes nën auditim si dhe ngarkesës e volumit të materialeve.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, pra AMBU, AKM dhe MBZHR kanë të bëjnë *me vështirësitë dhe pengesat* që këto institucione hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi. Ato lidhen kryesisht me risqe të jashtme dhe të brendshme. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në Udhëzuesin e Vlerësimit të Riskut të Gjykatës Evropiane të Llogarive.²² Në tabelën në vijim janë grupuar risqet sipas nivelit strategjik dhe operacional. Janë marrë në konsideratë vetëm risqet e nivelit mesatar dhe të lartë, si dhe është analizuar niveli i vështirësisë që hasin subjektet në tejkalimin e këtyre risqeve. Për të përcaktuar nivelin e riskut, grupi i auditimit është bazuar në SKMIBU, Programet Kombëtare të Monitorimit në Mjedis për vitet 2019, 2020, 2021, në Raportet e Gjendjes në Mjedis të 2019 dhe 2020, aktet nënligjore dhe rregulloret e brendshme të institucioneve subjekt auditimi të cilat jo gjithmonë janë të sinkronizuara me aktet ligjore/nënligjore dhe evidentimin paraprak të mangësive logjistike të këtyre institucioneve. Në funksion të përmbushjes së kësaj kornize, është lidhur secili risk me pyetjet audituese që drejtojnë këtë program auditimi.


Tabela nr. 6: Analiza e Riskut

Op / Str	Përshkrimi i Riskut	Niveli i Riskut	Pyetja e Auditimit	Efektet që mund të kenë risqet e indentifikuara	Realizuesh mëria
Strategjik	Mungesa e Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore. Mungesa inventarit të burimeve ujore Mungesa e përcaktimit të objektivave mjedisore për ujërat nëntokësorë	L	A kanë hartuar dhe miratuar institucionet përgjegjëse politika të duhura për menaxhimin e burimeve ujore?	Mos hartimi i politikave ose mos hartimi i politikave të duhura ndikon në organizim dhe menaxhim jo të mirë të përdorimit të burimeve ujore, sjell keqpërdorim dhe dëmtim të tyre duke ndikuar në aspekte social ekonomike dhe mjedisore.	Vështirë
	Aktet nënligjore që rregullojnë procesin e monitorimit, kontrollit dhe inspektimit të burimeve ujore, nuk janë të përditësuara dhe mund të mos jenë në koherencë me ligjin nr. 111/2012 ôi ndryshuarô.	L	A janë aktet nënligjore të përditësuara dhe në koherencë me kuadrin ligjor kryesor për menaxhimin e burimeve ujore?	Aktet nënligjore të pa përditësuara dhe jo në përputhje/koherencë me ligjin bazë të menaxhimit të burimeve ujore vështirësojnë punën e strukturave të monitorimit, kontrollit dhe inspektimit, kanë ndikim në zbatueshmërinë e përcaktimeve ligjore si dhe mund të sjellin mbivendosje përgjegjësish apo mos përfshirje të çështjeve specifike aktuale që ndikojnë në burimet ujore.	Vështirë
	Mbështetja financiare e përshkruar gjerësisht në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore nuk është siguruar e plotë dhe në nivelet e parashikuara sipas produkteve dhe aktiviteteve.	M	A është siguruar mbështetje financiare nga buxheti i shtetit për të përmbushur aktivitetet e institucioneve përgjegjëse lidhur me menaxhimin e burimeve ujore?	Mungesa e mbështetjes së plotë financiare do të bënte të vështirë ose të pamundur arritjen e objektivave të përcaktuara në SKMIBU dhe si rezultat do të përkeqësonte gjendjen e burimeve ujore të vendit tonë dhe cilësinë e ujit të tyre.	Normale
Operacional	AMBU mund të ketë mungesa të arkëtimeve nga përdorimi i ujit, mos pagesave e detyrimeve nga përdoruesit e ujit si dhe nga veprimtaria informale e përdoruesve të ujit.	L	A është siguruar arkëtimi i pagesave administrative dhe tarifave të përdorimit të ujërave?	Mungesa e të ardhura që duhet të sigurohen nga përdorimi i burimeve ujore ndikon drejtpërsëdrejti në mbështetjen financiare që duhet të shkojë për përmbushjen e objektivave specifike apo për të përmirësuar performancën e strukturave të AMBU-së.	Normale
	Nuk ka një përshkrim të saktë të metodologjisë së ndjekur për monitorimin e ujërave. Bashkëpunimi dhe koordinimi midis strukturave përgjegjëse për monitorimin e ujërave mund të mos jetë efektiv.	L	A janë koordinuar midis tyre institucionet përgjegjëse lidhur me procesin e monitorimit të burimeve ujore?	Mungesa e një koordinimi efektiv dhe monitorimi aktiv nga strukturat përgjegjëse sjell që AMBU nuk ka informacion lidhur me nivelin e përmbushjes së objektivave, lidhur me problematikat reale që hasen në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve ujore, me qëllim marrjen e vendimeve të duhura/rikuperuese.	Vështirë
	Strukturave përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin e ujërave mund të mos bashkëpunojnë midis tyre si duhet. Struktura e inspektimit mund të mos mbështetet me logjistikë dhe burimeve njerëzore të mjaftueshme për kryerjen e kontrolleve dhe inspekte.	L	A kanë në dispozicion strukturat e kontrollit dhe inspektimit të burimeve ujore logjistikën e nevojshme dhe burimet njerëzore dhe a janë koordinuar midis tyre për realizimin e detyrave kontrolluese dhe inspektuese?	Mos bashkëpunimi/koordinimi i strukturave përgjegjëse, mungesa në mjete logjistike dhe burime njerëzore, sjell që misioni i inspektimeve të mos realizohet, të rriten rastet e mos zbatimit të detyrimeve ligjore, të favorizohet aktiviteti i paligjshëm, të gjitha këto kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përdorimin e burimeve ujore, në të ardhurat e pritshme nga përdorimi i burimeve ujore si dhe në cilësinë e ujit.	Vështirë

3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë "Menaxhimi i burimeve ujore" ka si objektiv kryesor vlerësimin e politikave si dhe efektivitetin e eficiencës të institucioneve përgjegjëse duke u fokusuar kryesisht në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, administrimin e tyre dhe informacionet mbi to që janë njëkohësisht edhe objektivat kryesorë strategjikë. Në këtë mënyrë është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektivi nëse burimet publike janë menaxhuar me përgjegjësi dhe nëse janë arritur rezultatet e dëshiruara. Me anë të këtij objektivi kemi mundur të konkludojmë se deri në çfarë mase ka qenë efektive dhe efiçiente veprimtaria e institucioneve subjekt auditimi lidhur me menaxhimin e burimeve ujore për periudhën 2018-2021.

3.3 Pyetjet e auditimit



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka patur si fushëveprimi analizimin dhe dhënien e një opinionit mbi efektivitetin e menaxhimit të burimeve ujore duke u fokusuar kryesisht në ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore, dhe duke u përqendruar në cilësinë dhe administrimin e tyre. Çështje që kanë të bëjnë me përmbytjet, ujin e pijshëm, ujërat ndërkuftare, ujërat detare dhe kanalizimet nuk kanë qenë pjesë e objektit të këtij auditimi pasi ato janë audituar ose do të auditohen në auditime të tjera. Tema e auditimit në vetvete është komplekse, (kujtojmë se sipas Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, lidhur me menaxhimin e burimeve ujore janë të implikuara direkt/indirekt rreth 50 institucione të ndryshme) ndaj, krahas dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e situatës, një sy do të mbahet edhe për auditime të tjera që mund të vijnë pas këtij. Periudha e auditimit do të jetë 2018-2021. Siç u përmend edhe në kapitujt e

mësipërm subjektet kryesore ku është fokusuar ky auditim janë AMBU (së bashku me ZABU me seli në Tiranë, Shkodër, Fier dhe Vlorë në të cilat janë kryer edhe vizita në terren), AKM dhe MBZHR. Qëllimi i këtyre vizitave ka qenë për të parë nga afër procedurat e kontrollit të subjekteve që janë/duhet të jenë pajisur me leje përdorimi të ujit si dhe të nxirren statistika të cilat do të shërbejnë për plotësimin e fakteve, evidencave mbi të cilat do të bazohen gjetjet e auditimit.

Ky auditim është zhvilluar nën mbikëqyrjen e Institucionit Suprem të Auditimit të Norvegjisë. Rezultatet e këtij auditimi do të shërbejnë për auditimet e performancës në vijim, për tema që lidhen me burimet ujore dhe ndikimin e tyre në mjedis.

4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE

Mesazhi i auditimit

Masat e marra nga institucionet përgjegjëse lidhur me menaxhimin e përdorimit të burimeve ujore kanë qenë pjesërisht efektive dhe eficiente. Edhe pse, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore si një institucion i krijuar në vitin 2018 ka bërë hapa pozitivë në kuadër të përmirësimit të situatës në tërësi, evidentohen mangësi në plotësimin e kuadrit ligjor me akte nënligjore, ose akte nënligjore të pa përditësuara dhe që nuk përputhen me Ligjin nr. 111/2012 për menaxhimin e integruar të burimeve ujore dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 6/2018, datë 8.2.2018. Aktivitetet e parashikuara për arritjen e objektivave strategjike për menaxhimin e ujit, nuk u mbështetën me buxhetet e nevojshme, pasi për periudhën nën auditim u alokuan 60% më pak fonde se ato të nevojshme referuar Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (SKMBIU), çka përmban riskun e mos zbatimit me efektivitet të tyre. Për periudhën 2018-2021, nuk janë hartuar Raporte Vjetore të Monitorimit mbi implementimin e SKMBIU dhe planit të parë të veprimit duke mos adresuar shkaqet që kanë cënuar zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë, siç është edhe mungesa e fondeve. AMBU nuk ka arritur të maksimizojë mbledhjen e të ardhurave të veta, prej mos aplikimit për leje të subjekteve private dhe publike që aktualisht përdorin burimet ujore, por edhe si pasojë e mosarkëtimit të debitorëve (edhe pse vihet re një përmirësim i situatës për periudhën në auditim krahasuar me periudhën e para vitit 2018). Numri i subjekteve që përdorin burime ujore pa leje për qëllime dhe aktivitete të ndryshme vazhdon të jetë shumë herë më i lartë se ata që janë me leje/autorizim dhe që faturohen/arkëtohen nga AMBU. Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional, veçanërisht sa i përket kontrollit dhe inspektimit të përdoruesve të jashtëligjshëm të burimeve ujore, por dhe mungesa e burimeve njerëzore e logjistike në institucionet përgjegjëse, janë ndër arsyt kryesore të një menaxhimi jo efektiv të burimeve ujore në vend.

Pyetja kryesore: A ka qenë eficiente veprimtaria e institucioneve përgjegjëse drejt menaxhimit të integruar të burimeve ujore për periudhën 2018-2021?

4.1 A ekziston një kuadër ligjor dhe rregullator i plotë dhe me ndarje të qarta të roleve dhe përgjegjësi mes aktorëve të përfshirë?

4.1.1 A kanë hartuar dhe miratuar institucionet përgjegjëse politika të duhura për menaxhimin e burimeve ujore, sipas roleve përkatëse?

Ligji nr. 111/2012 për menaxhimin e integruar të burimeve ujore dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 6/2018, datë 8.2.2018, është ligji bazë për menaxhimin e burimeve ujore. Ai ka për qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, sigurimin, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja dhe shpërdorimi si dhe përcaktimin e kuadrit institucional, për vënien në jetë të një politike kombëtare për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në të mirë të komunitetit dhe interesave sociale dhe ekonomike të vendit. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) harton dhe zbaton politika, strategji, plane, programe dhe projekte, që synojnë menaxhimin e integruar të burimeve ujore, ruajtjen sasiore dhe cilësore, si dhe konsolidimin e mëtejshëm të tyre. Zyra e Administrimit të Basenit Ujor

(ZABU) e cila është një strukturë në varësi të AMBU funksionon në çdo basen ujor dhe duhet të hartojë inventarin e burimeve ujore në sasi dhe cilësi, si dhe bën periodikisht përditësimin e tij.²³ Territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në 7 basene ujore të cilat janë Drin-Bunë, Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë.²⁴ ZABU Drin-Bunë me seli në Shkodër funksionon dhe ushtron kompetencat e saj për basenin ujor Drin-Bunë. ZABU Ishëm-Erzen-Mat me seli në Tiranë funksionon dhe ushtron kompetencat e saj për basenin ujor Ishëm, Erzen dhe Mat. ZABU Seman Shkumbin me seli në Fier funksionon dhe ushtron kompetencat e saj për basenin ujor Seman dhe Shkumbin. ZABU Vjosë me seli në Vlorë funksionon dhe ushtron kompetencat e saj për basenin ujor Vjosë.²⁵

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (SKMIBU) është një dokument planifikimi që përcakton vizionin e politikave të shtetit, misionin, qëllimet dhe objektivat në fushën e menaxhimit të integruar të ujërave për një periudhë afatgjatë. Ajo është dokumenti kuadër për menaxhimin e ujërave për zhvillimin e planeve dhe dokumenteve të tjera strategjike në fushën e planifikimit territorial, mbrojtjes së mjedisit, diversitetit biologjik dhe peizazhit, bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, transportit, turizmit, shëndetit publik dhe përmban edhe dokumente të tjera përkatëse. SKMIBU hartohet nën mbikëqyrjen e AMBU dhe marrin pjesë të gjitha institucionet e specializuara në fushën e ujërave.²⁶ Me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 73 datë 7.2.2018 është miratuar Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore për periudhën 2018-2027. SKMIBU është hartuar në mënyrë të tillë që të ofrojë një kornizë për administrimin gjithëpërfshirës të burimeve ujore, në të cilin të gjitha palët e interesit, duke përfshirë edhe sektorin privat, shoqërinë civile dhe komunitetet përdoruese, pavarësisht nga gjinia, të luajnë një rol aktiv. Kjo strategji përqendrohet në ruajtjen e burimeve ujore për brezat e ardhshëm në përputhje me kërkesat e politikave dhe rregullave evropiane për ujin dhe mjedisin. Rezultatet kryesore²⁷ të pritshme përfshijnë:

- Përdorim dhe shpërndarje të ujit në mënyrë eficiente dhe të barabartë dhe një rritje thelbësore në eficiencën e përdorimit të ujit në të gjithë sektorët me qëllim shfrytëzimin, riciklimin dhe ripërdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore;
- Ulje të ndotjes nëpërmjet moslejimit të shkarkimeve të paligjshme dhe kufizimit të shkarkimeve të lëndëve kimike të rrezikshme në trupa ujorë (niveli i saktë i uljes do të jetë në funksion të numrit dhe natyrës të këtyre shkarkimeve);
- Rritjen e qëndrueshmërisë dhe aftësisë për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve që vijnë nga katastrofat natyrore;
- Një njohje të thellë të të gjitha burimeve ujore në vend, duke ofruar kështu një bazë njohurish publike për vendimet (politikat), lidhur me menaxhimin e integruar të burimeve ujore;
- Politika të qarta MIBU dhe zbatim të PMBU-së që synon a) objektiva të matshme në afate kohore të caktuara, në nivele të duhura, dhe b) përcaktimin e qartë të përgjegjësisë të autoriteteve, duke u bazuar në një monitorim dhe vlerësim efektiv.

Planet e menaxhimit të baseneve ujore hartohen në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe zbatohen për çdo basen ujor dhe periudhë të përcaktuar. Ato miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe rishikohen çdo 6 vjet.²⁸ Me anë të VKM nr. 849, datë 4.11.2020 është miratuar plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Drin-Bunë, ndërsa me anë të VKM nr. 453 datë 10.06.2020 është miratuar plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Seman.

²³ Ligji nr. 111/2012 për menaxhimin e integruar të burimeve ujore nënien 13 pika 2, b, i ndryshuar.

²⁴ Vendim nr. 696, datë 30.10.2019 për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre

²⁵ Urdhër i Kryeministrit nr. 152 datë 1.10.2018 për miratimin e strukturës dhe organikës së AMBU

²⁶ Ligji nr. 111/2012 për menaxhimin e integruar të burimeve ujore nënien 16, i ndryshuar.


²⁷ Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore, fq. 5.

²⁸ Ligji nr. 111/2012 për menaxhimin e integruar të burimeve ujore nënien 17, i ndryshuar.

Direktiva Kuadër e Ujit 2000/60/EC, mbi të cilën është transpozuar edhe ligji ynë mbi menaxhimin e burimeve ujore e përkufizon ujin si një produkt jo komercial, por si një trashëgimi e cila duhet mbrojtur dhe trajtuar si e tillë. Neni 5 i kësaj Direktive flet për karakteristikat e basenit lumor, rishikimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor dhe analizat ekonomike të përdorimit të ujit. Sipas këtij neni, çdo vend anëtar i BE-së duhet të garantojë për çdo basen ujqor një analizë të karakteristikave të këtij baseni, një vlerësim të ndikimit njerëzor në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe analiza ekonomike të përdorimit të ujit. Neni 5 i Direktivës Kuadër e Ujit 2000/60/EC është transpozuar me nenin 29 pika 1 të Ligjit nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreó, ói ndryshuaró në të cilin theksohet se Zyra e Administrimit të Basenit Ujqor kryen për çdo basen ujqor përkatës vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe analizën ekonomike të përdorimit të ujërave.

Një tjetër çështje në të cilën grupi i auditimit është fokusuar është edhe matësi automatik i ujit i cili duhet vendosur në çdo burim ujqor nga përdoruesit si dhe elementët që duhet të plotësojnë këta matës për të lexuar sa më saktë ujin që përdoret. Ligji nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreó i ndryshuar, neni 53, pika 2 germa óçó thekson se përdoruesi i burimit ujqor duhet të instalojë ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organi përkatës që ka lëshuar lejen, autorizimin apo koncesionin. Gjithashtu në nenin 72 pika të po këtij ligji, AMBU (nëpërmjet ZABU) në bashkëpunim me inspektoratin që mbulon çështjet e mjedisit, kanë të drejtë të mbikëqyrin e të detyrojnë subjektet, persona fizikë apo juridikë, për instalimin e pajisjeve për mbajtjen nën kontroll dhe matjen e sasisë së përdorimit të ujit në tokë private, si dhe të servituteve që nevojiten për hyrjen në instalime të tilla, për punën përgatitore dhe për ndërtimin. Krahës sa më sipër, kuadri ligjor e rregullator mbi menaxhimin e burimeve ujore nuk shprehet për çështje që kanë të bëjnë me elementët e sigurisë që matësit automatik duhet të plotësojnë. Nga konstatimet e grupit të auditimit dhe vëzhgimet në terren subjektet përdorues të burimeve ujore mjaftohen duke vendosur matës automatik të thjeshtë pa asnjë normë apo element sigurie. Matësit mund të jenë të llojeve, markave apo edhe vit prodhimeve të ndryshme (figura nr. 1).

Foto nr. 1. Matës automatik të ujit të ndryshëm në subjekte të ndryshme



Burimi: Grupi i auditimit

Gjetje nga auditimi

1. AMBU harton planet e menaxhimit të baseneve ujore, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të cilat zbatohen për një territor dhe periudhë të përcaktuar dhe rishikohen çdo gjashtë vjet. Nga auditimi rezultoi se, edhe pse kanë kaluar 10 vjet që nga hyrja në fuqi e Ligjit nr. 111/2012 *ô*Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore²⁹ ende nuk janë hartuar dhe miratuar Planet e Menaxhimit për basenet ujore Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin dhe Vjosë. Mungesa e planeve të menaxhimit të baseneve në fjalë, ndër të tjera ka lënë jashtë fokusit evidentimin dhe vlerësimin e ndikimeve të ndotjes në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore nga bujqësia, erozioni, hidrocentralet dhe mbetjet e ngurta.
2. Zyra e Administrimit të Basenit Ujor (ZABU) kryen për çdo basen ujor përkatës vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, analizën ekonomike të përdorimit të ujërave, si dhe analiza pas monitorimeve të kryera nga subjektet e kontraktuara nga ministria përgjegjëse për mjedisin. Gjithashtu analizat dhe vlerësimet e përcaktuara më sipër do të kryhen pas miratimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe do të përditësohen rregullisht. Nga auditimi rezultoi se, nga të gjitha ZABU-të, nuk është kryer asnjë vlerësim i ndikimit në mjedis dhe as analiza të tjera sikundër kërkohen në përputhje me karakteristikat e baseneve respektive, duke mos siguruar kështu një bazë të shëndoshë për të zhvilluar më tej plane masash që kanë për qëllim arritjen e objektivave mjedisore.
3. Normat e cilësisë së mjedisit për ujërat përcaktohen për të gjitha ujërat, përfshirë edhe ujërat nëntokësore. Nga auditimi rezultoi se, AMBU nuk ka përcaktuar normat e cilësisë së mjedisit, për ujërat nëntokësore²⁹, por vetëm normat e cilësisë për përcaktimin e statusit kimik të ujërave nëntokësore³⁰. Ujërat nëntokësore janë burim potencial i ndotjes dhe ndikimeve të ndryshme në aktivitete si natyrore ashtu edhe njerëzore, ndaj është shumë e rëndësishme që për të patur një tablo të qartë të gjendjes së tyre fillimisht të përcaktohen normat e cilësisë së mjedisit edhe për to.
4. Për ujin e pijshëm Shoqëritë e Ujësjellës Kanalizimeve në rregulloret e tyre të brendshme kanë përcaktuar se matësat e ujit duhet të vulosen dhe plumbosen nga specialistët e tyre.³¹ Nga auditimi rezultoi se, sa i përket burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore, nga vizitat në terren që grupi i auditimit ka zhvilluar, matësit automatik që janë gjetur në përdorim nuk plotësojnë asnjë element sigurie. I gjithë kuadri ligjor dhe rregullator lidhur me përdorimin e burimeve ujore nuk parashikon dhe nuk përcakton elementët e sigurisë që duhet të plotësojnë matësit automatik të ujit. Duke mos saktësuar elementët e sigurisë që duhet të kenë matësit automatik të ujit, risku i abuzimit me ujin rritet.
5. Ministri përgjegjës për mjedisin, në bashkëpunim me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, (AMBU) harton aktet përkatëse nënligjore për shpalljen e zonave në rrezik nga ndotja prej elementeve apo substancave të dëmshme, si *nitratet, fosfatet, produktet për mbrojtjen e bimëve, biocidet* dhe i paraqet për miratim në Këshillin Kombëtar të Ujit³². Nga auditimi rezultoi se nuk ka patur asnjë bashkëpunim mes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, dhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore për marrjen e masave për shpalljen e zonave në rrezik nga ndotja prej elementeve apo substancave të dëmshme. Hartimi i akteve të mësipërme, fillimisht kërkon identifikimin e zonave në rrezik nga ndotja, i cili lidhet me rezultatet e monitorimit, përgjegjësi kjo e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Nga auditimi rezultoi se, elementët dhe/ose substancat që duhen monitoruar me qëllim identifikimin dhe

²⁹ Ligji nr. 111/2012 *ô*Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore²⁹ neni 28 pika 2

³⁰ VKM nr. 1015, datë 16.12.2020 *ô*Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbajtjet³⁰, pika 2.3.1.

³¹ <https://www.shuk.al/sarande/lajme/njoftim-qytetareve-reformen>

³² Ligji nr. 111/2012 *ô*Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore³² neni 35 pika 1

shpalljen e zonave të tilla, aktualisht nuk përfshihen në programet e monitorimit të AKM (me përjashtim të nitrates dhe fosfates). Në mungesë të të dhënave për këto elementë, nuk është i mundur identifikimi dhe për pasojë as shpallja e këtyre zonave si të tilla.

6. Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të AMBU hartohet nga Drejtori i Përgjithshëm i saj dhe miratohet nga Kryeministri.³³ Nga auditimi rezultoi se, kjo rregullore ende nuk është miratuar edhe pse është hartuar që në vitin 2019. Mungesa e një rregulloreje të miratuar, rrezikon të çënojë arritjen e objektivave dhe përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësi që ky institucion ka në lidhje me menaxhimin e burimeve ujore.

Konkluzione

1. Aktualisht, në Republikën e Shqipërisë vetëm 2 nga 7 basenet ujore (Baseni i Drinit dhe Semanit) kanë plane menaxhimi, të miratuar.
2. ZABU nuk ka kryer për asnjë basen ujor vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, dhe as analizën ekonomike të përdorimit të ujërave.
3. AMBU nuk ka përcaktuar normat e cilësisë së mjedisit për ujërat nëntokësore, duke mos marrë asnjë masë për parandalimin e përkeqësimit të cilësisë së këtyre ujërave.
4. Matësit automatik të përdorimit të burimeve ujor, nuk i nënshtrohen asnjë kërkesë të detyrueshme ligjore mbi elementët e sigurisë që ky aparat duhet të ketë, në mënyrë që të jap siguri mbi matjen e saktë të sasisë së ujit të përdorur.
5. MTM dhe AMBU, ende nuk i kanë shpallur zonat në rrezik nga ndotja prej elementeve apo substancave të dëmshme, si *nitratet, fosfatet, produktet për mbrojtjen e bimëve dhe biocidet*.

Rekomandime

- 1.1 AMBU të marrë masa për të hartuar Planet e Menaxhimit për basenet ujore Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin dhe Vjosë në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore me qëllim menaxhimin e integruar të burimeve ujore që ndodhen në territorin e këtyre baseneve.

Në vijimësi

- 2.1 AMBU të marrë masa që nëpërmjet ZABU-ve të kryejë vlerësimin e ndikimit njerëzor në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe analizat ekonomike për përdorimin e ujërave, duke vendosur afate konkrete, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe eficiencë të burimeve ujore.

Në vijimësi

- 3.1 AMBU të përcaktojë normat e cilësisë së mjedisit për ujërat nëntokësore me qëllim parandalimin e përkeqësimit të cilësisë së ujërave nëntokësore duke patur në konsideratë përveç karakterit kimik ashtu dhe atë biologjik (baktereologjik).

Brenda datës 31.03.2023

- 4.1 AMBU të iniciojë rishikimin e kuadrit ligjor/rregullator me qëllim përcaktimin e saktë të elementëve të sigurisë që duhet të plotësojnë matësit automatik (sahatet) të përdorimit të burimeve ujore, me qëllim shmangien e abuzimit me përdorimin e tyre.

Brenda datës 31.12.2022

- 5.1 AMBU në bashkëpunim me AKM, të marrë masa për përfshirjen në programet e monitorimit të burimeve ujore, të matjes dhe vlerësimit të elementëve apo substancave të dëmshme, produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe biocideve. Pas rezultateve nga monitorimi, AMBU të hartojë aktet përkatëse nënligjore për shpalljen e zonave në rrezik nga ndotja prej elementeve apo substancave të dëmshme, si nitratet, fosfatet, produktet për mbrojtjen e bimëve, biocidet.

Brenda datës 31.12.2022 dhe në vijimësi

- 6.1 AMBU të ndjekë me prioritet dhe të drejtohet përsëri zyrtarisht Kryeministrit me qëllim miratimin e Draft Rregullores së Brendshme të funksionimit.

³³ VKM nr. 221, datë 26.04.2018 Për organizimin dhe funksionimin e AMBU-së kreu 2, pika 6

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga AMBU është paraqitur *observacioni me shkresë nr. 107/9 prot. datë 08.08.2022 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga Znj. G. L, me pozicion Drejtor i Përgjithshëm i AMBU*, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me gjetjen nr. 3, konkluzionin nr. 3 dhe rekomandimin nr. 3.1, në vijim të përcjelljes së projekt-raportit të auditimit, AMBU thekson se në VKM-në nr. 1015 datë 16.12.2020 për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, përcaktohen veç të tjerash edhe normat e cilësisë për ujërat nëntokësore (VKM kjo e hartuar dhe e propozuar nga AMBU). Në aneksin 5 të kësaj VKM-je, pjesa 2, çështja 2.3.1, Parametrat për përcaktimin e statusit kimik të ujërave nëntokësore, përcaktohet se këta parametra janë:

- Konduktiviteti;
- Përqendrimit e ndotësve;

Në tabelat më poshtë (pjesë e VKM-së) jepen normat e cilësisë për trupat ujorë nëntokësore për këta parametra.

Ndotësi	Norma e cilësisë
Nitratet	50mg/l
Substancat aktive të pesticidet, përfshirë metabolitët (substancat e lidhura me metabolizmin) e tyre përkatës, produktet e degradimit dhe reaksionit	0.1µg/l 0.5µg/l (total) Ku totali nënkupton shumën e të gjitha pesticideve individuale të zbuluara dhe me sasi të përcaktuar në procedurat e monitorimit, duke përfshirë metabolitët e tyre përkatës, produktet e degradimit dhe të reaksionit

Elementet	Statusi i mirë
Të përgjithshme	Përbërja kimike e trupit me ujëra nëntokësore është e tillë që përqendrimit e ndotësve: • siç specifikohet më poshtë, nuk shfaqin efekte të kripësisë ose futjeve të tjera • nuk tejkalojnë normat e aplikueshme të cilësisë të zbatueshme sipas legjislacioneve të tjera • nuk janë të tilla që të rezultojnë në mos përmbushjen e objektivave mjedisore të specifikuar sipas aneksit 3 për trupat me ujëra sipërfaqësore përkatës, në asnjë reduktim të rëndësishëm të cilësisë ekologjike ose kimike të këtyre trupave dhe as në ndonjë dëmtim të rëndësishëm të ekosistemeve tokësore që varen direkt nga trupi me ujëra nëntokësore
Konduktiviteti	Ndryshimet në konduktivitet nuk janë treguese të kripësisë ose futjeve të tjera në trupin me ujëra nëntokësore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Si fillim, duhet të theksojmë se kjo gjetje bazohet në përgjigjen e AMBU (email dt 24.02.2022) lidhur me pyetjen nr. 2 të pyetësorit të grupit të auditimit. Duhet të sqarojmë se gjetja nr. 3 së bashku me konkluzionin dhe rekomandimin përkatës që e pasojnë atë i referohen **normave të cilësisë së mjedisit për ujërat nëntokësore**. Ndërsa, AMBU në

observacionin e saj lidhur me këtë gjetje i referohet **parametrave për përcaktimin e statusit kimik të ujërave sipërfaqësore. Statusi kimik i ujërave nëntokësore dhe norma e cilësisë së ujërave nëntokësore nuk janë e njëjta gjë.** Në nenin 4 të Ligjit nr. 111/2012 *ó*Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore^ó përkufizohen:

- *ó*Normë e cilësisë së ujërave nëntokësore^ó është norma mjedisore, teknike dhe shëndetësore që shprehet si përqendrim i një substance ndotëse të veçantë apo i një grupi substancash ndotëse ose si tregues i ndotjes së ujërave nëntokësore.
- *ó*Status i mirë i ujërave nëntokësore^ó është statusi i arritur nga një trup me ujëra nëntokësore, kur si statusi i tij sasior, ashtu edhe statusi i tij kimik vlerësohen të paktën po aq *ó*të mirë^ó, siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi.
- *ó*Status i mirë kimik i ujërave nëntokësore^ó është statusi kimik i një trupi ujor nëntokësor që vlerësohet po aq *ó*i mirë^ó, siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi.

Pika 2.3.1 *ó*Parametrat për përcaktimin e statusit kimik të ujërave nëntokësore^ó e VKM nr. 1015 datë 16.12.2020 *ó*Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet^ó, në të cilën AMBU bazohet në observacionin e saj, nuk përcakton normat e cilësisë së mjedisit për ujërat nëntokësore por vetëm parametrat apo normat për përcaktimin e statusit kimik të ujërave nëntokësore. Krahës elementit kimik që sigurisht është shumë i rëndësishëm për cilësinë e ujërave nëntokësore edhe elementi biologjik (baktereologjik) ka rëndësinë e tij në cilësinë e ujërave nëntokësore³⁴. Ujërat nëntokësorë janë më pak të ndjeshëm ndaj ndotjes bakteriale se sa ujërat sipërfaqësore, sepse toka dhe shkëmbinjtë nëpër të cilët rrjedhin ujërat nëntokësore përjashtojnë ose filtrojnë shumicën e baktereve. Megjithatë, bakteret herë pas here gjejnë rrugën e tyre në ujërat nëntokësore, ndonjëherë edhe në përqëndrime të larta të rrezikshme. **Ndaj, observacioni i AMBU merret pjesërisht në konsideratë sa i përket gjetjes por megjithatë rekomandimi nuk ndryshon.**

4.1.2 A janë aktet nënligjore të përditësuara dhe në koherencë me kuadrin ligjor kryesor për menaxhimin e burimeve ujore?

Në këtë pyetje audituese grupi i auditimit ka adresuar çështje që kanë të bëjnë me përditësimin dhe përshtatshmërinë të akteve nënligjore duke u fokusuar më së shumti në drejtim të monitorimit dhe kontrolleve dhe inspektimeve të burimeve ujore dhe përdoruesve të tyre. Në vazhdim, është përshkruar kuadri ligjor rregullator i cili është sot në fuqi dhe mbi të cilin grupi i auditimit ka dalë në gjetje dhe konkluzione specifike. VKM nr.1189, datë 18.11.2009 *ó*Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit^ó përcakton strukturën se si duhet hartuar Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit. Kjo VKM është mbështetur ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit". Referuar kësaj VKM, PKMM është një dokument i cili hartohet çdo vit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. PKMM përcakton treguesit kryesorë të gjendjes, të ndikimit dhe të trysnisë në ujëra sipërfaqësore e nëntokësore. Bazuar në të dhënat e parametrave të monitoruara sipas PKMM hartohet çdo vit Raporti i Gjendjes në Mjedis i cili paraqet vlerësimin e gjendjes së mjedisit për komponentët kryesor të mjedisit ku pjesë e rëndësishme janë edhe burimet ujore. Ndërkohë në Ligjin nr. 111/2012 *ó*Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore^ó i ndryshuar me Ligjin nr. 6/2018, datë 8.2.2018, në nenin 85 pika 6.1, citohet se Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, harton kërkesat për programet e monitorimit.

Lidhur me kontrollin dhe inspektimin e përdoruesve të burimeve ujore, aktualisht këto procese kryhen respektivisht nga ZABU-të të cilat kontrollojnë dhe verifikojnë respektimin e kushteve të

³⁴ <https://pubs.usgs.gov/gip/gw/quality.html>

lejeve të përdorimit të ujit nga përdoruesit, nga AKM (Drejtoria e Inspektim Kontrollit) si dhe nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.³⁵ Më konkretisht, Zyra e Administrimit të Basenit ujon ndjek zbatimin e Vendimeve (ose lejeve të përdorimit të burimeve ujore) të Këshillit Kombëtar të Ujit ose Këshillit të Basenit Ujon.³⁶ Veç kësaj, ZABU nxit pjesëmarrjen e përdoruesve të ujit në drejtim të formalizimit dhe përdorimit me leje të burimeve ujore dhe në rastet kur evidenton subjekte që shfrytëzojnë burime ujore pa leje ajo i përcjell këto raste në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. AKM, bazuar në VKM nr. 568 datë 17.07.2019 óPër krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, ndër të tjera, ka përgjegjësi funksionale inspektimin dhe kontrollin tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore. Ajo ndjek sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të mjedisit dhe ujërave.³⁷ Pra, siç mund të kuptohet nga ky përkufizim, AKM, është përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin e përdoruesve të burimeve ujore. Duhet theksuar se VKM nr. 568 datë 17.07.2019 óPër krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKM, i jep AKM-së detyra dhe përgjegjësi kontrolluese dhe inspektuese të cilat nuk i ka patur deri në këtë kohë, ose e thënë me fjalë të tjera i jep përgjegjësitë e ish ISHMP. Kujtojmë gjithashtu se VKM nr. 568 datë 17.07.2019 óPër krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKM në Kreun IV, pika 4 ka shfuqizuar VKM nr. 103, datë 4.2.2015, óPër krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve. Nga ana tjetër, në po të njëjtën datë në të cilën është krijuar AKM, me anë të VKM nr. 515, datë 17.07.2019 óPër një shtesë në Vendimin nr. 502 datë 13.09.2017, të Këshillit të Ministrave, óPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme pika 1, germa óf, Ministrisë së Brendshme i shtohet edhe kompetenca për parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e ujërave. Krahas akteve nënligjore të mësipërme, nëpërmjet aksesit në óopen data, rezulton se IKMT (e cila është institucion varësie e Ministrisë së Brendshme) është Inspektorati përkatës që sot mbulon inspektimin e burimeve ujore.³⁸ Ligji nr. Nr.10 433, datë 16.6.2011 óPër inspektimin në Republikën e Shqipërisë përcakton parimet e përgjithshme të inspektimit, organizimin e institucioneve publike, që kryejnë funksione inspektimi, statusin e inspektorëve, rregullat e procedimit administrativ të inspektimit. Inspektorati shtetëror kompetent për kryerjen e një funksioni inspektimi të parashikuar me ligj krijohet apo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Çdo inspektorat shtetëror drejtohet nga Kryeinspektori.³⁹

VKM nr. 177, datë 31.3.2005 óPër normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse e hartuar në mbështetje të Ligjit nr.9115, datë 24.7.2003 óPër trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura synon të parandalojë, të zvogëlojë dhe të shmangë ndotjen e mjedisve ujore pritëse nga substancat e rrezikshme, që shkarkohen në to përmes ujërave të ndotura, duke përcaktuar vlerat kufi për përbërësit e lejuar, sipas shtojcave, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij. Këshillat e baseneve ujëmbledhëse⁴⁰, në bashkëpunim me agjencitë rajonale të mjedisit, çdo dy vjet, përgatisin dhe publikojnë programet për parandalimin dhe shmangien e ndotjes së mjedisve ujore pritëse nën juridiksionin e tyre, nga shkarkimet e lëngëta. Në këto programe përfshihen:

- a) identifikimi i shkarkimeve të lëngëta dhe i mjedisve ujore pritëse, që ndoten;
- b) masat dhe teknikat më të mira të mundshme për zvogëlimin e ndotjes;

³⁵ Shënim: Ky institucion nuk është subjekt auditimi, por është cituar gjatë shtjellimit të pyetjes për të patur një panoramë më të plotë të procesit të inspektimit.

³⁶ Ligji nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujore neni 13, pika 2 ódh, ói ndryshuar.

³⁷ VKM nr. 568 datë 17.07.2019 óPër krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKM, Kreu III, pika 5.4, germa ód.

³⁸ <https://ikmt.gov.al/organika>

³⁹ Ligji nr.10 433, datë 16.6.2011 óPër inspektimin në Republikën e Shqipërisë, neni 12 pika 1.

⁴⁰ VKM nr. 177, datë 31.3.2005 óPër normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse, Kreu I, pika 7.

- c) propozimet për zëvendësimin ose riciklimin e substancave të rrezikshme nga veprimtaritë industriale përkatëse;
- ç) përcaktimi i personave përgjegjës për zbatimin e kërkesave të programit;
- d) koha e zbatimit të programit dhe monitorimi i procesit zbatues të tij.

Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore (KKBU) është miratuar me VKM nr. 1122 datë 30.12.2020 óPër miratimin e kërkesave, kushteve, procedurave, fondeve të nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin, përditësimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujoreó në përputhje me Ligji nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreó neni 88 pika 2 dhe 3. 4. Të gjitha institucionet, entet dhe subjektet e tjera, publike ose jopublike, që merren me menaxhimin e burimeve ujore, detyrohen të caktojnë një përfaqësues që mban marrëdhënie me AMBU dhe dërgon të dhënat në KKBU, në bazë të formave dhe procedurave përkatëse të parashikuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.⁴¹


AKM nuk ka dijeni lidhur me formën dhe procedurën për popullimin e të dhënave të KKBU. Kujtojmë se, forma dhe procedura për popullimin e të dhënave të KKBU është e përcaktuar në Aneksin 9 të VKM nr. 1122 datë 30.12.2020 óPër miratimin e kërkesave, kushteve, procedurave, fondeve të nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin, përditësimin e KKBUó. AKM edhe pse ka caktuar një person përgjegjës (shkresa me nr. prot. 179/1 datë 19.01.2021 óKthim përgjigje kërkesës për caktimin e nëpunësit përgjegjës përfaqësues të përhershëm për popullimin e përditësimin e Kadastrësó⁴²) në të gjitha përgjigjet ndaj pyetësorëve të grupit të auditimit asnjëherë nuk e ka vënë në dispozicion këtë shkresë dhe asnjëherë nuk ka dëshmuar për caktimin e personit përgjegjës për popullimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore.

óRegjistri Kombëtar i autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve për përdorimin e burimeve ujoreó është portali i integruar i të dhënave elektronike, që shërben si instrument procedural publikimi, shpalljeje, që siguron transparencën në fushën e licencimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve.

⁴¹ Ligji nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreó neni 88 pika 4, ói ndryshuaró.

⁴² Grupi i auditimit u njoh me këtë shkresë nëpërmjet observacioneve të Projekt Raportit të dërguara nga AMBU me shkresën nr. 901/2 prot., datë 08.08.2022 óNë lidhje me Projekt Raportin e auditimit óMenaxhimi i burimeve ujoreó

Fig. nr. 5. Regjistri Kombëtar i Lejeve të Përdorimit të Burimeve Ujore



Burimi: AMBU

Fig. nr. 6. Modeli i Lejes për Përdorimin e Burimit Ujor


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR VJOSË

Nr. Serial [REDACTED]

LEJE
PËR PËRDORIM BËRIMI UJOR NËNTOKËSOR

Nr. [REDACTED] Prot., datë [REDACTED]

[REDACTED] iratuar me:

VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR VJOSË

[REDACTED]

Emri i individit/subjektit: [REDACTED]

I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT): [REDACTED]

Baseni Ujor: **VJOSE**

Qarku: **VLORE**

Bashkia/ Njësia administrative: **VLORE**

Koordinatat: [REDACTED] 47 Z: 4.05 m.m.n.d

Lloji aktivitetit dhe dëmtimi në emrin e të përdoret uji : **PËR QËLLIME TË NDRYSHME** [REDACTED]

Prurja mesatare vjetore: **0.4 l/s**

Prurja ekologjike: **nuk ka**

Sasia e ujit që jepet për përdorim: **0.3 l/s**

Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka): **nuk ka**

Vendi ku do të shkarkohet rrjedha e kthyer : **nuk ka**

Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura: **Kanali kullues i zonës**

Sipërfaqja e tokës, me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes): **nuk ka**

Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka): **Sipas kushteve të Lejes**

Periudha e vlefshmërisë: **5 vjet**

Hyrja në fuqi: **Pas publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve**


KRYETARI
[REDACTED]

Burimi: AMBU

Gjetje nga auditimi

7. Në VKM nr.1189, datë 18.11.2009 óPër rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisitë përcaktohet se AKM monitoron treguesit dhe parametrat sa i përket cilësisë së burimeve ujore; ndërsa në Ligjin nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujore theksohet se ky monitorim duhet bërë nën mbikëqyrjen e AMBU-së. Nga auditimi rezultoi se, deri në përfundim të kryerjes së auditimit monitorimi vijon të kryhet nga AKM, pa përfshirjen e AMBU-së, kjo pasi AKM vijon të mbështetet mbi një VKM të papërditësuar.
8. Përgjegjësitë funksionale të AKM, konsistojnë ndër të tjera në inspektimin dhe kontrollin tematik për respektimin e kërkesave ligjore në sektorin e ujrave⁴³. Nga ana tjetër, nga auditimi rezultoi se, prej datës 17.07.2019, në fakt është edhe IKMT (institucion varësie i Ministrisë së Brendshme) Inspektorati përkatës që mbulon inspektimin e burimeve ujore⁴⁴. Kryerja e të njëjtit funksion nga dy institucione të ndryshme, sjell konfuzion pasi ekziston mundësia që një subjekti të shkohet për inspektim dy herë; për të njëjtën shkelje të penalizohet 2 herë; etj. Sa më sipër implikon gjithashtu kosto financiare shtesë, pasi për të njëjtin funksion mbështeten me buxhet dy herë, dy institucione të ndryshme.
9. Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore e cila është një platformë elektronike e krijuar në vitin 2020 nuk është përditësuar në mënyrë të vazhdueshme. Të gjitha subjektet, që kanë në administrim burimet ujore, përfshirë edhe AKM duhet të popullojnë me të dhëna Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore⁴⁵. Nga auditimi rezultoi se, AKM, nuk ka populluar me të dhëna kadastrën, kjo pasi AKM nuk ka patur dhe nuk ka dijeni mbi VKM nr. 1122, datë 30.12.2020 *“Për miratimin e kërkesave, kushteve, procedurave, fondeve të nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore*. Mos përditësimi i inventarit publik (Kadastra) ku pritet të regjistrohen të gjitha të dhënat për ujërat sipërfaqëore, nëntokësore dhe zonat e mbrojtura e bën këtë platformë të papërdorshme nga autoritetet dhe institucionet publike, kombëtare e vendore të përfshira në procesin e menaxhimit të burimeve ujore.
10. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit përgjegjës për mjedisin, miraton *normat teknike të shkarkimit në mjedis për ujin, për substancat e rrezikshme, për substancat dhe parametrat e tjerë*, në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e mjedisit, me qëllim parandalimin e përkeqësimit të cilësisë së ujit dhe mbrojtjen e mjedisit⁴⁶. Nga auditimi u konstatua se, këto norma ende nuk janë miratuar dhe vijohet me normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse sipas VKM nr. 177 datë 31.3.2005 (e hartuar rreth 6 vite përpara miratimit të ligjit për menaxhimin e burimeve ujore dhe atij për mjedisin⁴⁷).
11. Nga verifikimi në faqen zyrtare⁴⁸ të AMBU, u konstatua që Regjistri Kombëtar i Autorizimeve dhe Lejeve të Përdorimit të Burimeve Ujore nuk është i përditësuar me lejet dhe autorizimet deri në fund të vitit 2021 (madje deri në qershor 2022). Konkretisht, për periudhën shtator-dhjetor 2021 janë miratuar 28 Leje dhe Autorizime për përdorim të burimit ujor, të cilat nuk janë publikuar në Regjistrin Kombëtar të Lejeve.

Konkluzione

6. Mungesa e përditësimit të VKM-së nr.1189, datë 18.11.2009 óPër rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisitë, komplikon në

⁴³ VKM nr. 568, datë 17.07.2019

⁴⁴ <https://ikmt.gov.al/organika>

⁴⁵ Ligji nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujore neni 88 pika 4, *“i ndryshuar,*

⁴⁶ Ligji nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujore neni 29.

⁴⁷ Ligj nr.10 431, datë 9.6.2011 óPër mbrojtjen e mjedisit

⁴⁸ <http://www.ambu.gov.al/regjistrat-kombetar-i-lejeve-te-perdorimit-te-burimeve-ujit-2/>

- tërësi procesin e monitorimit të burimeve ujore, duke mos ndarë qartë rolet dhe përgjegjësitë e subjekteve të përfshira në proces.
7. Ka mbivendosje kompetencash sa i takon inspektimit të burimeve ujore, i cili aktualisht kryhet edhe nga AKM edhe nga IKMT.
 8. Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore nuk është populluar me të dhënat e nevojshme mbi inventarin publik e të gjithë ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe zonave të mbrojtura.
 9. VKM nr. 177 datë 31.3.2005 óPër normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëseô nuk bazohet dhe nuk është i azhurnuar me Ligjin nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreô.
 10. Mos përditësimi dhe mos publikimi në kohë reale në Regjistrin Kombëtar të Autorizimeve dhe Lejeve për përdorimin e burimeve ujore nga ana e AMBU, nuk mundëson transparencën e plotë nga ana e portalit që administrohet nga AMBU lidhur me aktivitetet të cilat pajisen me autorizime dhe leje të tilla.

Rekomandime

- 7.1 AKM në cilësinë e institucionit kryesor që duhet të hartojë dhe zbatojë Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit të bashkëpunojë me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe të iniciojnë përditësimin e VKM nr.1189, datë 18.11.2009 óPër rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisitô në mënyrë që ajo të jetë në përputhje me Ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 óPër mbrojtjen e mjedisitô dhe Ligjin nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreô.

Brenda datës 31.12.2022

- 8.1 AKM të marrë masa që të iniciojë ndryshime ligjore për të qartësuar dhe saktësuar rolin e saj në funksion të procesit të inspektimit me qëllim që të mos ketë përplasje kompetencash dhe funksionesh me IKMT.

Brenda datës 31.12.2022

- 9.1 AKM si një ndër institucionet kryesore që kanë të dhëna lidhur me burimet ujore të marrë masa për të populluar dhe përditësuar vazhdimisht me këto të dhëna, Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore.

Brenda datës 30.11.2022

- 10.1 AKM tã drejtohet zyrtarisht Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me qëllim që kjo e fundit të marrë masa për të hartuar dhe përditësuar VKM nr. 177 datë 31.3.2005 óPër normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëseô, në përputhje me nenin 29 të Ligjit nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreô i ndryshuar.

Brenda datës 30.11.2022

- 11.1 AMBU të marrë masa që të përditësojë Regjistrin Kombëtar të Lejeve/Autorizimeve për të gjitha lejet/autorizimet e dhëna në periudhën shtator-dhjetor 2021, por edhe të tjera në vazhdimësi, në mënyrë që të sigurohet një transparencë në kohë reale lidhur me përdoruesit e burimeve ujore me autorizime/leje.

Brenda datës 30.10.2022 dhe në vazhdimësi

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, *nga AMBU është paraqitur observacioni me shkresë nr. 107/9 prot. datë 08.08.2022 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga Znj. G. L, me pozicion Drejtor i Përgjithshëm i AMBU*, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me gjetjen nr. 9, konkluzionin nr. 8 dhe rekomandimin nr. 8.1, në vijim të përcjelljes së projekt-raportit të auditimit, AMBU i ka kërkuar AKM me shkresën nr.86 prot., datë 14.1.2021 që të marrë masa për zbatimin e Vendimit Nr. 1122, datë 30.12.2020 të Këshillit të Ministrave óPër miratimin e kërkesave, kushteve, procedurave, fondeve të nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujoreô. AKM ka përcaktuar me shkresën nr.179/1 prot, datë 19.1.2020, personin

përfaqësues të përhershëm, që do të jetë përgjegjës për popullimin e Kadastrës me të dhënat e përcaktuara për AKM-në sipas VKM-së së sipërcituar.

Gjithashtu lidhur me rekomandimin nr 8.1, me anë të shkresës nr. 5425/1 datë 20.07.2022 óShpjegime mbi Projekt Raportin e Auditimit Menaxhimi i Burimeve Ujoreó, AKM ka observuar se bazuar në shkresën me nr. 179/1 prot datë 19.01.2021 me lëndë óKërkesë për përcaktimin e nëpunësit përgjegjës, përfaqësues të përhershëm për popullimin dhe përditësimin e Kadastrësó është caktuar specialisti i GIS në Sektorin e Informacionit, GIS dhe Regjistrave Mjedisore, në Drejtorinë e Kërkimit dhe Dijes Mjedisore, i cili mban kontakt të vazhdueshëm për shkëmbimin e informacioneve dhe të dhënave në lidhje me popullimin dhe përditësimin e Kadastrës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Gjetja nr. 9 së bashku me konkluzionin dhe rekomandimin përkatës janë bazuar tërësisht në përgjigjet e AKM ndaj pyetësorëve të grupit të auditimit. Grupi i auditimit po njihet vetëm tani (nëpërmjet observacioneve të AMBU dhe AKM) që AKM ka caktuar një person përgjegjës për popullimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore. AKM në përgjigjet zyrtare ndaj pyetësorëve të KLSH asnjëherë nuk ka dëshmuar për përcaktimin e një personi përgjegjës për popullimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore.

Observacionet e AMBU dhe AKM do të merren pjesërisht në konsideratë, vetëm sa i përket faktit që AKM ka caktuar një person përgjegjës.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me gjetjen nr. 11, konkluzionin nr. 10 dhe rekomandimin nr. 11.1 në vijim të përcjelljes së projekt-raportit të auditimit, AMBU thekson se:

Në konceptin e Ligjit 111/2012, të ndryshuar, në pikën 43 dhe 44 të nenit 4, ekzistojnë 2 regjistra që paqyrojnë lejet dhe autorizimet e dhëna në fushën e përdorimit të burimeve ujore (të cilët pavarësisht se të ngjashëm nuk janë të njëjtë):

1. Pika 43- **“Regjistër Kombëtar i autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve për përdorimin e burimeve ujoreó** është portali i integruar i të dhënave elektronike, që shërben si instrument procedural publikimi, shpalljeje, që siguron transparencën në fushën e licencimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve.
2. Pika 44- **“Regjistër Kombëtar i Licencave dhe Lejeve”** është një portal i integruar të dhënash elektronike, që shërben si instrument procedural publikimi, shpalljeje, si dhe një arkiv elektronik zyrtar që siguron transparencën në fushën e licencimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve.

“Regjistri Kombëtar i autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve për përdorimin e burimeve ujoreó (1), krijohet, mbahet, menaxhohet dhe përditësohet nga AMBU, dhe shërben si instrument procedural publikimi, shpalljeje, që siguron transparencën në fushën e licencimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve (përsëri sipas ligjit 111/2012).

Ndërsa **“Regjistri Kombëtar i Licencave dhe Lejeve” (2)** është Regjistri në kuptim të legjislacionit për lejet, autorizimet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë dhe në atë publikohet çdo licencë/leje në Republikën e Shqipërisë, e dhënë nga institucionet qendrore apo institucionet e pavarura, **dhe ajo licencë/leje/autorizim hyn në fuqi vetëm pas publikimit të saj në këtë regjistër (2).**

Ky Regjistër (2) mbahet nga QKB-ja, e cila siguron administrimin dhe mirëmbajtjen e përgjithshme të tij. QKB-ja, si çdo institucion i pavarur dhe çdo institucion qendror (kuptohet edhe AMBU në këtë rast), janë përgjegjës për administrimin dhe plotësimin, sipas këtij ligji, për pjesën e licencave/autorizimeve/lejeve në kompetencë të tyre.

Ky plotësim, i cili shoqërohet edhe me kushtin që vetëm pas publikimit në këtë Regjistër të QKB-së, leja/autorizimi konsiderohet i vlefshëm, është kryer në kohë reale nga ZABU-të (të cilat kanë

akses në sistemin përkatës ku ngarkohen të dhënat dhe formularët e lejeve) sapo leja/autorizimi është nënshkruar dhe vulosur dhe pasi subjekti ka paguar tarifat administrative përkatëse.

Pra, lejet/autorizimet e dhëna për përdorim të burimeve ujore janë óhedhuró gjithmonë në afat në **“Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve”** (2) dhe asnjëherë nuk kemi qenë në kushtin (e konstatuar nga auditimi) që *lejet të jenë të pavlefshme, duke ekspozuar me pa të drejtë përdoruesin e lejes, përpara riskut të informalitetit*.

Të dhënat e **“Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve”** konsultohen në faqen zyrtare të QKB (në rubrikën Licencat e lëshuara jashtë QKB-së).

Ndërkohë, është i drejtë konstatimi që nuk është publikuar i përditësuar **“Regjistri Kombëtar i autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve për përdorimin e burimeve ujore”** në faqen e AMBU (ju informojmë që ky regjistër mbahet dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga AMBU dhe ZABU, sa herë që ka ndryshime si leje të reja, ndryshime në leje, rinovime apo përfundim të afatit të vlefshmërisë).

Por, si qartësua më sipër, vonesat në publikimin e regjistrin të parë (1) në administrim të plotë nga AMBU nuk përbën kushtin që *lejet të jenë të pavlefshme, duke ekspozuar me pa të drejtë përdoruesin e lejes, përpara riskut të informalitetit*. Shtojmë këtu edhe faktin se të dhënat e këtij regjistri (1) bëhen pjesë e Kadastrës dhe në Kadastrë ato pasqyrohen në mënyrë të përditësuar. Thënë sa më lart, ju lutem rivlerësoni gjetjen dhe konkluzionin në fjalë, duke i qëndruar vetëm gjetjes që nuk është publikuar i përditësuar në faqen e AMBU-së **“Regjistri Kombëtar i autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve për përdorimin e burimeve ujore”** dhe jo faktit që kjo përbën kusht që lejet konsiderohen të pavlefshme dhe për pasojë subjektet ekspozohen ndaj informalitetit, për arsyen se **“Regjistri Kombëtar i Licencave dhe Lejeve”** është i përditësuar dhe të dhënat pasqyrohen në faqen zyrtare të QKB-së.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni i AMBU lidhur me këtë gjetje (si dhe konkluzionin dhe rekomandimin përkatës) pranohet tërësisht. Pra, grupi i auditimit bie dakord me argumentimin e AMBU, e cila ka shprehur në observacionin e saj dakordësi sa i përket mos përditësimit në kohë reale të Regjistrin Kombëtar të Autorizimeve dhe Lejeve për përdorimin e burimeve ujore, por që nuk ndikon në pavlefshmërinë apo informalitetin e këtyre përdoruesve.

4.2 A është mbështetur veprimtaria e institucioneve përgjegjëse me buxhete të mjaftueshme?

4.2.1 A është siguruar mbështetja e duhur financiare nga buxheti i shtetit në funksion të objektivave përkatës?

Sikurse paraqitur në tabelën nr. 1, në Kapitullin *“Pesha në buxhet”*, fokus i këtij auditimi janë, nën-objektivat strategjik si mëposhtë:

1. Për objektivin strategjik óSasia e ujitó, fokus i auditimit është për nën-objektivin strategjik *“Menaxhimi i burimeve ujore në nivel baseni (gjithashtu i lidhur me cilësinë)”*⁴⁹;
2. Për objektivin strategjik óCilësia e Ujitó, duke qenë se ai përbëhet nga vetëm një nën-objektiv strategjik óPërcaktimi i gjendjes së ujit me cilësi të mire”, ky i fundit është fokus i këtij auditimi,
3. Për objektivin strategjik óInformacione për ujinó, fokus i këtij auditimi është nën-objektivi strategjik óPërcaktimi i sistemeve të monitorimit të ujit”,
4. Për objektivin strategjik óMenaxhimi i burimeve ujoreó, fokus i këtij auditimi ishin nën-objektivat :
 - óArritja e përputhshmërisë së plotë me parimet e BE-së për ujin dhe mjedisin”⁵⁰;
 - óSigurimi i përfshirjes publike dhe debatit të informuar (nën qeverisjen e ujit)”;

⁴⁹ Shënim i grupit të auditimit: Nuk është fokus i auditimit aktiviteti për përfshirjen e direktivave të BE-së dhe adaptimin e problematikave të ndryshimeve klimatike, SKMIBU, fq.133.

⁵⁰ Shënim i grupit të auditimit: Nuk është fokus i auditimit aktiviteti óProgrami i infrastrukturës bashkiake II, për qytetet Kamëz, Lushnje, Berat, Kuçovë, Fier dhe Sarandë: trajnime dhe konsulencë fq.140.


- óVendosja e koordinimit ndër-sektorial dhe planifikimô;
- óPraktika e integritetit dhe transparencësô dhe
- óMonitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të menaxhimit të ujitô⁵¹

Në totalin e fondeve të parashikuara për arritjen e objektivave strategjik të SKMBIU-së, grupi i auditimi ekstrakti vetëm fondet e parashikuara për arritjen e nën-objektivave strategjik objekt auditimi. Nga analizimi u konstatua se, referuar vlerave të parashikuara në SKMBIU për arritjen e nën-objektivave fokus i këtij auditimi, fondet e nevojshme ishin në vlerën 2,067,600,000 lekë. Krahas fondeve të nevojshme, referuar dokumentin strategjik për arritjen e objektivave të vendosur me qëllim menaxhimin e integruar të burimeve ujore, grupi i auditimit analizoi edhe fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit dhe realizimin e tyre, për periudhën nën auditim.

Të dhënat që rezultuan nga analiza paraqiten në formë grafike në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku nr. 1: Fondet e planifikuara dhe të realizuara për çështjen nën auditim, krahasuar me ato të nevojshme (SKMBIU)

000/lekë



Burimi: AMBU, AKM, MBZHR, Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga analizimi i të dhënave të buxhetit total të planifikuar për realizimin e aktiviteteve lidhur me çështjet e ujit objekt auditimi që AMBU, AKM kryen dhe MBZHR (ka kryer përpara ngritjes së AMBU), konstatohet se, mbështetja financiare për to ka pësuar rënie vit pas viti, ku në vitin 2018 në vlerë absolute janë alokuar 240,540,000 lekë, krahasuar me 190,555,000 lekë që u alokuan në vitin 2021. Të njëjtin trend ka pasur edhe pesha relative e çështjes nën auditim, ku në vitin 2018 fondet e alokuara për të zinin 0,052% të buxhetit të shtetit, krahasuar me 0.032% që zinin në vitin 2021.

Në total për periudhën 2018-2021 janë planifikuar 826,628,000 lekë nga 2,067,600,000 lekë të parashikuara në SKMBIU, ose ndryshe 60% më pak fonde se ato të nevojshme për të përmbushur në mënyrë të plotë aktivitetet e lidhura me menaxhimin e burimeve ujore në Shqipëri.

Ndërsa, hendeuku thellohet edhe më tej midis fondeve faktike të angazhuara dhe fondeve të nevojshme. Gjatë periudhës 2018-2021, nga 826,628,000 lekë të parashikuara për çështjen nën auditim, janë realizuar në fakt vetëm 645,176,000 lekë.

Nga analizimi i fondeve të alokuara në nivel aktiviteti, referuar monitorimit të kryer nga AMBU, u konstatua se, gjatë periudhës nën auditim, nuk janë alokuar fonde për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në SKMBIU. Grupi i auditimit, analizoi kërkesat për buxhet të AMBU, përcjellë me shkresën nr. 514 prot., datë 26.04.2019 óDërgohet PBA 2020-2022ô, shkresën nr. 890 prot., datë 24.08.2020 óDërgohet PBA 2021-2023ô, dhe shkresën nr. 588 prot., datë 23.04.2021 óDërgohet PBA 2022-2024ô. Me anë të këtyre shkresave, krahas kërkesës për fonde për programin që ka aktualisht nën administrim, AMBU ka kërkuar fonde shtesë për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në SKMBIU, nën titullin óPolitikat e Rejaô, ku në vitin 2019 për vitin 2020 ka

⁵¹ Shënim i grupit të auditimit: Nuk është fokus i auditimit aktiviteti óRaport monitorimi i kontratave konçesionare...ô dhe óKrijimi, funksionimi, përgjegjësitë dhe detyrat e komisionit të të posaçëm për administrimin e ujërave ndërkufitareô.

kërkuar 516,767,000 lekë, ndërsa në vitin 2020 për vitin 2021 ka kërkuar 352,610,000 lekë. Gjithashtu, edhe në PBA-në e përgatitur në vitin 2021, ka kërkuar fonde për vitin 2022 me qëllim realizimin e aktiviteteve të parashikuara në SKMBIU dhe PV. Këto kërkesa nuk i janë miratuar nga MFE.

Në kushtet e mungesës së target-ave të synuar dhe Raporteve të miratuara të Monitorimit të Strategjisë (trajtuar në gjetjet nr. 13 dhe 14), grupi i auditimit nuk mund të konkludojë në mënyrë të besueshme, mbi aktivitetet të cilat janë realizuar dhe ato të cilat nuk janë realizuar për shkak të mungesës së fondeve.

Referuar kapitullit 5 të Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, *mjeti kryesor monitorues do të ishte Matrica për Vlerësimin e Performancës, që informon për progresin e arritur në qëllime të ndryshme strategjike, të matur përmes indikatorëve të përcaktuar*. Të dhënat e mbledhura do të konfirmoheshin dhe transferoheshin në një format të pajtueshëm e të rënë dakord nga drejtoria përgjegjëse për politikën e burimeve ujore, ku të dhënat do të përpunoheshin dhe sistemoreshin në tabela me tregues monitorimi. Gjithashtu, SKMBIU parashikonte se do të përgatitet *óPasaporta e Indikatorëveó* nga drejtoria e sipërpërmendur, e cila do të ofronte informacion më të detajuar mbi treguesit, dhe do të shoqërojë raportin e monitorimit.

Nga analizimi i SKMBIU dhe Planit të Veprimit u konstatua Matrica për Vlerësimin e Performancës, për periudhën në të cilën shtrihet Strategjia. Nga analizimi i treguesve të përgjithshëm, pjesë e Matricës së Vlerësimit, u vërejtë së në praktik ato (treguesit) nuk janë të matshëm, p.sh., disa prej treguesve të përdorur për të matur progresin e arritur kundrejt objektivit strategjik *óMenaxhimi i ujitó*, janë:

- *óZbatimi i legjislacionit dhe rregulloreve përkatëseó*,
- *óFunksionimi i strukturave të financimitó*,
- *óFunksionimi i mekanizmave të bashkërendimit ndër-institucionó*, etj.

E njëjta situatë rezulton edhe me treguesit e përgjithshëm të parashikuar për objektivat strategjike *“Sasia e Ujitó*, dhe *óCilësia e Ujitó*.

U konstatua gjithashtu se, për 20 aktivitete të marra në shqyrtim (për 3 objektivat strategjike të mësipërm), vetëm për 3 tregues janë përcaktuar target-et e synuar, ndërsa pjesa tjetër e target-eve të synuar është lënë më mbishkrimin *óPër t'u vendosuró*. Problematika, lidhur me vështirësinë praktike që kanë treguesit e vendosur për të matur progresin e arritur kundrejt rezultateve, grupi i auditimit e identifikoi edhe nga komunikimet e shpeshta me AMBU, institucionin përgjegjës për monitorimin e zbatimit të SKMBIU.

Gjithashtu, grupi i auditimit kërkoi *óPasaportën e Indikatorëveó*, për të shqyrtuar indikatorët e vendosur. Nga auditimi rezultoi se, gjatë periudhës 2018-2021 nuk është hartuar Pasaporta e Indikatorëve, e cila duhet të ofronte informacion të detajuar mbi treguesit, e duhet të shoqëronte raporte e monitorimit. 12 aktivitetet e raportuara si të zbatuara në masën 30-100% (detajuar në tabelat e mësipërme), janë mbështet në indikator të vendosur nga AMBU pa analiza të detajuara për zhvillimin e tyre (indikatorëve), dhe pa një metodologji të mirë-përcaktuar.

Monitorimi i vazhduar i strategjisë është një nga aktivitetet kyç që duhet të ndërmerret me qëllim për të identifikuar, progresin e arritur në drejtim të qëllimeve, problematikat e hasura gjatë zbatimit të aktiviteteve dhe masat e nevojshme për tu ndërmarr me synimin për të arritur objektivat.

Referuar SKMBIU, Kapitulli 5, në nivel institucional, strategjia do të monitorohet nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, ndërsa treguesit specifikë mbarë-sektorialë do të vlerësohen në mënyrë periodike nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Strategji. Ndërsa, *ógjithë procesi do të menaxhohet dhe monitorohet në nivel politik nga Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU), i kryesuar nga Kryeministri, në të cilin Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore shërben si koordinatorë qendrore e të gjitha politikave dhe masave ndër-sektoriale që janë zbatuar nëpërmjet një metode të integruar në sektorëtó*.

Të dhënat e vlerësuara në mënyrë periodike nga ministritë përgjegjëse dhe rezultatet do të përfshiheshin në raportet vjetore të monitorimit mbi zbatimin e strategjisë MIBU të cilat do të

paraqiteshin për shqyrtim në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe së fundi, për miratim, në Këshillin Kombëtar të Ujit. Referuar Strategjisë, raporti vjetor i monitorimit duhet të përfshijë ndër të tjera në rezultate, tregues, tendencat aktuale dhe të perspektivës, pengesave të shfaqura gjatë kohës së raportimit, mësimet të nxjerra dhe arritjeve, rezultateve të arritura gjatë periudhës së raportimit. Nga auditimi rezultoi se, gjatë periudhës nën auditim nuk janë hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të SKMBIU dhe Planit të parë të Veprimit të SKMBIU.

Gjetje nga auditimi

12. Në SKMBIU u parashikuan 2,067,600,000 lekë për të përmbushur në mënyrë të plotë aktivitetet e lidhura me menaxhimin e burimeve ujore në Shqipëri, për periudhën 2018-2021. Nga auditimi rezultoi se, për këto aktivitete janë planifikuar në PBA 826,628,000 lekë (ose 40% e fondeve të parashikuara në Strategji) dhe në fakt janë realizuar vetëm 645,176,000 lekë (ose 31% e fondeve të parashikuara në Strategji). Në kërkesat vjetore për buxhet, AMBU ka kërkuar alokimin e fondeve për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Strategji, kërkesa të cilat nuk janë miratuar nga MFE. Mungesa e fondeve përmban riskun e mos zbatimit me efektivitet të aktiviteteve të parashikuara në SKMBIU dhe në Planin e Veprimit. Në kushtet e mungesës së (i) target-ave të synuar, (ii) indikatorëve të mbështetur në analiza dhe (iii) Raporteve të miratuara të Monitorimit të Strategjisë (trajtuar në gjetjet nr. 13 dhe 14), grupi i auditimit **nuk** mund të konkludojë në mënyrë të besueshme, mbi nivelin e zbatimit të Strategjisë, apo aktivitetet të cilat nuk janë realizuar për shkak të mungesës së fondeve. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur niveli i implementimit të aktiviteteve për periudhën nën auditim, referuar monitorimit të kryer nga AMBU.

Nr.	Objektivi Strategjik	Nën-objektivi strategjik	Aktivitetet	Zbatimi (në %) ⁵²
1	“Sasia e Ujit”	Menaxhimi i burimeve ujore në nivel baseni.	1. Hartimi dhe realizimi i planit vjetor të të ardhurave nga subjektet që përdorin burimet ujore. Përgatitja e raporteve periodike financiare realizimin vjetor të të ardhurave.	100
			2. Përgatitja e akteve ligjore dhe nën-ligjore për menaxhimin e ujërave	60
			3. Hartimi i raportit financiar për grumbullimin e të ardhurave	100
			4. Raporte vlerësimi dhe masash mbi monitorimin e procedurës së pajisjes me leje të përdoruesve të burimeve ujore	56
			5. Regjistri kombëtar i lejeve të burimeve ujore	100
			6. Studim hidrologjik për shfrytëzimin e shtretërve të lumenjve	0
			7. Hartimi i PMBU Shkumbin	0
2	“Cilësia e Ujit”	Përcaktimi i gjendjes të ujit me cilësi të mirë	1. Raport monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	-
			2. Zhvillimi i një databaze dixhitale për matjen e cilësisë së ujërave 2018-2021	0
			3. Vlerësimi i laboratorëve ekzistues; përcaktimi i vendeve më të përshtatshme dhe plani i akreditimit	-
3	“Informacion për Ujin”	Përcaktimi i sistemeve të monitorimit të ujit	1. Zhvillimi i kadastrës së ujit në formën e një sistemi GIS: Kadastra e ujit do të përbëhet nga një bazë të dhënash për burimet e kërkuara të Gjeo-Referencuara AMBU	20
		Kontrolli i planeve	2. Stacione të monitorimit për cilësinë e ujërave	-

⁵² Në mungesë të Raporteve vjetore të Monitorimit mbi zbatimin e Strategjisë, apo dokumenteve të tjera justifikuese, nga monitorimi i kryer nga AMBU, grupi i auditimit nuk mund të ofrojë siguri mbi nivelin e realizimit të Strategjisë për periudhën objekt-auditimi.

		<i>për mbrojtjen ndaj ndryshimeve klimatike</i>	sipërfaqësorë	
			3. Raporte monitorimi për treguesit në programin mjedisor	-
4	“Menaxhimi i Ujit”	óArritja e përputhshmërisë së plotë me parimet e BE-së për ujin dhe mjedisin”	1. Hartimi dhe miratimi i akteve ligjore dhe nënligjore në përmbushje të detyrimeve të ligjit nr.111/2012 "Për menaxhimin e burimeve ujore" dhe në kuadër të përafrimit të Legjislacionit Kombëtar me atë Evropian	60
		óSigurimi i përfshirjes publike dhe debatit të informuar (nën qeverisjen e ujit)ó	2. Kryerja e detyrave funksionale të drejtorisë përkatëse të AMBU-së në funksion të këtij objekti	100
		óVendosja e koordinimit ndërsektorial dhe planifikimó	3. Kryerja e detyrave funksionale të drejtorisë përkatëse të AMBU-së në funksion të këtij objekti	100
			4. Strategjia kombëtare për menaxhimin e integruar të burimeve ujore	30
		óPraktika e integritetit dhe transparencësó	5. Kryerja e detyrave funksionale të drejtorisë përkatëse të AMBU-së në funksion të këtij objekti	100
		“Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të menaxhimit të ujitó	6. Identifikimi i një sërë masash prioritare për të përmirësuar efikasitetin e menaxhimit të burimeve ujore, si analizat dhe gjendjen fizike të burimeve ujore në basen, inventarin e burimeve ujore, Drini-Buna, Semani dhe Vjosa.	80
			7. Kryerja e detyrave funksionale të drejtorisë përkatëse të AMBU-së në funksion të këtij objekti	-

13. Nga auditimi u konstatua se treguesit e përgjithshëm të parashikuar në Strategji nuk ishin të matshëm.

-Krahas treguesve të përgjithshme, në SKMIBU parashikohet se duhet të përgatitet *óPasaporta e Indikatorëveó* nga AMBU, e cila shërben për të ofruar informacion të detajuar mbi treguesit, dhe duhet të shoqërojë raportin e monitorimit. Nga auditimi rezultoi se, AMBU nuk ka hartuar pasaportën e indikatorëve.

-Për periudhën nën auditimi AMBU ka përdorur indikatorë të pambështetur në analiza për të monitoruar implementimin e SKMIBU.

-Nga auditimi rezultoi se, në Strategji, nuk ishin parashikuar target-at e synuar; pra, AMBU nuk kishte përcaktuar target-et e synuar për aktivitetet e kryera prej saj, për periudhën 2018-2021.

Mungesa e treguesve të matshëm në nivel aktiviteti, si dhe mungesa e target-eve të synuar për vitet në të cilat shtrihet strategjia, nuk ofron siguri mbi aftësinë e tyre për të matur në mënyrë të drejtë progresin e arritur në drejtim të menaxhimit të burimeve ujore. Kjo situatë nuk ofron siguri mbi realizimin e 12 aktiviteteve të raportuara si të zbatuar në masën 30-100%.

14. Monitorimi i vazhduar i SKMIBU është një nga aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerret me qëllim identifikimin e progresit të arritur në drejtim të qëllimeve, problematikat e hasura gjatë zbatimit të aktiviteteve dhe masat e nevojshme për tu ndërmarrë për të arritur objektivat. Në nivel institucional, strategjia monitorohet nga AMBU, e cila në fund të çdo viti harton raportin e monitorimit, ku duhet të përfshijë edhe progresin e arritur, problematikat e hasura, hapësirat për përmirësimin, etj. Nga auditimi rezultoi se, gjatë periudhës nën auditim nuk janë hartuar dhe nuk janë miratuar raportet e monitorimit të zbatimit të SKMIBU dhe Planit të parë të Veprimit të SKMIBU. Mungesa e raporteve të detajuara të monitorimit të zbatimit të SKMIBU. Mungesa e raporteve të detajuara të monitorimit të zbatimit të SKMIBU nuk ka siguruar identifikimin dhe adresimin në kohë të problematikave të lidhura me zbatimin e SKMIBU, duke mos i dhënë kështu fokusin e

duhur një prej çështjeve më të ngutshme që ka cenuar zbatimin e tyre, siç është mungesa e fondeve.

Konkluzione:

11. Aktivitetet e parashikuara për arritjen e objektivave strategjike për menaxhimin e ujit, nuk janë mbështetur me buxhetet e nevojshme, pasi për periudhën nën auditim janë alokuar 60% më pak fonde se ato të nevojshme referuar SKMIBU, çka përmban riskun e mos zbatimit me efektivitet të tyre.
12. Indikatorët për matjen dhe monitorimin e aktiviteteve për çdo objektiv strategjik, janë të pamatshëm.
13. Për periudhën 2018-2021, nuk janë hartuar Raporte Vjetore të Monitorimit mbi implementimin e SKMIBU dhe Planit të parë të veprimit duke mos adresuar shkaqet që kanë cenuar zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë, siç është edhe mungesa e fondeve.

Rekomandim:

- 12.1 AMBU në cilësinë e monitoruesit të SKMIBU, të kryej analizimin në mënyrë të detajuar të aktiviteteve të parashikuara në Strategji, me qëllim për të konkluduar:
 - mbi faktorët që kanë ndikuar negativisht në zbatimin brenda afateve të aktiviteteve. Në përfundim të analizës AMBU, duhet të konkludojë në mënyrë eksplicite mbi përqindjen e mos realizimit të Strategjisë, si rezultat i mungesës së fondeve;
 - mbi aktivitetet të cilat mund të kryejë prej institucioneve zbatuese pa nevojën e fondeve shtesë, dhe aktivitetet për të cilat është e nevojshme mbështetje buxhetore shtesë. Në rast se, rezultojnë diferenca krahasuar me kostimin e bërë në Planin e Parë të Veprimit, ato të reflektohen në Planin e ardhshëm të Veprimit, me qëllim për të siguruar një pamje sa më të drejtë të fondeve të nevojshme gjatë zbatimit të tij, çka do të ndihmonte edhe procesin e planifikimit të fondeve buxhetore.

Brenda 3 mujorit të parë 2023

- 13.1 AMBU të hartojë Pasaportën e Indikatorëve, në të cilën duhet të përfshihen indikatorë të matshëm, si dhe *target*-et e pritshëm për vitet në të cilat do të shtrihet Plani i ardhshëm i Veprimit. Monitorimi i SKMIBU dhe Planit të Veprimit (PV) të bëhet mbështetur në Pasaportën e Indikatorëve dhe target-eve të synuar, për të siguruar rezultate të besueshme në drejtim të arritjes së objektivave të synuar.

Brenda datës 31.12.2022

- 14.1 AMBU të hartojë raportet vjetore të monitorimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Me miratimin e raporteve vjetore të zbatimit të SKMIBU nga K.K.U, AMBU të publikojë ato në faqen *web* të saj, me qëllim për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien.

Brenda datës 31.03.2023 dhe në vijimësi

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga AMBU është paraqitur observacioni me shkresë nr. 107/9 prot. datë 08.08.2022 óMbi Projektraportin e Auditimit nga Znj. G. L, me pozicion Drejtor i Përgjithshëm i AMBU, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit: Në vijim të përcjelljes së projekt-raportit të auditimit, AMBU thekson se: óNe lidhje me **gjetjen nr. 13**, përsa i përket aktivitetit *óRaport monitorimi i ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësorë*, këto raporte hartohen nga AKM dhe në Planin e Veprimit nuk është shënuar mosrealizimi i tij, por mungesa e informacionit nga institucionet përgjegjëse. Lidhur me aktivitetin *óZhvillimi i një databaze dixhitale për matjen e cilësisë së ujërave 2018-2021*ó, në Planin e Veprimit është shënuar që lidhur me këtë aktivitet, softi është i zhvilluar, pra si aktivitet është i realizuar 100%, problematikë mbetet popullimi i tij me të dhëna. Përsa i përket aktivitetit *óZhvillimi i kadastrës së ujit në formën e një sistemi GIS; kadastra e ujit do të përbëhet nga një bazë të dhënash për burimet e kërkuara të Gjeo-Referencuara AMBU*ó, në PV janë sqaruar komponentët e këtij procesi për strukturat e AMBU dhe përqindjet e realizimit, të cilat janë si vijojnë:

1. *Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore (KKBU)*
 - 1.a *Administrimi i sistemit të Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore (KKBU). Krijimi i aksesit të përdoruesve të enteve të ngarkuara me popullimin (52%);*
 - 1.b *Disponimi , përgatitja dhe standardizimi i informacionit në lidhje me përdorimin e burimeve ujore me leje dhe popullimi i KKBU me këto të dhëna. Përditësimi është një proces i vazhduar (100%)*
 - 1.c *Publikimi dhe përditësimi i këtij informacioni në portalin ASIG (100%)*
2. *Grumbullimi, analizimi, standardizimi, dhe raportimi për të dhënat e 2019-2020 në lidhje me elementët e 7 kategorive të “sasisë së ujit”, WISE, SoE, (SOE, WQ, DF), në mbështetje të parimeve të Direktivës Kuadër të Ujit të BE-së) (100% mbështetur në të dhënat e disponuara nga aktorët)*
3. *Ndërsa dy aktivitetet e tjera, të cilat janë pjesë e nën-objektivit strategjik “Kontrolli i planeve për mbrojtjen ndaj ndryshime klimaterike”, janë fushë e përgjegjësisë së MTM-së dhe AMBU nuk mund të përgjigjet mbi përqindjen e realizimit të tyre.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me aktivitetin *óRaport monitorimi i ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësorë*, referuar Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Burimeve Ujore, institucion përgjegjës për zbatimin e tij është AMBU. Për më tepër, edhe për aktivitete të tjera si p.sh. *óKryerja e detyrave funksionale të drejtorisë përkatëse të AMBU-së në funksion të këtij objekti*”, aktivitet i cili lidhet me vet detyrat funksionale të Agjencisë, AMBU ka përdorur të njëjtin shënjim në kuadratin e nivelit të realizimit (që është óó), sikurse edhe për aktivitetin *óRaport monitorimi i ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësorë*, përcjellë me e-mailin e datës 10.03.2022.

Lidhur me aktivitetin *óZhvillimi i një databaze dixhitale për matjen e cilësisë së ujërave 2018-2021*”, ai është përcjellë nga vet institucioni me e-mailin e datës 10.03.2022, si i realizuar në nivelin 60%ó. Në kushtet e mungesës së target-ave të synuar dhe raporteve të monitorimit të miratuara, grupi i auditimit nuk mund të konkludojë nëse qëndron norma e realizimit 60%óe përcjellë me e-mailin e datës 10.03.2022, apo norma e realizimit ó100%ó e përcjellë me observacionet shkresa nr. 901/2 prot., datë 08.08.2022.

Lidhur me *“Zhvillimi i kadastrës së ujit në formën e një sistemi GIS; kadastra e ujit do të përbëhet nga një bazë të dhënash për burimet e kërkuara të Gjeo-Referencuara AMBU”*, ai është përcjellë nga vet institucioni me e-mailin e datës 10.03.2022, si i realizuar në nivelin 620%ó. Lidhur me komponentët, nuk janë përcjellë fakte shtesë.

Sa më sipër, **Observacioni do të merret pjesërisht në konsideratë, ku grupi i auditimit do të shprehet se, në mungesë të: (i) target-ave të synuar; (ii) indikatorëve të mbështetur në analiza, dhe (iii) raporteve të miratuara të monitorimit, nuk mund të ofrojë siguri mbi nivelin e realizimit apo mos realizimit të Strategjisë, për periudhën objekt auditimi.**

Pretendimi i subjektit: Në vijim të përcjelljes së projekt-raportit të auditimit, AMBU ka përcjellë: *óGjithashtu, po në lidhje me gjetjen nr. 13, sqarojmë se në Planin e Veprimit, për çdo aktivitet ka indikatorë të përcaktuar, ku për indikatorë të veçantë është i nevojshëm përditësimi, në mënyrë që monitorimi i mëtejshëm i strategjisë të jetë i saktë.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me komentin e mësipërm, grupi i auditimit ka sjellë në vëmendje se, në Planin e Veprimit 2018-2020, nuk ka tregues të përcaktuar për asnjë aktivitet. Nëse AMBU, me termin *óPlan Veprimiô*, i referohet tabelave të excel-it të përdorura prej saj, për monitorimin e zbatimit të Strategjisë, grupi i auditimit sjellë në vëmendje e-mailin e datës 18.05.2022 të AMBU-së, ku në kërkesë të grupit të auditimit mbi vënien në dispozicion të analizave të kryera për konkludimin e indikatorëve dhe taraget-ave të synuar, nuk është përcjellë asnjë dokument vërtetues. Sa më sipër, nuk janë përcjellë fakte të reja, observacioni nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit (AMBU): *Në lidhje me gjetjen 14 sqarojmë se, lidhur me mungesën e raporteve vjetore, siç është komunikuar dhe më parë, se pavarësisht se është vendosur të kryhet një raport final në fund të përfundimit të afatit të Planit të Veprimit 2019-2021, aktivitetet janë matur në vazhdimësi dhe janë bërë raportime çdo tre muaj në takimet e Grupit Tematik “Burimet Ujore”. Pra, këto analiza dhe raportime janë bërë në një afat kohor me të detajuar, çdo tre muaj dhe shumatorja e tyre ka nxjerrë rezultatin në normë vjetore. Këto të fundit janë prezentë edhe në mbledhjen e KKU-së, e cila ka njëkohësisht rolin e KMIP “Menaxhimi i Ujit”.*

Arsyet e mosmiratimi të këtyre nevojave buxhetore janë specifike rast pas rasti dhe të ndryshme në çdo institucion, duke nisur nga mospërfshirja në kërkesat e PBA-së e nevojave nga institucionet, buxheti i limituar, për sektorin sikurse edhe mos prezenca e MFE-së në takimet e Grupit Tematik. Gjithashtu në mbledhjen më të afërt (që nga fillimi i zbatimit të P.V) të GMIP “Menaxhimi i Ujit”, është adresuar çështja e mungesës së fondeve lidhur me zbatimin e aktiviteteve të P.V, duke shtruar problemin e mosfinancimit të aktiviteteve dhe mungesës së bashkëpunimit nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij plani.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar Kapitullit 5: *“Raportimi, Monitorimi, dhe Vlerësimiô*, të Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Burimeve Ujore, **miratuar me VKM nr. 73, datë 07.02.2018**, parashikohet hartimi i raporteve vjetore të monitorimit të Strategjisë dhe miratimi i tyre. Në këtë kapitull parashikohet edhe se çfarë duhet të përfshijnë raportet vjetore të monitorimit të Strategjisë, sikurse paraqitur nga grupi i auditimit, në raportin final të auditimit.

Në përgjigje të kërkesës për informacion të grupit të auditimit, AMBU ka përcjellë me e-mailin e datës 23.05.2022 një prezantim në PPT të përgatitur për takimin e GMIP dhe minutat e takimit të datës 15.06.2021 (në version word, të pafirmosor), për vetëm 1 takim të kryer përgjatë periudhës nën auditim. Këto dokumente janë shqyrtuar nga grupi i auditimit dhe nuk plotësojnë kushtet për t’u konsideruar raporte monitorimi të draftuara dhe të miratuara, për çka trajton grupi i auditimit në gjetjen, konkluzion dhe rekomandimin e tij. Sa më sipër, nuk janë përcjellë fakte të reja observacioni nuk merret në konsideratë.

4.2.2 A i kanë shërbyer të ardhurat dytësore të krijuara nga AMBU, përmirësimit të menaxhimit të ujit?

Siç është cituar dhe më sipër, AMBU organizohet në nivel qendror dhe në nivel baseni ujqor nëpërmjet ZABU. Të ardhurat dytësore të krijuara nga AMBU janë:

- Tarifat e shpenzimeve administrative me qëllim pajisjen me leje përdorimi burimi ujqor të cilat janë të përcaktuara në VKM nr. 1014, datë 16.12.2020 “Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative për kërkesat për përdorimin, shkarkimin e ujit dhe ndërtimin e objekteve e veprave ujore”.
- Tarifat për përdorimin e burimeve ujore të cilat janë përcaktuar në VKM nr. 993 datë 9.12.2020 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit, të ujërave ndërkufitar, pagesave administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre”.

Përdoruesit e ujit detyrohen të paguajnë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit si dhe detyrohen të paguajnë për shpenzimet administrative të pajisjes me leje bazuar në ligjin Nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreó neni 53 pika c, neni 93 pika 1 ói ndryshuaró. Referuar nenit 94 pika 1 dhe 2 e Ligjit nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreó, ndryshuar me Ligjin nr. 6/2018, datë 8.2.2018, të dyja këto tarifa mbliidhen nga AMBU në bashkëpunim me ZABU dhe derdhen në buxhetin e shtetit.

Grupi i auditimit analizoi te dhënat e detyrimeve të subjekteve për tarifën e përdorimit të ujit si dhe tarifën e shpenzimeve administrative të pajisjeve me leje të përdorimit të burimit ujor. Nga analizimi i të dhënave rezulton se në fund të vitit 2021, janë 188,282,705 lekë detyrime të papaguara të debitorëve ndaj AMBU për tarifën e përdorimit të ujit. Nga këto, 138,522,792 lekë janë detyrime të enteve publike dhe 49,759,914 lekë janë detyrime të subjekteve private. Këto detyrime përbëhen nga detyrimet e pa paguara para vitit 2018 si dhe detyrimet e papaguara për periudhën 2018-2021.

Nga evidencat e përfuara është konstatuar se të ardhurat e faturuara dhe të arkëtuara nga viti 2018-2021 nga ana e AMBU-së kanë pasur luhajtje siç shihet në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr.11 Faturimet dhe arkëtimet nga ana e AMBU-së 2018-2021

(lekë)

Vitet 2018-2021							Total (tarifa vjetore ente private + ente publik)
Faturime/Arkë time	Ente private			Ente publike			
	Tarife administra tive	Tarife përdorimi	Totali (tarife administrativ e +Tarife përdorimi)	Tarifë administra tive	Tarife përdorimi	Totali (tarifë administrati ve + Tarifë përdorimi)	
Faturime 2018	12,163,380	81,492,519	93,655,899	221,000	157,563,724	157,784,724	251,440,623
Arkëtime 2018	11,788,380	71,870,777	83,659,157	221,000	161,572,576	161,793,576	245,452,733
Faturime 2019	4,325,000	43,388,620	47,713,620	62,000	55,660,355	55,722,355	103,435,975
Arkëtime 2019	4,585,000	49,823,121	54,408,121	37,000	58,009,012	58,046,012	112,454,134
Faturime 2020	5,639,000	53,452,071	59,091,071	271,000	75,077,975	75,348,975	134,440,046
Arkëtime 2020	5,619,000	51,704,330	57,323,330	290,000	55,639,511	55,929,511	113,252,841
Faturime 2021	7,309,450	99,709,940	107,019,390	68,000	99,489,039	99,557,039	206,576,429
Arkëtime 2021	7,364,450	98,732,188	106,096,638	68,000	105,711,826	105,779,826	211,876,465
Total faturime	29,436,830	278,043,150	307,479,980	622,000	387,791,093	388,413,093	695,893,073
Total arkëtime	29,356,830	272,130,416	301,487,246	616,000	380,932,925	381,548,925	683,036,173

Burimi: AMBU, Përpunoi: Grupi i auditimit

Për periudhën 2018-2021 janë faturuar në total nga AMBU për tarifën e shpenzimeve administrative të pajisjeve me leje përdorimi burimi ujor dhe tarifën e përdorimit të burimeve ujore 695,893,073 lekë. Nga vlera e faturuar (për periudhën 2018-2021) janë arkëtuar 683,036,173 lekë. Gjatë viteve

2018-2021 janë krijuar 12,856,900 lekë detyrime të pa papaguara të përdoruesve të ujit. Faturimet në vitin 2018 janë në vlerën 251,440,623 lekë ndërsa për vitin 2021 janë 206,576,429 lekë, që do të thotë që ato janë pakësuar me 18% krahasuar me vitin 2018. Arsyeja e vlerës së lartë të faturimit për vitin 2018 është si pasojë e faturimit të debive të vjetra ndaj KESH-it. Vlera e arkëtimeve për vitin 2021 është në shumën 211,876,465 lekë, ndërsa për vitin 2019 është në vlerën 112,454,134 lekë, që do të thotë që krahasuar me vitin 2019, pothuajse janë dyfishuar. Për vitin 2020 vlera e arkëtimeve është në shumën 113,252,841 lekë, vlerë e cila është më pak se faturimet të cilat janë 134,440,046 leke.

Gjatë periudhës 2018-2021, (tabela nr. 12) , vlera e arkëtimeve krahasuar me faturimet ka qenë në nivele 98% për vitin 2018, 109% për vitin 2019, 84 % për vitin 2020 dhe 103% për vitin 2021. Tejkalmi i arkëtimeve në nivelin më shumë se 100% vjen si pasojë e arkëtimeve nga debitë e vjetra të viteve të mëparshme. Niveli i arkëtimeve të faturimeve si për subjektet publike ashtu edhe për ato private (për të njëjtën periudhë 2018-2021) është në masën 98 %.


Tabela nr.12: Krahasimi i faturimeve të tarifave me arkëtimet 2018-2021

000/ lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Totali
1	Faturime	251,440	103,435	134,440	206,576	695,891
2	Arkëtime	245,452	112,454	113,252	211,876	683,034
3	% e arkëtimeve	98%	109%	84%	103%	98%

Burimi: AMBU, Përpunoi: Grupi i auditimit

Grafiku Nr.4: Krahasimi faturime dhe arkëtime 2018-2021



Burimi: AMBU, Përpunoi: Grupi i auditimit

Grupi i auditimit analizoi buxhetin faktik të realizuar nga AMBU si dhe të ardhurat e realizuara nga arkëtimet nga ana e AMBU të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 13: Buxheti fakt i AMBU-së, për periudhën 2018-2021 dhe arkëtimet e realizuara


000/lek

Nr.	Emërtimi	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Total 2018-2021
1	Buxheti fakt AMBU	32,784	123,716	136,657	160,112	453,269
2	Programi "Administrim Uji" MBZHR- Fakt	167,433				167,433
	Totali Buxheti faktik AMBU	200,217	123,716	136,657	160,112	620,702
	Arkëtimet e tarifave	245,452	112,454	113,252	211,876	683,034

Burimi: AMBU, Përpunoi: Grupi i auditimit

Buxheti faktik për vitin 2018 i AMBU është 200,217,000 lekë dhe në këtë vit janë realizuar 245,452,733 lekë të ardhura të arkëtuara nga tarifat dhe shpenzimet administrative. Për vitin 2019 buxheti faktik i AMBU është 123,716,000 lekë dhe në këtë vit janë realizuar 112,454,134 lekë të ardhura nga tarifat dhe shpenzimet administrative. Në vitin 2020 buxheti faktik është 136,657,000 leke dhe janë arkëtuar 113,252,841 lekë. Në vitin 2021 buxheti faktik është 160,112,000 lekë dhe janë arkëtuar 211,876,465 lekë. Ndikim në rritjen e tarifimit për vitin 2021 ka dhënë edhe shtimi i numrit të subjekteve të pajisuara me leje përdorimi të burimeve ujore, ku për vitet 2020-2021 janë dhënë rreth 150 leje përdorimi burimi ujqor nga 976 që janë sot gjithsej.

Grafik Nr.5:Krahasimi buxhet faktik me arkëtimet



Burimi: AMBU, Përpunoi: Grupi i auditimit

Fatura e përdorur nga AMBU për faturimet e tarifave

përdorimit ujqor nga ana e AMBU. Gjate analizimit, grupi i auditimit verifikoi dhe shqyrtoi disa fatura te ndryshme. Fatura që përdoret nga AMBU është sipas formatit të paraqitur në figurën nr. 7. Për vitet 2018-2020 faturat duhet të ishin në përputhje me VKM nr.1497, datë 19.11.2008 óPër shtypjen e letrave me vlerë pikën 2, ndërsa për vitin 2021 e në vazhdim duhet të jenë fatura kompjuterike siç përcaktohet në Ligjin nr. 87/2019 óPër Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimitô, neni 4 pika ócô si dhe në Udhëzimin nr. 16, datë 3.4. 2020 óPër faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimitô neni 4 pika 2.

Ligji nr. 87/2019 óPër Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimitó përcakton që faturat që do të lëshohen për Organet Publike Shtetërore duhet të jenë Fatura Elektronike dhe shkëmbehen nëpërmjet Platformës Qendrore të Faturave që nga data 1 Janar 2021, ndërsa për faturat që do të lëshohen ndërmjet tatimpaguesve, këto fatura duhet që të jenë Fatura Elektronike dhe shkëmbehen nëpërmjet Platformës Qendrore të Faturave duke filluar nga data 1 Korrik 2021. VKM nr.220, datë 12.3.2020 óPër përcaktimin e kategorisë së tatimpaguesve dhe të kriterëve të përdorimit të procedurës së thjeshtëzuar të fiskalizimitó pika 2.2 thekson se “*Organet publike qendrore dhe vendore mund të lëshojnë fatura dhe fatura elektronike dhe të kryejnë procedurën e fiskalizimit për transaksionet që kryejnë, përmes përdorimit të platformës qendrore të faturave.*”

Figura nr. 7. Modeli i faturës së arkëtimit të tarifave

FATURË PER ARKËTIM
NR. 13 DATË 15.02.2022

DREJTUAR: **BANKA**

VLORE

Me anë të kësaj fature kërkojmë që Banka juaj të pranojë nga klientë (persona fizik e juridik) arkëtime të të ardhurave, për llogari të institucionit tonë, me emërtimet, kodet dhe shumat si më poshtë:

EMRI I INSTITUCIONIT PËRFITUES **AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE**

KODI I INSTITUCIONIT **1087016**

KODI I DEGËS SË THESARIT KU VEPRON **3535**

Përshkrimi i Të Ardhurave			
Nr	Emërtimi	Kodi i Llogarisë Ekonomike	Arkëtohet (Lekë)
1	Përdorim burimi uhor sipërfaqësor për akuakulturë për periudhën Tetor-Dhjetor 2021 (3720 kg * 1 lekë/kg)	7113099	3 720,00
TOTALI:			3.720,00
()			

INSTITUCIONI
ZYRA E ADMINISTRIMIT TË BASENIT UJOR
VLOSË

KLIENTI

Burimi: AMBU

Përdorimi i burimeve ujore nga mjetet lundruese

Nga shqyrtimi i óopen data⁵³ rezulton se gjatë viteve 2018-2019-2020 janë regjistruar 663 mjete lundruese pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare. Në vitin 2018 janë regjistruar 8 mjete lundruese mbi 15m, 14 për vitin 2019 dhe 3 mjete në vitin 2020 edhe pse në periudhë pandemie. Mjete lundruese nën 15 m janë regjistruar 189 në vitin 2018, 198 për vitin 2019, 130 në vitin 2020 edhe pse në periudhë pandemie. Në vitin 2018 janë regjistruar 37 motor deti, 45 për vitin 2019 dhe 39 për vitin 2020 edhe pse në periudhë pandemie. Këto mjete lundruese duhet të pajisen me leje përdorimi burimi ujqor për lundrim pranë AMBU në përputhje me VKM Nr.550, datë 15.07.2020 *óPër miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin në parim, për dhënien me koncesion të burimit ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e lumit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqërues, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes, të formularëve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë të tyreó*. Përdoruesit e ujqit për lundrim duhet të paguajnë tarifën e përcaktuar në VKM nr. 1014, datë 16.12.2020 *óPër miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative për kërkesat për përdorimin, shkarkimin e ujqit dhe ndërtimin e objekteve e veprave ujoreó pika 2 óaó, óbó Tabela e tarifave të shpenzimeve administrative Nr. Rendor 12 óKërkesë për autorizim për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për turizëm, argëtim, lundrim për argëtimó*. Sipas kësaj VKM, tarifa e aplikimit për leje lundrimi është 53,000 lekë. Referuar VKM nr. 993 datë 9.12.2020 *“Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujqit, të ujërave ndërkufitar, pagesave administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyreó pika 12, tarifa e përdorimit të burimeve ujore për lundrim është 0 lekë*.

Përdorimi i burimeve ujore në sektorin e akuakulturës

Një tjetër çështje që grupi i auditimit adresoi është edhe sektori i akuakulturës për vetë rëndësinë që ky sektor ka në zhvillimin ekonomik e social të vendit. Subjektet që ushtrojnë aktivitetin e akuakulturës duhet të pajisen me leje përdorimi burimi ujqor siç përcaktohet në *ligjin 111/2012 për menaxhimin e integruar të burimeve ujore (ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018), neni 38 pika b dhe neni 41 pika 1 ë*. Subjektet e akuakulturës tariforen për shpenzimet administrative referuar VKM nr. 1014, datë 16.12.2020 *“Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative për kërkesat për përdorimin, shkarkimin e ujqit dhe ndërtimin e objekteve e veprave ujore” Tabela e tarifave të shpenzimeve administrative pika 5.1 dhe 5.2*. Ndërsa, sa i përket tarifës së përdorimit të burimit ujqor nga subjektet e sektorit të akuakulturës, ato përllogariten dhe janë të përcaktuara në VKM Nr.933 datë 9.12.2020 *“Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujqit, të ujërave ndërkufitar, pagesave administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre” pika 5.1, 5.2 dhe pika 23*. Në pikën 5.1 dhe 5.2 të kësaj VKM, tarifa e përdorimit (për ujërat sipërfaqësorë) është 1 lekë për kg peshk të shitur ndërsa sipas pikës 23 të po kësaj VKM (për ujërat nëntokësor) është 2 lekë për kg peshk të shitur. Nga të dhënat zyrtare të përfutuara nga MBZHR, rezulton se në Shqipëri janë 94 subjekte që ushtrojnë aktivitet në sektorin e akuakulturës. Në total për vitet 2018-2021 këto subjekte kanë prodhuar dhe shitur 30,294.4 ton peshk ose 30,294,400 kg. Në AMBU janë të regjistruara 10 subjekte për përdorim burimi ujqor për akuakulturë nga 94 që janë regjistruar në MBZHR. Vetëm njëri prej këtyre 10 subjekteve që rezulton i regjistruar në AMBU është i regjistruar edhe në MBZHR. Ky është subjekti K.A.A. Sh.a. Për sa më sipër, rezultojnë 93 subjekte që janë të regjistruara në MBZHR por që nuk disponojnë leje të përdorimit të burimit ujqor nga AMBU. Subjekti K.A.A. Sh.a, për periudhën 2018-2021 ka shitur 94,190 kg peshk, rrjedhimisht peshku i pa faturuar nga AMBU është në shumën 30,294,400 kg ñ 94,190 kg = 30,200,210 kg. Referuar VKM nr. 1014, datë 16.12.2020 *“Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative për kërkesat për përdorimin, shkarkimin e ujqit dhe ndërtimin e objekteve e veprave ujore” Tabela e tarifave të shpenzimeve administrative pika 5.1, 5.2 dhe 23”, vlera për shpenzimet administrative të pajisjes me leje përdorimi burimi ujqor për akuakulturë kur përdorimi është për Ó ton/vit ose Ó l/sek është 26,500 lekë dhe kur përdorimi është për >5 ton/vit ose >5 l/sek është 53,000 lekë*. Grupi

⁵³ <http://dpdetare.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Arritjet-e-Drejtorise-se-Pergjithshme-Detare.pdf>

i auditimit për përlllogaritjen minimale të shpenzimeve administrative të pa faturuara mori vlerën më të vogël të shpenzimit administrativ pikërisht 26,500 lekë, që do të thotë se tarifa për shpenzime administrative për aplikimin për leje përdorimi të burimit ujqor nga një subjekt që operon në sektorin e akuakulturës është minimalisht 26,500 lekë. Ndërsa, përlllogaritja e tarifës së përdorimit të burimit ujqor të pa faturuar në sektorin e akuakulturës u krye bazuar në VKM Nr.933 datë 9.12.2020 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit, të ujërave ndërkufitar, pagesave administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre” pika 5.1,5.2 e cila ka përcaktuar tarifën në vlerën 1 lekë për kg peshk të shitur ndërsa pika 23 ka përcaktuar tarifën në vlerën 2 lekë për kg peshk të shitur. Grupi i auditimit për përlllogaritjen minimale të tarifës së përdorimit të burimit ujqor të pa faturuar mori vlerën më të vogël pikërisht 1 lekë për kg peshk të shitur.

Përdorimi i burimeve ujqore për furnizim me ujë të pijshëm të popullatës

Subjektet që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit me ujë të popullatës duhet të pajisen me leje bazuar në ligjin 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujqore” (ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018),neni 31 pika 2 neni 38 pika a dhe neni 41 pika 1 a. si dhe duhet të monitorohen sipas nenit 87 te ligjit. Subjektet e ujësjellësve tariforen për shpenzimet administrative referuar VKM nr. 1014, datë 16.12.2020 “Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative për kërkesat për përdorimin, shkarkimin e ujit dhe ndërtimin e objekteve e veprave ujqore” pika 2,a,b dhe Tabela e tarifave të shpenzimeve administrative nr. Rendor 2 dhe 20.

Nga informacioni i dërguar nga ZABU në lidhje me përdorimin e burimeve ujqore të shoqërive të Ujësjellës Kanalizimeve, ZABU Vjosë ka konfirmuar që në Basenin Ujqor Vjosë shoqëritë e Ujësjellës Kanalizimeve shfrytëzojnë në total 282 burime ujqore nga këto 20 burime ujqore janë me leje/ kontratë koncensionare shfrytëzimi dhe 262 burime ujqore janë pa leje. ZABU Shkumbin-Seman ka konfirmuar që në Basenin Ujqor Shkumbin-Seman, shoqëritë e Ujësjellës Kanalizimeve shfrytëzojnë në total rreth 227 burime ujqore, nga këto 57 burime ujqore janë me leje/ kontratë koncensionare shfrytëzimi dhe 170 burime ujqore janë pa leje. ZABU Ishëm-Erzen-Mat ka konfirmuar që Baseni Ishëm-Erzen-Mat ka 24 burime ujësjellësi me leje dhe 61 pa leje ZABU Drin-Bunë ka konfirmuar që në ZABU Drin-Bunë janë 74 burime ujqore të Ujësjellësve që shfrytëzohen nga ujësjellësit pa leje dhe 16 me leje përdorimi burimi ujqor. Nga informacioni i përfutur nga të gjitha ZABU- të, në të gjithë Shqipërinë rezultojnë 567 burime ujqore të Ujësjellës Kanalizimeve pa leje përdorimi burimi ujqor dhe 117 burime të cilat kanë leje për përdorimin e burimit ujqor.

Vlera për shpenzimet administrative të pajisjes me leje për një burim referuar VKM nr. 1014, datë 16.12.2020 pika 2 “a”, “b” dhe Tabelës se tarifave të shpenzimeve administrative nr. Rendor 2 dhe 20 është $1,500 + 25,000 = 26,500$ leke.

Përdorimi i burimeve ujqore të ujërave termal

Grupi i auditimit gjatë fazës së terrenit u shoqërua nga ZABU Shkumbin-Seman në disa vizita në terren dhe veçanërisht në fshatin Tregan Elbasan. Nga vizita e kryera në fshatin Tregan Elbasan rezultojnë rreth 50 subjekte të pa pajisura me leje përdorimi burimi ujqor të ujërave termal. Shifra e sakte e këtyre subjekteve nuk dihet nga ana e ZABU Shkumbin-Seman. Nga të dhënat e siguruara nga ZABU Seman Shkumbin rezultojnë 10-12 subjekte termale, gjeotermale që posedojnë leje përdorimi të burimeve ujqore për qëllime gjeotermale.

Subjektet që përdorin ujërat termal duhet të pajisen me leje përdorimi burimi ujqor të ujërave termal bazuar në ligjin 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujqore” (ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018),neni 41 pika 1 germa dh ,si dhe duhet të monitorohen sipas nenit 48 pika 1 germa ë, te ligjit. Subjektet që përdorin ujërat termal tariforen për shpenzimet administrative referuar VKM nr. 1014, datë 16.12.2020 “Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative për kërkesat për përdorimin, shkarkimin e ujit dhe ndërtimin e objekteve e veprave ujqore” pika 2 “a”, “b” dhe Tabela e tarifave të shpenzimeve administrative Nr. Rendor 27 “Kërkesë për leje për përdorim burimit ujqor kurativ, mineral, termomineral dhe gjeotermal”,vlera për shpenzimet

administrative për pajisjen me leje përdorimi burimi ujqor për një burim gjeotermal është 5,000+100,000=105,000 lekë.

Përdorimi i burimeve ujore për pishina

Grupi i auditimit në fazën e studimit hartoi pyetësorë për ZABU në lidhje me aktivitetet përdoruesit e burimeve ujore për pishina. ZABU në përgjigjet e tyre kanë konfirmuar që nuk kanë informacion të saktë se sa pishina në të gjithë Shqipërinë duhet të pajisen me leje përdorimi të burimit ujqor.

Përdoruesit e burimeve ujore për pishina duhet të pajisen me leje përdorim burimi ujqor referuar Ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” (ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018), neni 41 pika 1 gërma “ç”.

Nga informacioni i përmbledhur i ZABU vetëm në basenin Drin-Bunë është miratuar një leje për përdorim uji për qëllime turistike ku ka në përdorim pishina.

AMBU në bashkëpunim me ZABU Drin Bunë me qëndër në Shkodër lejen për pishina e ka dhënë 6Leje për turizëm, argëtim, lundrim për argëtim6 që i përgjigjet pikës 12 dhe pikës 26 të VKM Nr.1014, datë 16.12.2020. Tarifat për pajisjen me leje për një pishinë është 53,000 lekë.

Grupi i auditimit duke qenë qe nuk ka të dhëna të sakta për numrin e pishinave pa leje përdorimi burimi ujqor, rrjedhimisht dhe sasinë e përdorur të ujit nga ana e tyre, nuk mund të llogarisë saktësisht të ardhurat e munguara nga pajisja me leje dhe nga përdorimi i ujit, por ka shtjelluar fenomenin në mënyrë që të evidentojë faktin që ekzistojnë potencialisht të ardhura të munguara nga përdoruesit e burimeve ujore për pishina.

Tarifat e përdorimit të ujit dhe pagesat për shpenzimet administrative mbliidhen nga organet e menaxhimit të burimeve ujore.

Përdorimi i burimeve ujore për lavazhe

Një tjetër çështje në të cilën është fokusuar grupi i auditimit është edhe përdorimi i burimeve ujore për lavazhe. Nga informacionet e marra, përveç ZABU Vjosë, ZABU-të e tjera kanë konfirmuar që nuk kanë një informacion të saktë se sa lavazhe të cilat ndodhen në territorin e baseneve të tyre duhet të pajisen me leje përdorimi të burimit ujqor.

Referuar pikës 7 të VKM Nr. 1014, datë 16.12.2020 6Kërkesë për leje për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për qëllime industriale dhe teknologjike6, tarifa për pajisjen me leje për një lavazh është 28,000 lekë.

Duke qenë se për ZABU Drin-Bunë, Ishëm, Erzen, Mat, Shkumbin, Seman nuk ka të dhëna të sakta për numrin e lavazheve pa leje përdorimi burimi ujqor, grupi i auditimit nuk mund të llogarisë saktësisht të ardhurat e munguara, por ka shtjelluar fenomenin në mënyrë që të evidentojë faktin që ekzistojnë potencialisht të ardhura të munguara nga përdoruesit e burimeve ujore për lavazhe. Sa i përket ZABU Vjosë, ajo ka evidentuar 54 subjekte përdorues të burimeve ujore për lavazhe.⁵⁴

Gjetje nga auditimi

15. Tarifat e përdorimit të ujit dhe pagesat për shpenzimet administrative mbliidhen nga AMBU nëpërmjet ZABU-ve.⁵⁵ Nga auditimi rezultoi se, AMBU nuk ka arritur të arkëtojë detyrimet e tarifave të përdorimit të ujit dhe shpenzimeve administrative për pajisjen me leje përdorim burimi ujqor. Mos arkëtimi i detyrimeve ndaj AMBU ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në shumën **188,282,000 lekë**. Për periudhën 2018-2021 nuk janë arkëtuar 12,8 milionë lekë, çka dëshmon se rreth 93% e të ardhurave totale të munguara (188,282,000 lekë) i përket detyrimeve të trashëguara para vitit 2018.

⁵⁴ Shkresa me nr. 346 Prot., datë 23.09.2019, drejtuar ISHMPUT Vlorë, për dijeni AMBU.

⁵⁵ Ligji nr. 111/2012 6Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore6, 6i ndryshuar6 neni 94 pika 1, VKM nr. 221, datë 26.04.2018 për 6Organizimin dhe funksionimin e AMBU6 Kreu III, pika 4 gërma 6dh6

16. Nga verifikimi i regjistrit të lejeve të përdorimit të burimit ujor që administrohet nga AMBU, rezulton se asnjë nga 663 mjetet lundrues të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme Detare,⁵⁶ nuk është i pajisur me leje përdorimi burimi ujor për lundrim. AMBU nuk ka kryer asnjë kontroll për sa më sipër. Mos pajisja e tyre me leje përdorimi të burimit ujor, sjell **të paktën rreth 35,139,000 lekë** të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit si pasojë e mos pagesës së tarifës së pajisjes me leje në AMBU (663 mjete x 53,000 leke = 35,139,000 lekë).
17. Nga kryqëzimi i të dhënave midis AMBU dhe MBZHR rezultuan 93 subjekte që përdorin burimet ujore për akuakulturë, të pa pajisura me leje përdorimi nga AMBU. Subjektet e pa pajisura me leje përdorimi të burimit ujor nuk janë faturuar për shpenzimet administrative të pajisjes me leje, duke sjellë të ardhura të munguara nga shpenzimet administrative të regjistrimit **të paktën rreth 2,464,000 lekë** (93 subjekte x 26,500 tarifa e aplikimit për leje). Si pasojë, subjektet e pa pajisura me leje në AMBU as nuk janë faturuar për prodhimin dhe shitjen e peshkut, duke sjellë të tjera të ardhura të munguara në vlerën 30,200,210 lekë (30,200,210 kg x 1 lekë) për tarifën e përdorimit të ujit. Në total, të ardhurat të munguara në buxhetin e shtetit përllëgariten **minimalisht në shumën 32,664,710 lekë**.
18. Në të gjithë Shqipërinë rezultojnë 567 burime ujore që përdoren për ujë të pijshëm nga Ujësjellësit, të pa pajisura me leje përdorimi nga AMBU. Si të tilla, ato nuk janë faturuar për shpenzimet administrative të aplikimit për leje përdorim burimi ujor, duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhet në shumën **15,025,500 lekë** (567 burime x 26,500 lekë/aplikim për burim).
19. Nga vizitat e kryera në terren u konstatua që në fshatin Tregan, Elbasan, rezultojnë minimalisht 50 subjekte të pa pajisura me leje përdorimi burimi ujor të ujërave termale/gjeotermale në AMBU, duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhet si pasojë e mos faturimit për shpenzimet administrative të pajisjes me leje, në shumën **5,250,000 lekë** (50 subjekte x 105,000 tarifa e aplikimit për leje).
20. AMBU nuk mban asnjë të dhënë mbi numrin e burimeve ujore që shfrytëzohen për qëllim turizmi/argëtimi (p.sh. në rastin e pishinave). Si pasojë të ardhurat e munguara nga mos aplikimi për pajisjen me leje për këto burime, nuk mund të llogariten (tarifa për aplikim për leje është 53,000 lekë/burim⁵⁷).
21. AMBU nuk ka informacion të saktë mbi numrin e burimeve ujore që shfrytëzohen për qëllim lavazhe. Si pasojë të ardhurat e munguara nga mos aplikimi për pajisjen me leje për këto burime, nuk mund të përllëgariten. (tarifat për pajisjen me leje për një lavazh është **28,000 lekë**⁵⁸).
22. Nga informacioni i dhënë nga ZABU Vjosë, në territorin e basenit në administrimin e saj, ekzistojnë rreth 54 subjekte që ushtrojnë aktivitet për lavazhe pa leje përdorimi burimi ujor. Si pasojë e mos pajisjes së këtyre lavazheve me leje përdorim burimi ujor, rezultojnë **1,512,000 lekë** (54 x 28,000⁵⁹) të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit nga tarifa e pajisjes me leje përdorimi të burimit ujor. Këtu nuk është përllëgaritur tarifa e përdorimit të ujit pasi në mungesë të lejes së përdorimit nuk ka të dhëna për sasinë e ujit të përdorur.
23. MBZHR administron 21 kanale ujitëse parësore dhe 7 rezervuare kryesore për ujtitje, të cilët nuk janë të pajisura me leje përdorimi të burimit ujor nga AMBU. Si pasojë e mos pajisjes së këtyre burimeve ujore me leje përdorimi rezultojnë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit nga tarifa e pajisjes me leje përdorimi të burimit ujor.

⁵⁶ <http://dpdetare.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Arritjet-e-Drejtorise-se-Pergjithshme-Detare.pdf>

⁵⁷ VKM nr. 1014, datë 16.12.2020 ËPër miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative për kërkesat për përdorimin, shkarkimin e ujit dhe ndërtimin e objekteve e veprave ujoreË pika 12 dhe pika 26

⁵⁸ VKM nr. 1014, datë 16.12.2020 ËPër miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative për kërkesat për përdorimin, shkarkimin e ujit dhe ndërtimin e objekteve e veprave ujoreË pika 7

⁵⁹ VKM nr. 1014, datë 16.12.2020 ËPër miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative për kërkesat për përdorimin, shkarkimin e ujit dhe ndërtimin e objekteve e veprave ujoreË pika 7

Konkluzione

14. AMBU nuk ka arritur plotësisht arkëtimin e debitorëve, duke mos maksimizuar të ardhurat, të cilat mund të ishin përdorur për kryerjen e aktiviteteve që nuk janë kryer si pasojë e mungesës së fondeve (*rreth 188,283,000 lekë të pambledhur*).
15. AMBU nuk ka arritur të maksimizojë mbledhjen e të ardhurave të veta, nga mos faturimet si pasojë e mos aplikimit për leje nga subjektet private dhe publike që përdorin burimet ujore (*minimalisht 89,591,210 lekë⁶⁰ të pa faturuar dhe pa arkëtuar*).

Rekomandime

- 15.1 AMBU të marrë masa për ndjekjen në rrugë ligjore të debitorëve, me qëllim arkëtimin e detyrimeve të pa paguara për të maksimizuar të ardhurat dytësore dhe bërë të mundur përdorimin e tyre për zhvillimin e aktiviteteve të domosdoshme në përputhje me objektivat strategjike të institucionit.

Brenda datës 30.06.2023 dhe në vijimësi

- 16.1 AMBU të marrë masa për identifikimin dhe verifikimin në kohë të të gjithë subjekteve që përdorin burimet ujore pa leje, për qëllime lundrimi, akuakulturë, ujësjellësit, ujëra termal/gjeotermalë, për argëtim/turizëm; lavazhe, etj, dhe referimin e tyre në inspektoratin përkatës për aplikimin e penaliteteve në rast se konstatohen shkelje. Në vijim, AMBU të procedojë për formalizimin e subjekteve që rezultojnë pa leje përdorimi të burimit ujore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Brenda datës 30.03.2023 dhe në vijimësi

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga AMBU është paraqitur observacioni me shkresë nr. 107/9 prot. datë 08.08.2022 óMbi Projektraportin e Auditimit nga Znj. G. L, me pozicion Drejtor i Përgjithshëm i AMBU, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit: Në vijim të përcjelljes së projekt-raportit të auditimit, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore me anë të shkresës nr. 901/2 prot., datë 08.08.2022, në lidhje me gjetjen nr. 15, thekson se ajo ka arkëtuar të gjitha tarifat administrative të faturura për periudhën 2019-2021. Në lidhje me debitë e akumuluar, theksojmë se ato përbëhen nga detyrime të palikujduara si pasojë e përdorimi të ujit si dhe nga detyrimet e lëna nga auditime të mëparshme nga KLSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Edhe pse komenti i AMBU lidhur me këtë gjetje nuk shpreh mos dakordësi sa i përket detyrimeve të pa arkëtuara, grupi i auditimit nuk ka ndryshuar problematikën e mos arkëtimin të detyrimeve por ka theksuar detyrimet e pa arkëtuara për periudhën objekt auditimi (2018-2021) dhe ka shtuar që rreth 93% e totalit të detyrimeve të pa arkëtuara nga AMBU i përkasin periudhës përpara 2018-2021.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Konkluzionin 14 “*AMBU nuk ka arritur plotësisht arkëtimin e debitorëve, duke mos maksimizuar të ardhurat, të cilat mund të ishin përdorur për kryerjen e aktiviteteve që nuk janë kryer si pasojë e mungesës së fondeve {rreth 188,283 mijë lekë të pambledhur}*”.

Observojmë se të ardhurat e arkëtuara për llogari të AMBU derdhen plotësisht në buxhetin e shtetit, ndaj nuk mund të përdoren për financime/kryerje aktiviteteve për AMBU-në.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Edhe pse grupi i auditimit është në dijeni që të gjitha të ardhurat e grumbulluara nga AMBU lidhur me përdorimin e burimeve ujore përfundojnë në buxhetin e shtetit, rritja e të ardhurave të grumbulluara mund të justifikojë rritjen e buxhetit të propozuar nga AMBU në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

⁶⁰ Shënim: Shuma e vlerave të cituara në gjetjet nr. 16, 17, 18, 19, dhe 23.

4.3 A kanë garantuar institucionet përgjegjëse mbikëqyrje të plotë ndaj përdoruesve të burimeve ujore?

4.3.1 A janë koordinuar midis tyre institucionet përgjegjëse lidhur me procesin e monitorimit të burimeve ujore?

Ligji nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreô i ndryshuar me Ligjin nr. 6/2018, datë 8.2.2018 neni 85 pika 6.1 Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, harton kërkesat për programet e monitorimit. Kuadri ligjor⁶¹ i fushës së mjedisit përcakton MTM dhe AKM si institucionet përgjegjëse për monitorimin, përfshirë këtu edhe hartimin e programit të monitorimit të mjedisit, pjesë e të cilit është edhe monitorimi i ujërave. Në këtë kuadër, grupi i auditimit është fokusuar në zbatimin e akteve ligjore/nënligjore në fuqi që lidhen me procesin e monitorimit të burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore. Programi kombëtar i monitorimit të mjedisit përcakton treguesit kryesorë të gjendjes, të ndikimit dhe të trysnisë në ajër, në ujëra sipërfaqësore e nëntokësore, në tokë, në zonën bregdetare, në detet, pyjet e në larminë biologjike. Për çdo tregues mjedisor, që matet apo llogaritet, ai përmban emrin e tij, mënyrën e përcaktimit, metodën e matjes dhe vendin e marrjes së mostrës, shpeshhtësinë dhe njësinë e matjes, mënyrën e përpunimit dhe të paraqitjes së të dhënave.

Në VKM nr.1189, datë 18.11.2009 óPër rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisitô, Aneksi I janë përcaktuar treguesit e gjendjes dhe të trysnisë së mjedisit, sipas përbërësve të tij si ajri, uji, toka e biodiversiteti. Grupi i auditimit është fokusuar vetëm në përbërësit që lidhen me objektin e këtij auditimi (burimet ujore). Më konkretisht referuar këtij Aneksi nga AKM duhen monitoruar treguesit si më poshtë:

4. Për ujërat:

4.1. Për ujërat sipërfaqësore (lumenjtë, liqenet):

- a) alkaliniteti;
- b) konduktivitetit specifik;
- c) aciditeti;
- ç) përmbajtja e nevojës kimike për oksigjenin, NKO;
- d) përmbajtja e nevojës biokimike për oksigjen, NBO;
- dh) përmbajtja e nitrateve dhe ozotit;
- e) përmbajtja e fosforit, P;
- ë) përmbajtja e anomikut, NH₃;
- f) vlera e pH-së;
- g) vlera e fonit radioaktiv natyror dhe radioaktiviteti i ujërave;
- gj) qëndrueshmëria e shtretërve të lumenjve;
- h) treguesit bakterialë;
- i) prurja e lumenjve.

4.3. Për ujërat nëntokësorë:

- a) pH;
- b) fortësia
- c) alkaliniteti;
- ç) aciditeti;
- d) përmbajtja e nitrateve;
- dh) shkalla e kripshmërisë.

4.4. Për ujërat sipërfaqësore, nëntokësore, detare ku ka burime të fuqishme të ndotjes industriale dhe bujqësore:

⁶¹ VKM nr.1189, datë 18.11.2009 óPër rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisitô

- a) përmbajtja e metaleve të rënda;
- b) përmbajtja e pesticideve;
- c) përmbajtja e komponimeve hidrokarburike.⁶²

Krahas Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore, në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Mjedisit (degë rajonale të AKM-së), përgatisin programet për parandalimin dhe shmangien e ndotjes së burimeve ujore pritëse nën juridiksionin e tyre, nga shkarkimet e lëngëta.⁶³

Direktiva Kuadër e Ujit 2000/60/EC në nenin 8 të saj citon ôMonitorimin e statusit të ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore dhe zonave të mbrojtura. Lidhur me monitorimin e ujërave, Direktiva Kuadër e Ujit 2000/60/EC është transpozuar me VKM nr. 1015, datë 16.12.2020 ôPër përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmytjetô. Për ujërat sipërfaqësore, programet e monitorimit të referuara në pikën 1 i këtij kreu, duhet të trajtojnë:

- a) vëllimin dhe nivelin ose normën e rrjedhjes në masën përkatëse për statusin ekologjik dhe kimik dhe potencialin ekologjik;
- b) statusin ekologjik;
- c) statusin kimik; dhe
- d) potencialin ekologjik.

Për ujërat nëntokësore monitorimi i programeve i referuar në pikën 1 i këtij kreu, duhet të trajtojë:

- a) statusin kimik; dhe
- b) statusin sasior.

Për zonat e mbrojtura, referuar nenit 85, të Ligjit nr. 111/2012, ôPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreô, të ndryshuar, programet e monitorimit të referuara në pikën 1 këtij kreu, duhet të plotësohen nga specifikime siç përmbahen në legjislacionin përkatës për këto zona.⁶⁴

Një tjetër çështje në të cilën grupi i auditimit është fokusuar në lidhje me monitorimin e ujërave është përzgjedhja e pikave të monitorimit si dhe shpeshësia mbi të cilat do të kryen matjet për të vlerësuar cilësinë e burimeve ujore. VKM nr. 1015, datë 16.12.2020 ôPër përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmytjetô ashtu si edhe Direktiva Kuadër e Ujit 2000/60/EC theksojnë rëndësinë që kanë në procesin e monitorimit ôpërzgjedhja e pikave të monitorimitô dhe ôpërzgjedhja e elementëve të cilësisëô.

Përzgjedhja e pikave të monitorimit

Monitorimi i mbikëqyrjes duhet të kryhet për trupa ujorë sipërfaqësorë të mjaftueshëm për të dhënë një vlerësim të statusit të përgjithshëm të ujërave sipërfaqësore brenda çdo baseni uxor ose nënbaseni të tyre. Në përzgjedhjen e këtyre trupave, ZABU-ja duhet të sigurojë ku është e mundur, që monitorimi është kryer në pikat ku:

- norma e rrjedhës së ujit është e konsiderueshme si e tërë brenda baseneve ujore; duke përfshirë pikat në lumenjtë e mëdhenj ku zona e shtrirjes është më e madhe se 2500 km²;
- vëllimi i ujit të pranishëm është i konsiderueshëm brenda baseneve ujore, duke përfshirë liqenet dhe rezervuarët e mëdhenj;
- kufirin e një shteti e kalojnë një numër i konsiderueshëm trupash ujorë; dhe

⁶² VKM nr.1189, datë 18.11.2009 ôPër rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisitô, Aneksi I.

⁶³ Ligji nr. 111/2012 ôPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreô neni 30 pika 1 ôi ndryshuarô

⁶⁴ Direktiva Kuadër e Ujit 2000/60/EC neni 8 & VKM nr. 1015, datë 16.12.2020 ôPër përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmytjetô, Kreu 6, pika 5,6,7.

- në vende të tjera që kërkohen për të llogaritur ngarkesën e ndotësve që është transferuar nëpërmjet kufijve të shteteve, dhe që është transferuar në mjedisin detar.⁶⁵

Përzgjedhja e elementeve të cilësisë

Për të vlerësuar madhësinë e trysnisë së cilës i nënshtrohen trupat me ujëra sipërfaqësore, Institucionet shtetërore përgjegjëse për monitorimin duhet të monitorojnë ato elemente të cilësisë të cilat janë tregues të trysnive të cilave i/u nënshtrohen trupi ose trupat. Për të vlerësuar ndikimin e këtyre trysnive, Institucionet shtetërore përgjegjëse për monitorimin duhet të monitorojnë sipas nevojës:

- parametrat tregues të elementit ose elementeve biologjike të cilësisë, që janë më të ndjeshme ndaj trysnive të cilave u nënshtrohen trupat ujorë;
- të gjitha substancat përparësore të shkarkuara dhe ndotësit e tjerë të shkarkuar në sasi të konsiderueshme;
- parametrat tregues të elementeve të cilësisë hidromorfologjike më të ndjeshëm ndaj trysnisë së identifikuar.

Shpeshtësia e monitorimit

Për periudhën e monitorimit mbikëqyrës, shpeshtësia për monitorimin e parametrave tregues të elementeve të cilësive fiziko-kimike të dhëna më poshtë duhet të zbatohet në qoftë se nuk do të justifikohen intervale më të mëdha në bazë të njohurive teknike dhe të gjykimit të ekspertëve. Për elementet biologjike ose hidromorfologjike të cilësisë monitorimi duhet të kryhet të paktën një herë gjatë periudhës së monitorimit tëurvejimit. Për monitorimin operacional, shpeshtësia e monitorimit e kërkuar për çdo parametër duhet të përcaktohet nga AMBU-ja në mënyrë që të sigurohen të dhëna të mjaftueshme për një vlerësim të besueshëm të statusit të elementeve përkatës të cilësisë. Si një udhëzues, monitorimi duhet të zhvillohet në intervale që nuk i tejkalojnë ato që tregohen në tabelën e mëposhtme në qoftë se intervale më të madhe nuk do të jenë të justifikuara në bazë të njohurive teknike dhe gjykimit të ekspertëve. Shpeshtësia do të zgjidhet në mënyrë që të arrihet një nivel i pranueshëm besimi dhe saktësie. Llogaritjet e besimit dhe të saktësisë të përfutuara me anë të sistemit të monitorimit të përdorur duhet të konstatohen në Planin e menaxhimit të baseneve ujore. Duhet të zgjidhen shpeshtësi të monitorimit që marrin në konsideratë ndryshueshmërinë e parametrave që rezultojnë si nga kushtet natyrore ashtu edhe ato antropogjene. Kohët në të cilat do të ndërmerret monitorimi duhet të zgjidhen në mënyrë që të minimizojnë ndikimin e ndryshimeve sezonale në rezultate, dhe kështu të sigurojnë që rezultatet pasqyrojnë ndryshimet në trupat ujorë si rezultat i ndryshimeve për shkak të trysnisë antropogjenike. Për të arritur këtë objektiv, kur është e nevojshme, duhen kryer monitorime të tjera shtesë gjatë stinëve të ndryshme të të njëjtit vit.

⁶⁵ VKM nr. 1015, datë 16.12.2020 óPër përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmytjetó, fq. 43

Tabela nr . 14 Shepshtësia për monitorimin e treguesve të cilësive fiziko-kimike

Elementi i cilësisë	Lumenjtë	Liqenet	Ujërat tranzitorë	Ujërat bregdetarë
Biologjik				
Fitoplanktoni	6 muaj	6 muaj	6 muaj	6 muaj
Flora tjetër ujore	3 vjet	3 vjet	3 vjet	3 vjet
Makro invertebrorët	3 vjet	3 vjet	3 vjet	3 vjet
Peshqit	3 vjet	3 vjet	3 vjet	
Hidromorfologjik				
Vazhdimësia	6 vjet			
Hidrologjia	në vazhdimësi	1 muaj		
Morfologjia	6 vjet	6 vjet	6 vjet	6 vjet
Fiziko-kimike				
Kushtet termike	3 muaj	3 muaj	3 muaj	3 muaj
Oksigjenimi	3 muaj	3 muaj	3 muaj	3 muaj
Kripësia	3 muaj	3 muaj	3 muaj	
Statusi i ushqyesve	3 muaj	3 muaj	3 muaj	3 muaj
Statusi i acidifikimit	3 muaj	3 muaj		
Ndotësit e tjerë	3 muaj	3 muaj	3 muaj	3 muaj
Substancat përparësore	1 muaj	1 muaj	1 muaj	1 muaj

Burimi: VKM nr 1015, datë 16.12.2020, fq 45.

Gjetje nga auditimi

24. AMBU në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet e mjedisit duhet të hartojë programin e monitorimit lidhur me burimet ujore.⁶⁶ Nga auditimi rezultoi se, AMBU nuk është përfshirë në asnjë monitorim të kryer nga AKM. Mos përfshirja e AMBU ka sjellë edhe mungesën e monitorimeve të një sërë parametrash dhe treguesish si produktet për mbrojtjen e bimëve dhe biocidet të cilat më pas shërbejnë për hartimin dhe përpilimin e Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore. Një nga shkaqet kryesore të cilat kanë çuar në këtë situatë është mos përputhja e VKM nr.1189, datë 18.11.2009 me Ligjin e menaxhimit të burimeve ujore.
25. AKM duhet të kryejë monitorimin e treguesve të gjendjes dhe trysnisë që ushtrohet në mjedis nga burimet e ndotjes, në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore⁶⁷. Nga auditimi rezultoi se, AKM nuk ka kryer asnjë monitorim të parametrave të kërkuar si niveli i fondit radioaktiv natyror dhe radioaktiviteti i ujërave, qëndrueshmëria e shtretërve të lumenjve, treguesit bakterialë, përmbajtjen e pesticideve si dhe përmbajtjes së komponimeve hidrokarburike, duke mos dhënë siguri mbi nivelin e ndikimit të tyre në cilësinë e burimeve ujore dhe shëndetin e njeriut.
26. Ka munguar bashkëpunimi mes Agjencive Rajonale të Mjedisit (ARM) dhe ZABU-ve për përgatitjen e programeve për parandalimin dhe shmangien e ndotjes së burimeve ujore pritëse nën juridiksionin e tyre, nga shkarkimet e lëngëta. Nga ana e tyre nuk janë marrë masa duke rritur riskun që burimet ujore pritëse të jenë të një cilësie jo të mirë duke u prirur drejt ndotjes.
27. Nga auditimi rezultoi se AKM nuk ka parashikuar kriteret dhe metodologjinë që përdor, për përcaktimin e stacioneve ku do të kryhet monitorimi i secilit burim ujor (p.sh. një lumë ose një liqen), si dhe frekuencën/shpeshtësinë e monitorimit, pasi ky proces vijon të mbështetet mbi Projektin CEMSA (projekt i vitit 2011), ku dhe ky ky i fundit nuk e ofron një informacion të tillë. Sa më sipër, ky proces nuk jep siguri nëse stacionet e përzgjedhura, janë përfaqësuese për cilësinë e ujit të burimit që po monitorohet.

⁶⁶ Ligji nr. 111/2012 ËPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreË neni 85 pika 6.1 Ëi ndryshuarË

⁶⁷ VKM nr.1189, datë 18.11.2009 ËPër rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të MjedisitË, Aneksi I.

Konkluzione

16. Ka munguar bashkëpunimi mes AKM dhe AMBU, dhe degëve rajonale të tyre, duke lënë jashtë fokusit të monitorimeve, shqyrtimin e parametrave dhe treguesve të rëndësishëm për matjen e cilësisë dhe nivelit të ndotjes së burimeve ujore.
17. Si pasojë e mungesës së një metodologjie të përzgjedhjes së stacioneve, për monitorimin e burimit ujor, nuk japim dot siguri mbi besueshmërinë e të dhënave për cilësinë e ujit.

Rekomandime

- 24.1 AKM dhe AMBU të bashkëpunojnë dhe të koordinohen midis tyre gjatë procesit të ardhshëm të monitorimit të burimeve ujore me qëllim përthithjen e të dhënave të nevojshme nga ana e AMBU e cila do të përdorë për hartimin e Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore dhe më gjerë.

Në vazhdimësi

- 25.1 Deri në përditësimin e VKM nr. 1189 datë 18.11.2009, AKM të marrë masa dhe të monitorojë vlerën e fonit radioaktiv natyror dhe radioaktivitetin e ujërave, qëndrueshmërisë së shtretërve të lumenjve, treguesve bakterialë, përmbajtjen e pesticideve si dhe përmbajtjes së komponimeve hidrokarburike.⁶⁸

Në vazhdimësi

- 26.1 ZABU-të në bashkëpunim me AKM (ARM-të) të marrin masa për të përgatitur programet për parandalimin dhe shmangien e ndotjes së burimeve ujore pritëse nën juridiksionin e tyre, me qëllim përmirësimin e cilësisë së burimeve ujore në juridiksionin e tyre.

Në vazhdimësi

- 27.1 AKM në bashkëpunim me AMBU, gjatë hartimit të programeve të ardhshme të monitorimit të burimeve ujore të përcaktojë saktë dhe qartë përzgjedhjen e pikave të stacioneve të monitorimit, numrit të tyre që janë të domosdoshëm për të dhëna të sakta e të besueshme, frekuencën dhe shpërndarjen e tyre.

Në vazhdimësi

4.3.2 A kanë në dispozicion strukturat e kontrollit dhe inspektimit të burimeve ujore logjistikën e nevojshme dhe burimet njerëzore dhe a janë koordinuar midis tyre për realizimin e detyrave kontrolluese dhe inspektuese?

Strukturat përgjegjëse për kontrollim dhe inspektimin


Referuar Ligjit nr. 111/2021 datë 15.11.2012 ⁶⁸Për menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore⁶⁸ i ndryshuar, dhe VKM nr. 221, datë 26.4.2018 ⁶⁸Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, AMBU nëpërmjet ZABU është përgjegjëse për kontrollin dhe zbatimin e kushteve të lejeve të përdorimit të burimeve ujore si dhe verifikimin në tërësi të subjekteve që përdorin burime ujore duke nxitur përdoruesit e burimeve ujore. Sa i përket inspektimit, përdorimi i burimeve ujore natyrore i nënshtrohet kontrollit administrativ nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore dhe inspektimit nga inspektorët që mbulojnë fushën e kontrollit të veprimtarisë në përdorimin e burimeve ujore, nën menaxhimin e përgjithshëm të AMBU-së. Këto organe janë AKM dhe IKMT⁶⁸ dhe janë përcaktuar respektivisht me anë të VKM nr. 568, datë 17.7.2019 ⁶⁸Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit⁶⁸ dhe VKM nr. 515, datë 17.07.2019 ⁶⁸Për një shtesë në Vendimin nr. 502 datë 13.09.2017, të Këshillit të Ministrave, ⁶⁸Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme⁶⁸.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore/ Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore

Struktura e AMBU-së është miratuar me Urdhrin e KM nr. 152 datë 01.10.2018 ⁶⁸Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore⁶⁸, i ndryshuar. Referuar këtij urdhri struktura përgjegjëse në AMBU për kontrollin është Sektori i Monitorim-Kontrollit.

⁶⁸ Shënim: IKMT duke mos qenë subjekt i këtij auditimi nuk është trajtuar gjerësisht sepse auditimi nuk ka për qëllim vlerësimin e performancës së këtij institucioni.


Figura nr. 8. Struktura e AMBU-së



Burimi: AMBU

Struktura e AMBU-së është e organizuar në nivel qendror dhe në nivel rajonal. Siç është përmendur edhe në kapitujt e mësipërm, janë pikërisht katër zyrat në nivel rajonal ose ZABU që kryejnë monitorimin dhe kontrollin e territorit sa i përket përdorimit të burimeve ujore për 7 basenet ujore. Secila nga Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore ka pjesë të strukturës së saj Sektorin e Lejeve dhe Monitorim-Kontrollit, i cili ka për detyrë ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kushteve e të kritereve të përcaktuara në lejet/autorizimet e dhëna për përdorimin e ujit, duke ndërmarrë dhe masa ndaj subjekteve që gjenden në shkelje⁶⁹.

Fig. nr. 9. Struktura e ZABU-ve



Burimi: AMBU

⁶⁹ VKM nr. 221, datë 26.04.2018 për Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore Kreu III, pika 4 germa dh.

Në strukturën e AMBU-së/ZABU-ve numri i punonjësve të miratuar me Urdhrin e KM nr. 152, datë 01.10.2018 óPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujorë i ndryshuar, është në total 82 pozicione nga të cilat për AMBU-në 42 pozicione dhe për katër ZABU-të 40 pozicione. Nga auditimi i strukturave të AMBU-së dhe ZABU-ve rezulton se, në fund të vitit 2021 në AMBU ka 11 vende vakante ndërsa në të katër ZABU-të ka 12 vende vakante. Përkatësisht, në ZABU Ishëm-Erzen-Mat ka 2 vende vakante nga 11 gjithsej, në ZABU Shkumbin-Seman ka 7 vende vakante nga 11 gjithsej dhe në ZABU Vjosë ka 3 vende vakante nga 9 gjithsej. Në nivel rajonal vakancat janë në masën 30% ndërsa në nivel AMBU dhe ZABU vakancat përbëjnë 28% të totalit të pozicioneve. Sa më sipër, vihet re se ZABU Shkumbin-Seman është pothuajse jo funksionale duke sjellë mos përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi nga kjo strukturë rajonale. Në Sektorin e Lejeve të Monitorim-Kontrollit nga 7 pozicione janë të pa plotësuar 4 pozicione duke sjellë që numri i kontroleve lidhur me zbatimin e kushteve të lejeve apo për identifikimin e subjekteve që përdorin burime ujore pa leje të jetë shumë i ulët.

AMBU në zbatim të kuadrit ligjor për nëpunësin civil ka hedhur në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore HRMIS vendet e lira të cilat më pas janë administruar nga Departamenti i Administratës Publike. Rezulton se, pavarësisht publikimit të vendeve të lira procesi i rekrutimeve ka ecur shumë ngadalë ose nuk ka rezultuar efektiv duke mos patur aplikues apo duke mos patur fitues. Nga AMBU identifikohen disa arsye që ndikojnë në mosplotësimin e strukturës me numrin e plotë dhe kapacitet e nevojshme që lidhen me kriteret e kualifikimit që janë për diploma të profilit inxhinierik apo me nivelin e pagave në degët rajonale. Nga ana e AMBU-së nuk rezulton që, të jetë kryer ndonjë analizë lidhur me këtë çështje, të jenë marrë masa të mëtejshme për të zgjidhur këtë problematikë apo për të nxitur dhe ndjekur me përparësi plotësimin e vendeve të lira me qëllim funksionimin e strukturave me kapacitet të plotë.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Në strukturën e saj AKM ka Drejtorinë e Inspektimit dhe Kontrollit (DIK) - Sektorin i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave). Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit ka kaluar si pjesë e strukturës së AKM-së në bazë të VKM-së nr. 568, datë 17.7.2019 óPër krijimin, mënyrën e Organizimit dhe të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në përfundim të procesit të ristrukturimit. Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) funksionon në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 óPër menaxhimin e burimeve ujorë, i ndryshuar, neni 96, pika 1 ó*Kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet nga inspektoratet kombëtare përgjegjëse për kontrollin e territorit, mjedisit dhe ujërave, në përputhje me këtë ligj, ligjin për inspektimin dhe aktet ligjore e nënligjore për funksionimin e tyre, nën menaxhimin e përgjithshëm të AMBU-së (si një pjesë e ciklit të menaxhimit të integruar të burimeve ujorë)* dhe VKM-së nr. 568, datë 17.7.2019 ku AKM-së i caktohet si përgjegjësi edhe inspektimi dhe kontrolli tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore⁷⁰.

Nga auditimi rezulton se, referuar strukturës së AKM-së, Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) në nivel qendror dhe degët rajonale ka në total 20 inspektorë dhe nuk ka vende vakante.

Mbi logjistikën e nevojshme të sektorëve përgjegjës për kontroll-inspektimin

Përdorimi i burimeve ujore natyrore i nënshtrohet kontrollit administrativ nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore dhe inspektimit nga inspektorët që mbulojnë fushën e kontrollit të veprimtarisë në përdorimin e burimeve ujore, nën menaxhimin e përgjithshëm të AMBU-së, si një pjesë e ciklit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore⁷¹. Kontrollat

⁷⁰ VKM-së nr. 568, datë 17.7.2019 óPër krijimin, mënyrën e Organizimit dhe të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Kreu II, pika 4.

⁷¹ Ligji nr. 111/2012 datë 15.11.2012 óPër menaxhimin e integruar të Burimeve Ujorë i ndryshuar, neni 39.

ushtrohen në disa aspekte/elementë kryesor të zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, sikurse është kontrolli dhe inspektimi mbi zbatimin e kushteve të lejeve të dhëna për përdorimin e burimeve ujore, mbi identifikimin e subjekteve që përdorin burimet ujore pa lejen përkatëse, mbi vlerësimin e sasisë së ujit që jepet për përdorim, mbi rrjedhën minimale ekologjike që çdo përdorues i ujit është i detyruar që në rrjedhën natyrore të lejojë, duke mos e përfshirë atë në sasinë e ujit që është i autorizuar të përdorë, mbi normat dhe cilësinë e ujërave të shkarkuara nga subjektet që përdorin burimet ujore. Për të kryer procesin e kontrollit dhe inspektimit të këtyre aktiviteteve, sasive dhe parametrave të ujit strukturat përkatëse të kontrollit dhe të inspektimit (ZABU-të dhe AKM/ Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) duhet të jenë të pajisur me pajisjet/aparaturat dhe të gjithë logjistikën e duhur. Nga auditimi rezulton se, në nivel rajonal asnjë nga ZABU-të nuk ka pajisjet dhe mjetet logjistike për të monitoruar sasinë e ujit që jepet për përdorim, rrjedhën minimale ekologjike, si dhe zbatimin në tërësi të kushteve të vendosura në lejet/autorizimet për përdorimin e burimeve ujore. Si rezultat, AMBU si organi përgjegjës në nivel kombëtar për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, kontrollin dhe inspektimin lidhur me përdorimin e burimeve ujore natyrore nuk ka të dhëna lidhur me zbatimin e përcaktimeve të ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 óPër menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore ô i ndryshuar, neni 39, pika 1. Struktura tjetër me detyra dhe përgjegjësi për inspektimin lidhur zbatimin e kuadrit ligjor nga përdoruesit e burimeve ujore natyrore është AKM nëpërmjet Sektorit të Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) në nivel qendror dhe degët rajonale. Nga auditimi rezulton se, situata është e njëjtë edhe në AKM ku mungojnë mjetet dhe pajisjet e duhura për të vlerësuar cilësinë apo normat e ujërave të shkarkuara nga subjektet që përdorin ujin, për të vlerësuar dhe matur plotësisht këto norma.

Mbi hartimin dhe realizimin e planit të kontrolleve dhe inspektimeve

Plani i kontrolleve të ZABU-ve

Të gjitha ZABU-të në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 óPër menaxhimin e integruar të Burimeve Ujoreô i ndryshuar dhe të VKM-së nr. 221, datë 26.04.2018 për óOrganizimin dhe funksionimin e agjencisë së menaxhimit të burimeve ujoreô hartojnë planet vjetore dhe mujore të punës të cilat i paraqesin në AMBU. Draft planet diskutohen në takimet periodike që ZABU-të kanë me AMBU-në dhe si rezultat planet e dërguara nga ZABU-të konsiderohen nga AMBU si plane të miratuara. Lidhur me këto plane pune AMBU nga ana e saj nuk jep një miratim shkresor drejtuar ZABU-ve. Për hartimin e planeve vjetore të punës AMBU ka hartuar një metodologji e cila ju është bërë me dije të gjitha ZABU-ve në muajin dhjetor 2020. Nga auditimi rezulton se, ZABU-të planet vjetore të punës për vitin 2021 nuk i kanë hartuar bazuar në kriteret e miratuara nga AMBU ku të përcaktohet mbulimi me kontroll-monitorim sipas kronologjisë, kapaciteteve dhe rëndësisë por hartojnë një plan pune ku përshtrohen masat që do të merren gjatë vitit në funksion të arritjes së objektivave. Në planet vjetore të punës nuk përcaktohen subjektet që do të kontrollohen, nuk përcaktohet numri i kontrolleve vjetore që do të kryhen në përputhje me kapacitetet dhe logjistikën. Nga auditimi i dokumentacionit në dispozicion rezulton se për vitin 2021 në nivel kombëtar nga të katër ZABU-të janë kryer në total 773 kontroll-monitorime, ndërsa për vitet e tjera të dhënat nuk janë të plota dhe nuk mund të llogaritet numri total i kontroll-monitorimeve në nivel kombëtar. Në mungesë të një planifikimi të detajuar është e pamundur të llogaritet se sa % e planit të kontrollit është zbatuar.

Plani i inspektimeve nga AKM

Për vitin 2018, Drejtoria e Inspektimit të Ujërave nuk ka qenë pjesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve dhe nuk ka të dhëna lidhur me numrin e inspektorëve dhe të inspektimeve.

Për vitin 2019, referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) në AKM plani vjetor i inspektimeve është miratuar me shkresën nr. 6898/3 datë 10.12.2018 ku janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 2577 inspektime (2148 inspektime të planifikuara + 20% të paplanifikuara rast pas rasti). Metodologjia e përdorur për llogaritjen e planit

vjetor të inspektimit bazohet mbi: numrin e ditëve të vitit - numrin e ditëve të pushimeve të fundjavës - numrin e ditëve të festave zyrtare - numrin e ditëve të lejes vjetore - numrin e ditëve për punë zyre - numrin e ditëve të trajnimeve - numrin e ditëve të pa aftësisë së përkohshme në punë. Për vitin 2019 numri total i inspektorëve ka qenë 39. Nga auditimi rezulton se, plani është realizuar në masën 58%, nga 2577 inspektime të planifikuara janë realizuar në total 1485 inspektime (-1092), nga këto inspektime janë marrë 44 masa óparalajmërimô, 12 masa ópezullim dhe mbyllje aktivitetiô dhe 29 ógjjobaô. Një nga arsyt e mos realizimit të gjithë planit të Inspektimeve të parashikuar për vitin 2019, është edhe transferimi i Inspektoratit Shtetëror të Ujërave (ISHU), nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit.

Për vitin 2020, Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) në nivel qendror dhe sektorët e Ujërave në Degët Rajonale të AKM-së, deri më 1 Korrik 2020, kanë qenë në vartësi të ISHMPUT-së. Gjatë periudhës 1 Janar 2020-1 Korrik 2020 këta sektorë nuk kanë ushtruar aktivitet si rezultat i procesit të ristrukturimit, kalimit në strukturën e AKM-së referuar VKM-së nr. 568, datë 17.7.2019 cituar më sipër, si dhe më pas për shkak të Pandemisë Covid-19. Me përfundimin e ristrukturimit të plotë të ISHMPUT-së, më 01.07.2020 sektorët e lartpërmendur u përfshinë në Drejtorinë e Inspektimit në Kontrollit(DIK), në vartësi të AKM-së. Me kalimin si pjesë e strukturës së AKM-së numri i inspektorëve në sektorin e ujërave në nivel qendror dhe në nivel rajonal është miratuar në total 20 inspektorë.

Nga auditimi rezulton se, plani i inspektimeve është realizuar në masën 22% nga 343 inspektime të planifikuara janë realizuar 74 inspektime (-269). Një nga arsyt që ka ndikuar në mos realizimin e planit të inspektimeve ka qenë edhe angazhimi i inspektorëve të AKM-së përfshirë këtu edhe inspektorët e Sektorit të Ujërave, për periudhën 21.10.2020 deri në 31.12.2020 në zbatimin e masave të sigurisë dhe sensibilizimin e qytetarëve gjatë pandemisë. Ky angazhim ka ardhur në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 156, datë 10.03.2020, óPër marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19ô, si dhe Urdhrit të Inspektorit të Përgjithshëm nr. 28, datë 21.10.2020, óPër bashkërendimin e inspektimeve për zbatimin e protokolleve të sigurisë në kuadër të task forcës Anti Covid-19ô.

Për vitin 2021, programi i inspektimit është miratuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 635/1 Prot. datë 23.12.2020. Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) në nivel qendror dhe sektorët e ujërave në degët rajonale duhet të realizojnë gjithsej 828 inspektime (660 inspektime të planifikuara + 20% të paplanifikuara rast pas rasti). Nga auditimi rezulton se, **për periudhën 1 Janar 2021 - 31 Maj 2021**, Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) në nivel qendror dhe sektorët e ujërave në degët rajonale **nuk kanë ushtruar aktivitet**. Për periudhën Qershor-Dhjetor 2021, plani i inspektimeve është realizuar në masën 35% nga 828 inspektime të planifikuara janë në total 290 inspektime (-538). Numri total i inspektorëve është 20. Ajo që vihet re është se, me kalimin e Sektorit të Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) në varësi të AKM-së kanë filluar inspektimet në muajin Gusht 2020 gjatë vitit pandemik por inspektimet janë ndërprerë për periudhën 1 Janar 2021 - 31 Maj 2021, ndërprerje kjo e pa bazuar dhe e pa justifikuar pasi në vitin 2021 pandemia nuk ka përbërë më një pengesë për kryerjen e detyra funksionale nga institucionet e administratës publike në këtë rast nga Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave).

Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) në nivel qendror dhe rajonal duke mos kryer të gjitha inspektimet referuar planit të miratuar apo duke mos kryer fare inspektime për periudhën 1 Janar 2021 - 31 Maj 2021 nuk ka përmbushur detyrat e tij funksionale referuar óRregullores së Brendshme për organizimin dhe Funksionimin e AKM-së dhe Agjencive Rajonale të Mjedisitô nr. 120 Prot. datë 12.01.2021, Kreu IV.

Mbi koordinimin dhe bashkëpunimin e strukturave përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin

Në zbatim të ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 për ôMenaxhimin e integruar të Burimeve Ujoreô i ndryshuar, inspektoratet, që mbulojnë fushën e mjedisit, shëndetësisë dhe bujqësisë, janë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave ligjore nën menaxhimin e përgjithshëm të AMBU-së⁷². Nga shqyrtimi i korrespondencës shkresore dhe dokumenteve të tjera të ZABU-ve është identifikuar që ZABU Vjosë në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional në vitin 2020 i është drejtuar institucioneve përgjegjëse siç janë IKMT dhe ARM-të në 14 raste që ka identifikuar subjekte që përdorin burimet ujore natyrore në mos respektim të përcaktimeve ligjore. Në vitin 2021 ka raportuar në IKMT 32 raste dhe në ARM 11 raste duke kërkuar marrjen e masave nga këto institucione në zbatim të përgjegjësisë të tyre si dhe më pas të informojnë ZABU-në lidhur me vazhdimësinë e këtyre rasteve. ZABU Vjosë apo AMBU për asnjë rast nuk ka marrë informacion nëse janë kryer nga këto struktura inspektive për të verifikuar raportimet e bëra nga ZABU. Mungesa e bashkëpunimit ndikon direkt në numrin e subjekteve aktive të pajisura me leje në basenin ujqor të Vjosës.

Grupet e inspektimit të ngritur nga Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) në AKM, në rastet kur kanë konstatuar subjekte që përdorin burimin ujqor pa leje të Autoriteteve të Ujqit, kanë marrë masë administrative mbështetur në legjislacion në fuqi, dënim me gjobë, paralajmërim dhe caktim detyrash konkrete për tû pajisur me leje të përdorimit të burimit ujqor nga AMBU. Këto masa, Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) në AKM, i ka marrë kryesisht referuar indicieve që kanë ardhur nga AMBU mbështetur në praktikën shkresore dhe bashkëpunimin ndërmjet AKM-së dhe AMBU-së, si dhe gjatë inspektimeve në terren në zbatim të planit të inspektimeve.

Drejtoria e Inspektim Kontrollit në AKM, gjatë hartimit të programit vjetor të inspektimit nuk bashkëpunon me AMBU-në. Programet vjetore të inspektimeve rakordohen me Inspektoratin Qendror dhe miratohen nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit. Drejtoria e Inspektim Kontrollit në AKM nuk dërgon raporte/relacione periodike mbi veprimtarinë e inspektimit në AMBU, bashkëpunimi me AMBU-në qëndron lidhur me subjektet që identifikohen në shfrytëzim të burimeve ujore pa lejen përkatëse. Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave), për periudhën 2019-2021, referuar tabelës në vijim ka identifikuar 749 subjekte pa leje për përdorimin e burimeve ujore, të cilët duhet të aplikojnë pranë Zyrrave të Administrimit të Burimeve Ujore për tû pajisur me lejen përkatëse të përdorimit të ujqit.

Tabela nr. 15. Subjektet e identifikuar nga AKM si përdorues të ujqit pa leje përdorimi për periudhën 2019-2021

Nr.	Dega Rajonale	Subjekte të Njqftuara
1	Dega Rajonale Fier	35 subjekte
2	Dega Rajonale Durrës	240 subjekte
3	Dega Rajonale Shkodër	69 subjekte
4	Dega Rajonale Berat	74 subjekte
5	Dega Rajonale Kukës	14 subjekte
6	Dega Rajonale Korçë	121 subjekte
7	Dega Rajonale Elbasan	196 subjekte
	Totali	749 Objekte

Burimi: AKM

⁷² Ligji nr. 111/2012 datë 15.11.2012 ôPër menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore ô i ndryshuar, neni 95, pika 2.

Nga ana tjetër edhe ZABU-të gjatë kontrolleve të kryera në terren kanë identifikuar subjekte të pa pajisur me leje për përdorimin e ujit që referuar tabelës në vijim për periudhën 2019-2021 janë në total 244 subjekte.

Tabela nr.16. Subjektet e identifikuara nga ZABU-të si përdorues të ujit dhe të pa pajisur me leje përkatëse për periudhën 2019-2021

Viti	Nr. i subjekteve me leje	Nr. i kontrolleve nga AMBU/ZABU-ve	Nr. i kontrolleve nga AMBU/ZABU-ve për subjektet pa leje
2018	796	Të dhënat janë administruar nga MBZHR	Të dhënat janë administruar nga MBZHR
2019	835	292	26
2020	907	498	66
2021	976	725	152
			244

Burimi: ZABU-të

Nga auditimi rezulton se, nga inspektimet e AKM-së, janë raportuar pranë AMBU-së 749 subjekte të pa pajisur me lejen përkatëse për përdorimin e burimeve ujore ndërsa nga ZABU-të janë identifikuar 244 subjekte.⁷³ Referuar regjistrin të lejeve që administron AMBU i paraqitur në Aneksin nr.1, rezulton se, për periudhën 2019-2021 janë pajisur me leje për përdorimin e burimeve ujore për qëllime të ndryshme 190 subjekte duke treguar qartë se numri i subjekteve të identifikuara pa leje dhe që vazhdojnë aktivitetet në mënyrë të parregullt mbetet ende i lartë.

Veprime këto në mos respektim të përcaktimeve të ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 óPër menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore ô i ndryshuar, neni 41, *Përdorimi me leje i ujit “Veprimtaritë e mëposhtme, që mund të kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, do të ushtrohen në bazë të lejes administrative të lëshuar nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore: a) Përdorimi i ujit, kur ky realizohet me instalime të përhershme; b) Ujitja; c) Përdorime industriale të ujit sipërfaqësor; ç) Ujë për pishina; d) Ujë i ambalazhuar; dh) Ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale; e) Shfrytëzimi i ujërave nëntokësore për qëllime të ndryshme; ë) Dhënia në përdorim e burimeve ujore për zhvillimin e akuakulturës”.*

Bashkëpunimi AMBU-MBZHR

Referuar Ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreô, i ndryshuar neni 38, germa b, burimet ujore përdoren për qëllime të ndryshme përfshirë dhe për akuakulturë.

Në zbatim të Ligjit nr. 103/2016 óPër Akuakulturënô, neni 8 dhe neni 10, pika 1, sipërfaqet ujore të Republikës së Shqipërisë u jepen me qira, sipas procedurave të parashikuara në nenin 8, të këtij ligji, personave juridikë e fizikë, për të ushtruar veprimtarinë e akuakulturës intensive, me qëllim shfrytëzimin e këtyre sipërfaqeve, në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm⁷⁴.

Autoriteti përgjegjës që jep të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës, nëpërmjet lidhjes së kontratës përkatëse me personat fizikë apo juridikë, për ushtrimin e këtij aktiviteti është MBZHR (DSHPA)⁷⁵.

⁷³ *Grupi i auditimit nuk llogariti totalin e subjekteve të identifikuara pa leje nga AKM dhe ZABU-të si shumë e të dyja sepse ka subjekte që mund të jenë identifikuar si nga AKM edhe nga ZABU-të.

⁷⁴ Ligji nr. 103/2016 óPër Akuakulturënô, neni 8 Veprimtaria e Akuakulturës dhe neni 10, pika 1.

⁷⁵ Ligji nr. 103/2016 óPër Akuakulturënô, neni 15, pika 1.

Ndërsa referuar ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 për ôMenaxhimin e integruar të Burimeve Ujore ô i ndryshuar, neni 7germa ç, AMBU është organi përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë.

Këto dy institucione duhet të bashkëpunojnë dhe koordinohen lidhur me hartimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave për subjektet që janë pajisur me leje për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës. Për sa më sipër, AMBU i ka dërguar MBZHR-së shkresën nr. 1095 Prot. datë 07.10.2020 ku kërkon informacion lidhur me personat fizikë dhe juridikë që MBZHR ka lidhur kontrata për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës. MBZHR nga ana e saj me shkresën nr. 7950/1 Prot. datë 22.10.2020 i ka dërguar AMBU-së listën përkatëse të kontratave që ka lidhur duke paraqitur një numër total prej 75 kontrata të lidhura për këtë aktivitet.

AMBU, pasi ka kryer verifikimin dhe kryqëzimin e listës së subjekteve që kanë lidhur kontrata me MBZHR-në dhe atyre të pajisura me leje nga AMBU për përdorimin e burimeve ujore për aktivitetin e akuakulturës ka rezultuar se vetëm 1 subjekt nga 75 është i pajisur me leje edhe nga AMBU. Për 74 subjektet e tjerë që ushtrojnë aktivitetin e akuakulturës jo në përputhje me dispozitat për menaxhimin e burimeve ujore (pa leje përdorimi nga AMBU), AMBU ka njoftuar ZABU-të përkatëse për të marrë masat dhe te angazhohen në verifikimin e rasteve dhe njoftimin e përdoruesve për t'u pajisur me leje. Përkatësisht:

- Shkresa nr. 1262 Prot. datë 10.11.2020 drejtuar ZABU-së Drin-Bunë për të verifikuar 7 subjekte të pa pajisur me leje;

- Shkresa nr. 1263 Prot. datë 10.11.2020 drejtuar ZABU-së Ishëm-Erzen-Mat për të verifikuar 3 subjekte;

- Shkresa nr. 1264 Prot. datë 10.11.2020 drejtuar ZABU-së Shkumbin-Seman për të verifikuar 7 subjekte;

- Shkresa nr. 1265 Prot. datë 10.11.2020 drejtuar ZABU-së Vjosë për të verifikuar 57 subjekte.

Referuar shkresave të dërguara nga AMBU, ZABU-të nga ana e tyre kanë kryer kontrollet përkatëse dhe kanë raportuar në AMBU si vijon:

- ZABU Drin-Bunë shkresa 353/1 Prot. datë 28.12.2020 ku ka njoftuar për identifikimin e 7 subjekteve të akuakulturës të pa pajisur me leje në këtë basen ujqor;

- ZABU Vjosë shkresa 27 Prot. datë 08.01.2021 dhe shkresa nr. 531 Prot. datë 06.10.2021 ku ka njoftuar për identifikimin e 9 subjekteve të akuakulturës të pa pajisur me leje në këtë basen ujqor;

- ZABU Shkumbin-Seman ka njoftuar për identifikimin e 5 subjekteve të akuakulturës të pa pajisur me leje në këtë basen ujqor;

- ZABU Ishëm-Erzen-Mat nuk ka kryer kontrollet e duhura për identifikimin e subjekteve të akuakulturës të pa pajisur me leje në këtë basen ujqor si rezultat i mungesës së kapaciteteve/burimeve njerëzore. Lidhur me subjektet e konstatuara nga të gjitha ZABU-të rast pas rasti është njoftuar IKMT dhe ARM-të.

Referuar Regjistrin të lejeve që administron AMBU për periudhën 2018-2021 janë pajisur me leje në total 10 subjekte që përdorin burimet ujore për aktivitetin e akuakulturës të grupuara në: për përdorim të burimit ujqor sipërfaqësor të rrjedhshëm për akuakulturë 5 subjekte, për përdorim të burimit ujqor sipërfaqësor të qëndrueshëm për akuakulturë 1 subjekt dhe për përdorim të burimit ujqor nëntokësor për akuakulturë 4 subjekte.

ZABU Vjosë ka hasur në pengesa për të kryer inspektive në zonën e Pashalimanit për të verifikuar dhe monitoruar subjektet që ushtrojnë aktivitetin e akuakulturës. Lidhur me këtë ZABU i është drejtuar me shkresën nr. 74 Prot. datë 09.02.2022 Komandantin të Repartit Ushtarak të Pashalimanit për t'u pajisur me lejen përkatëse në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e aktivitetit të akuakulturës. Procesi është në vijimësi dhe po ndiqet nga strukturat përkatëse të ZABU-së Vjosë.

Ligji nr. 111/2012 datë 15.11.2012 ôPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreô, i ndryshuar neni 38, përcakton se burimet ujore përdoren ndër të tjera për qëllimet shtëpiake, komunale, bujqësore, përfshirë ujitjen dhe ujin për blegtorinë.

Në zbatim të përcaktimeve të mësipërme ligjore, grupi auditimit gjatë fazës studimore ka kryer vizita në terren në të gjitha ZABU. Gjatë vizitave në ZABU-në Drin-Bunë me seli në Shkodër, lidhur me pajisjen me leje të subjekteve që *përdorin burime ujore për ujitje* u konstatua si vijon:

1. Rezervuari i Shtodrit me kapacitet prej 11.5 mil m³ ujë, furnizohet nga lumi Kir dhe ujit një sipërfaqe prej 6500 ha tokë. Kjo vepër ujitje është nën administrim të MBZHR (Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit), dhe nuk ka leje për shfrytëzimin e ujit, nga AMBU.

2. Kanali i Ujit Vukatanë i cili administrohet nga Bashkia Shkodër. Ky kanal ujitës mbulon 700 ha tokë për ujitje. Nuk është i pajisur me leje nga AMBU për përdorim uji.

3. Kanali i Ujit Mjedë i cili administrohet nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit në MBZHR. Ky kanal ujitës mbulon 24,000 ha tokë për ujitje. Nuk është pajisur me leje nga AMBU-së për përdorim uji.

Nga të dhënat e administruara nga MBZHR janë 21 kanale kryesore ujitës të skemave ujitëse, që mbulojnë më shumë se një bashki, me gjatësi totale rreth 1100 km, që mundësojnë furnizimin me ujë të një rrjeti sekondar kanalesh ujitëse dhe 7 rezervuarë kryesorë për ujitje, me një kapacitet të projektuar ujëmbledhës rreth 140 milion m³ ujë ose rreth 25% e kapacitetit të projektuar të të gjithë rezervuarëve për ujitje që nuk janë të pajisur me leje përdorimi nga AMBU. Nga të dhënat e audituara në lidhje me kanalet ujitëse parësore që administrohen nga MBZHR, rezulton se, asnjë kanal ujitës i MBZHR-së nuk është i pajisur me leje përdorim të burimit ujqor pranë AMBU-së.

Mos pajisja e kanaleve ujitëse me leje përdorimi të burimit ujqor për ujitje pranë AMBU-së është në mos përputhje me përcaktimet e ligjit 111/2012 datë 15.11.2012 për menaxhimin e integruar të burimeve ujore dhe ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018, neni 41 për përdorimi me leje i ujitit pika 1, germa 6b, *“Veprimtaritë e mëposhtme, që mund të kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, do të ushtrohen në bazë të lejes administrative të lëshuar nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore,... b) Ujitja”*.

Foto nr. 2 Rezervuari i Shtodrit



Burimi: Grupi i auditimit, Shkurt 2022

Foto nr.3 Kanali i Shtodrit që ujit fushën e mbi Shkodrës



Burimi: Grupi i auditimit, Shkurt 2022

Burimet ujore përdoren edhe për qëllime shtëpiake dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit me ujë të popullatës duhet të pajisen me leje bazuar në përcaktimet e ligjit nr.111/2012 datë 15.11.2012 *“Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore të ndryshuar, neni 31 pika 2 “Çdo person fizik a juridik, publik apo privat, që ofron ose shet në publik ujë të pijshëm, detyrohet të jetë i pajisur me leje apo autorizimin përkatës, si dhe të përmbushë kërkesat e cilësisë së ujit të pijshëm, sipas akteve ligjore në fuqi”*. Nga auditimi i dokumentacionit të grumbulluar nga ZABU lidhur me përdorimin e burimeve ujore nga Shoqëritë e Ujësjetës Kanalizimeve rezultoi si vijon:

1. Në basenin ujqor Drin-Bunë, Shoqëritë e Ujësjetës Kanalizimeve shfrytëzojnë në total 90 burime ujore nga të cilat vetëm 16 janë me leje përdorimi dhe 74 burime ujore janë pa leje.
2. Në basenin ujqor Ishëm-Erzen-Mat, Shoqëritë e Ujësjetës Kanalizimeve shfrytëzojnë në total 85 burime ujore ku 24 burime janë me leje dhe 61 burime ujore janë pa leje.
3. Në basenin ujqor Shkumbin-Seman, Shoqëritë e Ujësjetës Kanalizimeve shfrytëzojnë në total rreth 227 burime ujore, nga të cilat vetëm 57 burime ujore janë me leje/ kontratë koncensionare shfrytëzimi ndërsa 170 burime ujore janë pa leje .
4. Në basenin ujqor Vjosë, Shoqëritë e Ujësjetës Kanalizimeve shfrytëzojnë në total 282 burime ujore nga të cilat vetëm 20 burime ujore janë me leje/kontratë koncensionare shfrytëzimi ndërsa 262 burimet e tjera ujore janë pa leje.

Si përfundim rezultoi se, në të gjithë vendin janë në total 567 burime ujore të Shoqërive të Ujësjetës Kanalizimeve pa leje përdorimi burimi ujqor nga AMBU.

Vizitat në terren

Grupi i auditimit si gjatë fazës studimore ashtu edhe në fazën e terrenit kreu disa vizita në terren për të kuptuar funksionimin dhe shfrytëzimin e burimeve ujore për qëllime, tipologji dhe aktivitete të ndryshme. Disa nga aktivitetet kryesore në të cilat grupi i auditimit u fokusua ishte sektori i akuakulturës, ujitjes, përdorimit të burimeve ujore për ujë të ambalazhuar, për qëllime industriale dhe teknologjike, blegtorale etj. Më datë 14.04.2022 grupi i auditimit vizitoi burimet termale/gjeotermale në fshatin Tragan, Elbasan. Nga sa u evidentua në këtë zonë, operonin mbi 50 subjekte të cilat përdornin burimet ujore për qëllim kurativ/termal/gjeotermal. Grupi i auditimit u shoqërua gjatë kësaj vizite nga specialistët e ZABU Shkumbin-Seman. Nga konstatimet, rezultoi se ZABU Shkumbin-Seman nuk kishte informacion të saktë se sa subjekte operonin në këtë zonë. Një tjetër sektor që u përqendrua grupi i auditimit gjatë kësaj vizite ishte edhe sektori i akuakulturës dhe konkretisht disa aktivitete të cilat ndodhen në Përrenjas.

Foto nr. 4 Përdorimi i burimeve ujore termale, Tregan, Elbasan



Burimi: Grupi i auditimit, Prill 2022

Foto nr. 5 Përdorimi i burimeve ujore në sektorin e akuakulturës, Përrenjas



Burimi: Grupi i auditimit, Prill 2022

Gjetje nga auditimi

28. AMBU, që prej miratimit të strukturës organizative në vitin 2018, nuk ka arritur asnjëherë të funksionojë me kapacitet të plotë. Në AMBU (e cila ka 83 punonjës në total përfshirë edhe ZABU) rezultoi se nga 43 punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme janë 11 pozicione vakante dhe prekin sektorë që lidhen me Burimet Ujore, Zhvillimin dhe Inovacionin. Gjithashtu, ZABU paraqiten me nivel të lartë vakancash, konkretisht: **(i)** 63% pozicione vakante në ZABU Shkumbin-Seman, p.sh. në Sektorin e Lejeve të Monitorim-Kontrollit i cili funksion me 60% të kapacitetit (zyrë kjo e cila mbulon rreth 400 përdorues të burimeve ujore, të shtrirë në një sipërfaqe prej 9801.8 km² -afërsisht 1/3 e territorit të Republikës së Shqipërisë, ku përqindja më e madhe e burimeve ndodhet në terrene të vështira malore); **(ii)** 50% vakanca në ZABU Vjosë; dhe **(iii)** 18%, në ZABU Ishëm-Erzen-Mat. Mungesa e burimeve njerëzore në ZABU dhe si pasojë edhe e ekspertizës, pamundëson mbulimin e plotë me kontrole, të burimeve që administrojnë secila zyrë. Shkak i identifikuar për vakancat e krijuara mund të jetë edhe niveli i ulët i pagave në ZABU, pasi nga njëra anë kërkohen specialistë me profil të lartë si inxhinierë, hidrolog etj., dhe nga ana tjetër niveli i pagave për këta specialistë është i ulët¹.
29. Në lidhje me kontrollin e subjekteve përdorues të burimeve ujore, rezultoi se për periudhën 2018-2020, ZABU-të kanë funksionuar pa një metodologji për hartimin e planeve vjetore të punës. Edhe pse metodologjia është miratuar nga AMBU në Dhjetor të vitit 2022, ZABU-të kanë vijuar kontrollet pa u mbështetur te kjo metodologji. Si pasojë është e paqartë se mbi çbazë bëhet përzgjedhja e subjekteve për kontroll, mbulimi i territorit, mbulimi me

- ekspertizën e nevojshme të grupeve të kontrollit, frekuenca e kontrolleve apo logjistika e nevojshme për secilin kontroll.
30. AKM nuk disponon mjete dhe pajisje për të matur dhe vlerësuar **në terren** cilësinë apo normat e ujërave të shkarkuara nga subjektet që përdorin ujin⁷⁶, me qëllim parandalimin dhe shmangien e ndotjes së mjedisve ujore pritëse nga substanca të rrezikshme që shkarkohen përmes ujërave të ndotura.
 31. AMBU, për rastet ku konstaton shkelje gjatë zhvillimit të procesit të monitorim-kontrollit duhet të njoftojë strukturat përgjegjëse si IKMT dhe ARM⁷⁷. Pavarësisht, njoftimit të AMBU-së në strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin, në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, nuk parashikohet më tej, mënyra se si rezultatet e inspektimit do të raportohen në AMBU dhe do të përdoren nga kjo e fundit.
 32. Nga verifikimi i Regjistrimit të Lejeve që administrojnë AMBU rezulton se, për periudhën 2019-2021 janë pajisur me leje për përdorimin e burimeve ujore për qëllime të ndryshme 190 subjekte. Ndërkohë, për të njëjtën periudhë, nga AKM janë raportuar në AMBU, 749 subjekte të pa pajisur me lejen përkatëse për përdorimin e burimeve ujore, ndërsa AMBU për të njëjtën periudhë ka identifikuar 244 subjekte pa leje. Kështu, për këtë periudhë, numri i subjekteve të identifikuar pa leje dhe që vazhdojnë aktivitetet në mënyrë të parregullt është afërsisht 4 herë më i lartë se numri i subjekteve të cilave iu është dhënë leje.
 33. MBZHR është autoriteti përgjegjës që jep të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës, nëpërmjet lidhjes së kontratës përkatëse me personat fizikë apo juridikë, për ushtrimin e këtij aktiviteti.⁷⁸ Nga ana tjetër, AMBU jep lejen e përdorimit të burimit ujor për zhvillimin e akuakulturës⁷⁹. Nga të dhënat zyrtare të MBZHR rezulton se, në fund të 2021, **94 subjekte** ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e akuakulturës. Referuar të dhënave zyrtare të AMBU-së për të njëjtën periudhë, rezultoi se janë pajisur me leje për përdorimin e burimeve ujore për akuakulturë, **10 subjekte**⁸⁰, nga të cilat vetëm **1 subjekt** rezulton në listën e MBZHR. Situata më sipër tregon për moskoordinim të punës mes këtyre dy institucioneve.
 34. Në zonën e Karaburunit ushtrojnë aktivitet privat një sërë subjektesh në sektorin e akuakulturës. ZABU Vjosë nuk ka mundur të kryejë kontroll të plotë për të verifikuar subjektet që operojnë në këtë zonë, pasi specialistët e ZABU-së nuk janë lejuar nga Reparti Ushtarak 2004, Pashaliman, Vlorë për të hyrë në territorin që administrohet nga ky Repart Ushtarak edhe pse në këtë territor ushtrojnë aktivitet privat një sërë subjektesh në sektorin e akuakulturës. Edhe pas kërkesës zyrtare⁸¹ së ZABU Vjosë drejtuar Repartit Ushtarak 2004, Pashaliman, Vlorë, situata paraqitet po njësoj.

Konkluzione

18. Strukturat e kontrollit dhe inspektimit të burimeve ujore prej disa vitesh operojnë më kapacitete shumë të ulëta, fakt i cili ka sjellë mos mbulimin me kontrolle të gjithë territorit.
19. Konstatohet mungesë logjistike për të vlerësuar në terren cilësinë apo normat e ujërave të shkarkuara.
20. Procesi i shkëmbimit të informacionit mes subjekteve të përfshira, lidhur me rezultatet e inspektimeve për aktivitetet e paligjshme për çështje që lidhen me burimet ujore, ka vend për përmirësim.

⁷⁶ VKM nr. 246, datë 30.4.201 óPër përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësorë dhe VKM nr. 177, datë 31.3.2005 óPër normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse.

⁷⁷ Ligji nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujore neni 95

⁷⁸ Ligj nr. 103/2016 óPër Akuakulturën, neni 15

⁷⁹ Ligji nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujore neni 41, pika 1/ë,

⁸⁰ Aneksi 1

⁸¹ Shkresa e ZABU Vjosë me nr. 74 prot. datë 09.02.2022 óKërkesë për leje kalimi dhe hyrje drejtuar Repartit Ushtarak 2004, Pashaliman, Vlorë

Rekomandime

28.1 AMBU të marrë masa të menjëhershme për të plotësuar të gjitha vakancat që ekzistojnë në organikën e saj. AMBU gjithashtu të kryejë një analizë/relacion mbi arsyet e mos plotësimit të këtyre vakancave ndër vite dhe mos të mjaftohet vetëm me kërkesa në DAP për plotësimin e këtyre vakancave. Rezultatet e këtyre relacioneve të përcillen në Kryeministri me qëllim korrigjimin e situatës duke synuar edhe rishikimin dhe përmirësimin e kushteve financiare për punonjësit e saj.

Brenda datës 31.12.2022

29.1 AMBU të marrë masa që planet vjetore të punës që përgatiten nga ZABU-të të jenë në përputhje me metodologjinë e hartuar nga AMBU duke saktësuar dhe përcaktuar numrin e kontrolleve që parashikohen për t'u kryer gjatë vitit, subjektet, shpërndarjen e stafit të ZABU etj. Planet vjetore pasi të dërgohen nga ZABU në AMBU, të marrin miratimin nga ana e kësaj të fundit.

Në vazhdimësi

30.1 AKM të marrë masa për të pajisur me mjete dhe logjistikë të nevojshme inspektorët e Drejtorisë së Kontroll Inspektimit për të matur dhe vlerësuar saktësisht cilësinë apo normat e ujërave të shkarkuara nga subjektet që përdorin ujin.

Brenda datës 31.12.2022

31-32.1 AMBU të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të rritur e përmirësuar bashkëpunimin me strukturat inspektuese me qëllim rritjen e numrit të lejeve/autorizimeve të përdorimit të burimeve ujore.

Në vazhdimësi

33.1 AMBU dhe MBZHR të marrin masa dhe të bashkëpunojnë në vazhdimësi me qëllim saktësimin e numrit të subjekteve që operojnë në sektorin e akuakulturës me qëllim nxitjen dhe formalizimin e këtyre të fundit në përputhje me kuadrin ligjor të burimeve ujore dhe akuakulturës.

Në vazhdimësi

34.1 ZABU Vjosë, së bashku me AMBU të insistojnë dhe të marrin masa duke ju drejtuar organeve kompetente, me qëllim realizimin e kontrolleve nga ana e ZABU Vjosë të subjekteve që operojnë në sektorin e akuakulturës në zonën e Karaburunit.

Brenda datës 31.12.2022

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga AMBU është paraqitur observacioni me shkresë nr. 107/9 prot. datë 08.08.2022 óMbi Projektraportin e Auditimit nga Znj. G. L, me pozicion Drejtor i Përgjithshëm i AMBU, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit: Lidhur me gjetjen nr. 28 dhe rekomandimin nr. 28.1, AMBU thekson se ajo ka në strukturën e saj 83 punonjës, nga të cilët 43 janë në Drejtorinë e Përgjithshme, 9 në ZABU Drin Bunë, 11 në ZABU Ishëm Erzen Mat, 11 në ZABU Shkumbin Seman dhe 9 në ZABU Vjosë. Vakancat përfshijnë të gjithë sektorët. AMBU kryen shpalljen e vendeve vakante nëpërmjet Departamentit të Administratës Publike, si njësi përgjegjëse për burimet njerëzore për institucionet e administratës shtetërore. Për këtë arsye kërkesat për shpalljen e vendeve vakante procesohen vetëm nëpërmjet DAP dhe nuk mund të përdoret asnjë instrument tjetër.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi është njohur me problematikën e vakancave, e cila nuk është momentale, por ekziston prej vitesh, veçanërisht në katër ZABU-të, është i mendimit që AMBU mos të mjaftohet vetëm me shpalljen e vakancave dhe dërgimin e tyre në DAP, pasi kjo gjë është bërë ndër vite dhe situata paraqitet po njësoj, por siç kemi theksuar edhe në rekomandimin përkatës, AMBU të analizojë dhe të pasqyrojë në një relacion shkaqet dhe arsyet pse çojnë në mos plotësimin e këtyre vakancave dhe t'a përcjellë ato në organet kompetente.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga AMBU është paraqitur observacioni me shkresë nr. 107/9 prot. datë 08.08.2022 óMbi Projektraportin e Auditimitó nga Znj. G.L, me pozicion Drejtor i Përgjithshëm i AMBU, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit: Lidhur me gjetjen nr. 30, konkluzionin nr 18 dhe rekomandimin nr. 30.1, të Projekt Raportit, AMBU, thekson se:

Në lidhje me rrjedhën ekologjike

Rrjedha minimale ekologjike është një parametër që vlen vetëm për trupat sipërfaqësorë të rrjedhshëm (referuar edhe përcaktimeve të ligjit nr. 111/2012 i ndryshuar). Mbështetur në përcaktimet e nenit 4 pika 46 dhe nenit 39 të ligjit 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujorë, i ndryshuar, të gjithë përdoruesit e pajisur me leje, gjatë përdorimit të burimit ujqor duhet të respektojnë kushtet e lejes në lidhje me rrjedhën ekologjike që duhet të garantojnë, dhe monitorimi i vazhdueshëm i këtij elementi ndikon drejtpërdrejtë në mirëmenaxhimin e burimit ujqor. Subjekte që përdorin me leje burimet sipërfaqësore të rrjedhshme janë rreth 500, prej të cilëve mbi 380 janë ato të cilat përdorin burime ujore sipërfaqësore të rrjedhshme për prodhim hidroenergjie (HEC), pra rreth 76%. Kjo përqindje është shumë më e lartë kundrejt subjekteve të cilët kanë detyrimin e lejimit të rrjedhës ekologjike, pasi është vlerësuar se në një pjesë të konsiderueshme të përdorimeve të tjera të ujërave sipërfaqësorë të rrjedhshëm (ndër 120 subjektet e tjerë) nuk vendoset kushti i prurjes ekologjike, për arsyen se nuk ndikohet regjimi i rrjedhës së trupit ujqor dhe nuk cënohet qëndrueshmëria e ekosistemit (përdorimet e tjera përfshijnë akuakulturën; ujitjen në bujqësi, veprimtaritë ndërtimore në brigje, shfrytëzimin e materialeve inerte, larjen e inerteve në rastet më të shumta kur kryhet pranë lumenjve të mëdhenj, apo përdorime të sasive shumë të vogla të rrjedhës së lumenjve me prurje të konsiderueshme). Thënë sa më sipër, qëllimi kryesor i AMBU-së ka qënë kontrolli i lejimit të prurjes ekologjike nga subjektet që përdorin burimet ujore sipërfaqësore të rrjedhshme për hidroenergji (HEC-et). Numri i madh i veprave të marrjeve (ku një HEC ka në shumicën e rasteve më shumë se një vepër marrje), zonat e thella ku ato janë të pozicionuara dhe nevoja për të matur këtë prurje në vazhdimësi 365 ditë të vitit 24 orë, e bën teknikisht dhe praktikisht të pamundur, që matja e kësaj prurjeje të bëhet nga AMBU, ZABU-të apo inspektoratet kompetente për kontrollin e këtyre e veprimtarive. AMBU dhe inspektoratet përkatëse e bazojnë monitorimin dhe kontrollin e tyre (në lidhje me prurjen ekologjike) në kqyrjen në terren të respektimit të zbatimit të strukturave të kalimit të prurjes ekologjike, në përputhje me ato të miratura në projektin e pajisjes me leje si dhe mbajtjen hapur të portave kur këto të fundit janë të komanduara. Por edhe ky kontroll është i pamundur që të bëhet për çdo ditë të viti për 24 orë nga këto struktura. Në këto kushte për të zgjidhur këtë situatë AMBU ka ndërmarr disa politika për detyrimin e subjekteve të vendosin e stacionet e tyre hidrologjike në çdo vepër marrje në mënyrë që duke aplikuar ekuacionin e bilancit ujqor, pra të sasisë që vjen, asaj që përdoret (i cili matet në bazë të prodhimit të energjisë) të vlerësojë sasinë e ujit që lejohet për rrjedhën ekologjike në të gjithë periudhën e viti. Ky detyrim për subjektet HEC-e, është formalizuar në VKM nr.1122, datë 30.12.2022 (për Kadastrën e burimeve ujore), për subjektet ekzistuese dhe në VKM 550/2020 ku vendosja e stacioneve është një detyrim për të gjitha subjektet e reja që kërkojnë të pajisen me leje për prodhim hidroenergjie.

Në gjykimin tonë nevojitet të rivlerësohet gjetja dhe konkluzioni në lidhje me faktin se *ZABU-të nuk kanë pajisjet dhe mjetet logjistike për të monitoruar dhe kontrolluar rrjedhën minimale ekologjike duke mos garantuar respektimin e sasisë së nevojshme të ujit për të ruajtur qëndrueshmërinë e ekosistemit natyror*, për faktin se AMBU ka formalizuar mekanizmat se si monitorohet dhe analizohet lejimi i kësaj rrjedhe.

Në lidhje me matjen e sasisë së ujit në përdorim

Matja e sasisë së ujit në përdorim, për të gjithë përdoruesit e burimeve ujore nëntokësore realizohet nëpërmjet matësve. Edhe për të gjithë përdoruesit e burimeve ujore sipërfaqësore, për të cilët faturimi realizohet mbi sasinë e ujit që përdoret, matja bëhet me matësa. Ndërkohë për përdoruesit e tjerë të burimeve ujore sipërfaqësore, për të cilët faturimi i përdorimit realizohet mbi elementë të tjerë dhe jo sasinë (volumin) e ujit të përdorur, sasia e ujit nuk matet. Por kjo, jo për mungesë të mjeteve logjistike, por për arsytet se kjo sasi përlogaritet në mënyrë alternative, ose matja është e panevojshme pasi faturimi realizohet mbi elementë të tjerë të produkteve që prodhojnë/krijojnë/mbarështojnë/ tregtojnë subjektet sipas qëllimeve të përdorimit (psh., në rastin e akuakulturës, faturimi bazohet në kg peshk). Gjithashtu, sqarojmë se matja e sasive të ujërave nuk mund të kryhet me raste (si do të mund të realizohej me mjete logjistike nga monitoruesit, psh. njëherë në muaj) por duhet të kryhet me pajisje stacionare permanente. Gjithashtu sqarojmë se detyrimi për të vendosur matës sipas ligjit 111/2012 është detyrim i subjeteve dhe ky është një element që kërkohet vazhdimisht nga AMBU. Vendosja e matësit veç përfitimit të të dhënave për AMBU, është edhe në favor të subjektit, pasi ai faturohet bazuar në konsumin faktik të ujit, pavarësisht se sasia e miratuar në leje mund të jetë më e madhe. Në rastet e mungesës së këtyre matësve AMBU e bazon faturimin në vlerësimin potencial të përdorimit maksimal të ujit, duke konsideruar se subjekti përdor 24 orë sasinë e prurjes llogaritëse të miratuar në lejen e përdorimit. Ky është një instrument shtrëngues për ti detyruar subjektet të vendosin matësat dhe mirëmbajnë ato në gjendje funksionale gjatë të gjithë kohës.

Thënë sa më lart, në gjykimin tonë nevojitet të rivlerësohet gjetja dhe rekomandimi në lidhje me faktin se *ZABU-të nuk kanë pajisjet dhe mjetet logjistike për të monitoruar dhe kontrolluar sasinë e ujit të përdorur.*

Në lidhje me vlerësimin në terren të cilësisë apo normave të ujërave të shkarkuara

Në lidhje me konkluzionin për vlerësimin në terren të cilësisë apo normat e ujërave të shkarkuara, monitorimi i cilësisë dhe sasisë së prodhimit të ujërave të përdorur industrial dhe shkarkimet bëhet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për subjektet e pajisur me leje mjedisi (VKM 742 datë 9.9.2015 óPër funksionimin dhe menaxhimin e regjistrit të shkarkimit e të transferimit të ndotësve, miratimin e listës së veprimtarive dhe të ndotësve, që janë subjekt i këtij regjistri, si dhe të formularit të deklaratimit të të dhënave për shkarkimet dhe për transferimin e ndotësve nga operatori). Megjithatë, sektori i monitorim-kontrollit në AMBU dhe ZABU, monitoron periodikisht përdoruesit e kësaj kategorie dhe rast pas rasti gjykon nëse potencialisht ujërat e shkarkuar nga subjekte të ndryshëm, mund të kenë një ndikim të konsiderueshëm negativ në trupin ujqor pritës, bazuar në aktivitetin të cilin ata ushtrojnë. Në të tilla raste, ky sektor realizon një verifikim analitik nëpërmjet sondës multiparametrike *AQUAREAD* (që prej janarit 2020). Ky instrument është një pajisje shkencore për testimin e ujit me një gamë të gjerë parametrash (temperaturë, oksigjen i tretur, konduktivitet, pH, lëndë të ngurta pezull, nitrate, amoniak, etj.) AMBU në mungesë të të dhënave nga autoritetet përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së ujërave të shkarkuar, për trupa ujqorë për të cilët dyshon se janë të rrezikuar të ndoten nga shkarkimet e subjekteve, bazuar në llojin e aktivitetit të cilit kryejnë, përdor këtë instrument. Nga ana tjetër, duhet përmendur se ky instrument nuk është një laborator, por kalibrimi frekuent dhe mirëmbajtja e elektrodave individuale në përputhje me manualin, mundësojnë që të dhënat e përftuara prej tij, të shërbejnë si një indicie për verifikimin e shkeljeve të kushteve të lejes si dhe për të analizuar trendet e cilësisë së trupave ujqorë. Në gjykimin tonë nevojitet të rivlerësohet konkluzioni në lidhje me faktin se *ZABU-të nuk kanë pajisjet dhe mjetet logjistike për të vlerësuar në terren cilësinë apo normat e ujërave të shkarkuara*, për faktin se kjo e fundit nuk është përgjegjësi e AMBU/ZABU dhe të vlerësohet që pavarësisht kësaj, AMBU dhe ZABU sipas rasteve, nëpërmjet pajisjeve që disponojnë, kanë kryer verifikimet e nevojshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit e ka marrë plotësisht në konsideratë këtë observacion duke qenë se AMBU ka ndërmarrë një nismë të re për monitorimin e rrjedhës ekologjike dhe sasinë e përdorur të ujit nga aktivitetet e hidrocentraleve të cilët kanë rëndësi të madhe duke qenë se përdorin sasi të madhe uji.

PËRMBLEDHJE

Auditimi me temë "Menaxhimi i burimeve ujore" ka si objekt kryesor vlerësimin e politikave si dhe efektivitetin e eficiencës së institucioneve përgjegjëse, duke u fokusuar kryesisht në cilësinë e ujërave sipërfaqësorë e nëntokësorë, administrimin e tyre dhe informacionet mbi to që janë njëkohësisht edhe objektivat kryesorë strategjikë. Institucionet subjekt auditimi kanë qenë AMBU, AKM dhe MBZHR. Periudha objekt auditimi ka qenë 2018-2021. Gjatë këtij auditimi, si në fazën studimore ashtu edhe në fazën e terrenit janë kryer një sërë vizitash në terren për të parë nga afër problematika të ndryshme në sektorë dhe aktivitete të ndryshme përdorues të burimeve ujore.

Nga 7 Basene ujore sot janë të miratuar vetëm Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Drin-Bunë dhe Seman. Për pesë Basenet e tjera nuk ka ende një Plan Menaxhimi të miratuar. Krahas mungesës së Rregullores së Brendshme të Funkcionimit dhe Organizimit të AMBU në të cilën duhet të jenë përshkruar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë stafit të saj, një sërë aktesh nënligjore nuk janë hartuar dhe miratuar në përputhje me Ligjin nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" i ndryshuar. Krahas mungesës së hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore, një sërë aktesh të tjera nënligjore nuk janë të përditësura dhe nuk janë në përputhje e koherencë me Ligjin nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" i ndryshuar. Këto akte lidhen veçanërisht me çështje që kanë të bëjnë me monitorimin dhe inspektimin e përdorimit të burimeve ujore. Gjithashtu, është vërejtur se Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore nuk është përditësuar në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm nga AKM, e cila asnjëherë nuk ka populluar të dhëna në këtë Kadastro por edhe nga subjekte dhe institucione të tjera që kanë të dhëna lidhur me burimet ujore. Përveç Kadastrës, u konstatua që Regjistri Kombëtar i Lejeve të Përdorimit të Burimeve Ujore nuk është i përditësuar me lejet dhe autorizimet deri në fund të vitit 2021. Regjistrat e autorizimeve dhe lejeve janë të përditësuara deri në muajin Gusht 2021.

Lidhur me fondet faktike të angazhuara për menaxhimin e burimeve ujore, rezulton se ato janë 70% më pak se ato të nevojshme (parashikuar në dokumentin strategjik SKMBIU). Mungesa e fondeve ka shkaktuar që të paktën 45% e aktiviteteve strategjike të marra në shqyrtim, të mos kenë nisur të realizohen, megjithëse afati për përbushjen e tyre ishte viti 2021, duke cënuar kështu efektivitetin e menaxhimit të burimeve ujore. Gjithashtu, mungesa e raporteve të detajuara të monitorimit të zbatimit të SKMBIU, nuk ka siguruar identifikimin dhe adresimin në kohë të problematikave të lidhura me zbatimin e SKMBIU, duke mos i dhënë kështu fokusin e duhur një prej çështjeve më të ngutshme që ka cënuar zbatimin e tyre, siç është mungesa e fondeve.

AMBU nuk ka arritur të evidentojë subjektet përdoruese të burimeve ujore pa leje përdorimi burimi ujor për lavazhe dhe të tjerë nxisë ata të pajisen me leje përdorimi burimi ujor. Të gjitha të ardhurat dytësore që krijohen nga AMBU kalojnë në buxhetin e shtetit. Në total për periudhën e auditimit AMBU ka arkëtuar 683,034,000 lekë dhe është financuar nga buxheti i shtetit në shumën 620,702,000 lekë. Edhe pse vërehet një përmirësim i arkëtimit të të ardhurave për periudhën objekt auditimi me periudhën para vitit 2018, të ardhurat e munguara si rezultat i mos pajisjes me leje të të gjitha subjekteve me leje përdorimi të ujit vazhdojnë të jenë shumë të larta, kjo për pasojë se pjesa më e madhe e subjekteve përdorues të ujit funksionojnë pa leje. Grupi i auditimit është fokusuar në disa sektorë gjatë këtij auditimi, nisur nga të dhënat që ka siguruar dhe mbi të cilat është kryer një analizë e plotë. Të ardhurat e munguara në buxhetin e shtetit vijnë si pasojë e mos arkëtimit të faturimeve si dhe mos faturimit si pasojë e mos pajisjes me leje përdorimi uji nga ana e subjekteve. Kështu, për periudhën objekt auditimi është konstatuar se rezultojnë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit si pasojë e mosarkëtimit të faturimeve në shumën **188,282,705** lekë dhe të ardhura të munguara si pasojë e mosfaturimit (rrjedhimisht edhe mosarkëtimit) si rezultat i mospajisjes me leje të subjekteve në vlerën **89,591,210** lekë. Kjo shifër është sigurisht shumë herë

më e lartë nëse do të kishim të dhëna të sakta për numrin e saktë të të gjithë subjekteve që shfrytëzojnë burime ujore dhe që operojnë pa leje përdorimi të burimeve ujore. Ndaj dhe grupi i auditimit si në këtë pyetje audituese ashtu edhe në pyetjen audituese që lidhet me procesin e inspektimit ngulmon fort në formalizimin dhe pajisjen me leje përdorimi nga ana e përdoruesve. Që të dalim në një konkluzion të saktë e të qartë lidhur me përmirësimin e situatës, duhet që së pari të ekzistojnë indikatorë të matshëm e të qartë. Lidhur me indikatorët, AMBU citon indikatorë të përgjithshëm, të cilat janë po ashtu pjesë të SKMIBU si për shembull:

- Rritja e numrit të aplikimeve,
- Rritja e kontrolleve/monitorimeve ndaj subjekteve përdorues të ujit;
- Ulje e informalitetit,
- Rritje e faturimeve/arkëtimeve;
- Hartimi i Planeve
- Ngritja, funksionimi dhe përditësimi i Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore etj.

Por në asnjë rast këta indikatorë nuk janë të matshëm sepse nuk citohet dhe nuk specifikohet qartë askund se sa duhet të jetë numri i aplikimeve për shembull, sa duhet të jetë niveli i faturimeve/arkëtimeve, sa duhet të jetë numri i kontrolleve/monitorimeve në një vit ndaj subjekteve përdorues të ujit, etj. Është e vërtetë që ka patur numër të rritur të aplikimeve dhe lejeve të dhëna, por pyetja që ngrihet është, a është i mjaftueshëm ky numër apo duhet të ishte edhe më i lartë. Në mungesë të indikatorëve të matshëm bëhet thuajse e pamundur të jepet një përgjigje e plotë ndaj pyetjes lidhur me përmirësimin e situatës.

Lidhur me procesin e monitorimit të burimeve ujore AMBU nuk është përfshirë në procesin e monitorimit që realizohet nga AKM. Kjo situatë është në mospërputhje me Ligjin nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreó neni 85 pika 6.1 ói ndryshuaró. Një nga shkaqet kryesore që ka çuar në këtë situatë është mospërputhja e VKM nr.1189, datë 18.11.2009 óPër rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisitó me Ligjin nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreó. Treguesit e përcaktuar në VKM nr.1189, datë 18.11.2009 óPër rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisitó, Aneksi I pika 4.1 germa ógô, ógjô, óhó dhe pika 4.4 óbó dhe ócô nuk monitorohen nga AKM. Gjithashtu, në monitorimin e treguesve të bërë nga AKM nuk përcaktohen dhe nuk përshkruhen qartë kriteret dhe metodologjia e përdorur për përcaktimin e stacioneve ku do të kryhet monitorimi i burimeve ujore, frekuenca dhe shpeshtësia e monitorimit. Edhe pse përgjigja zyrtare e AKM është se ajo bazohet në Raportin CEMSA (projekt i vitit 2011), ky Raport gjithashtu nuk shpjegon dhe nuk argumenton mbi kriteret apo metodologjinë e përzgjedhjes së stacioneve, frekuencën apo shpeshtësinë e monitorimit të burimeve ujore.

Struktura dhe organika e AMBU-së në nivel qendror dhe rajonal nuk është në përputhje me Urdhrin nr. 152 datë 01.10.2018 të KM óPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujoreó i ndryshuar duke qenë se janë evidentuar rreth 23 vakanca nga 82 në total që duhet të jetë numri i punonjësve në AMBU. AKM nuk disponon mjete dhe pajisje për të matur dhe vlerësuar në terren cilësinë apo normat e ujërave të shkarkuara nga subjektet që përdorin ujin. Për periudhën 2019-2021, nëse do të krahasojmë numrin e subjekteve të cilët operojnë pa leje përdorimi të burimit ujqor të evidentuara nga AKM (749 subjekte) dhe nga AMBU (244 subjekte) me numrin e lejeve të dhëna, i cili është 190, atëherë dalim në konkluzionin se veprimtaria e AKM dhe AMBU lidhur me kontrollin, nxitjen në drejtim të formalizimit të subjekteve nuk ka qenë efektive dhe efiçiente.

Nga të dhënat zyrtare të MBZHR-së rezulton se në fund të vitit 2021 rezultojnë 94 subjekte që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e akuakulturës. Të gjitha këto subjekte duhet të pajisen me leje për përdorimin e burimeve ujore nga AMBU si organi përgjegjësj për menaxhimin dhe administrimin e burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë. Referuar dokumentacionit dhe Regjistrit të Lejeve të shqyrtuar nga grupi i auditimit, për periudhën 2018-2021 rezulton se, janë pajisur me leje nga AMBU në total 10 subjekte që përdorin burimet ujore për aktivitetin e

akuakulturës. Numri i subjekteve të pa pajisura me leje nga AMBU mbetet ende shumë i lartë, veprime këto në mospërputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 111/2012. Nga ana tjetër, nga këto 10 subjekte në sektorin e akuakulturës që AMBU ka pajisur me leje për përdorimin e burimeve ujore vetëm një prej tyre rezulton në listën e MBZHR. Këto fakte dëshmojnë se nuk ka patur një koordinim efektiv midis AMBU dhe MBZHR me qëllim saktësimin e numrit të plotë të subjekteve që operojnë në sektorin e akuakulturës. MBZHR administron 21 kanale ujitëse parësore dhe 7 rezervuare kryesorë për ujitje, të cilët nuk janë të pajisura me leje përdorimi të burimit ujqor nga AMBU. Shoqëritë e Ujësjiellës Kanalizimeve në të gjithë vendin administrojnë 567 burime ujore të ujësjiellësve pa leje përdorimi burimi ujqor nga AMBU, në mos përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.111/2012 datë 15.11.2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreô i ndryshuar.

9. GRUPI I PUNËS

1. A. G, *Përgjegjësi Grupi*
2. M. K, *Anëtare*
3. E.V, *Anëtare*
4. L. Gj, *Anëtar*

ANEKS 1

Lejet e dhëna nga AMBU (2018-2021) dhe ato ekzistuese

NR. SIPAS FORMU LARIT	LEJET SIPAS LLOJIT TE PERDORIMIT	2018		2019		2020		2021	
		Leje te dhena gjate vitit	Leje te vlefshme 31.12.2018	Leje te dhena gjate vitit	Leje te vlefshme 31.12.2019	leje te dhena gjate vitit	Leje te vlefshme 31.12.2020	Leje te dhena gjate vitit	Leje te vlefshme 31.12.2021
1	miratimin në parim të dhënies me koncesion të përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor.								
17	miratimin në parim për dhënien me koncesion të përdorimit të burimi ujq nëntokësor.								
2	leje për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për ujë të pijshëm (sisteme të furnizimit me ujë të popullatës).							1	1
20	leje për përdorim burimi ujq nëntokësor për ujë të pijshëm (sisteme të furnizimit me ujë të popullatës).	3	55		55	2	57	1	58
3	leje për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për ujë të ambalazhuar.								
21	leje për përdorim burimi ujq nëntokësor për ujë të ambalazhuar.	6	39	3	42	5	47	5	49
4	leje për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për ujitje.	2	5		5		5	2	7
22	leje për përdorim burimi ujq nëntokësor për ujitje.	3	3		3	6	9		9
5\1	leje për përdorim të burimi ujq sipërfaqësor për akuakulturë (në rastin e ujërave të rrjedhshëm).	2	4		4	1	5		5
5\2	leje për përdorim të burimi ujq sipërfaqësor për akuakulturë (në rastin e ujërave të qëndrueshëm).		1		1		1		1
23	leje për përdorim burimi ujq nëntokësor për akuakulturë.		4		4		4		4

6	leje për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik.	54	313	13	326	27	353	35	388
24	leje për përdorim burimi ujq nëntokësor për prodhim hidroenergjie.								
9	leje për përdorimin e ujërave detare për prodhim energjie elektrike.								
7	leje për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për qëllime industriale dhe teknologjike.	1	32		32	4	36	3	39
25	leje për përdorim burimi ujq nëntokësor për qëllime industriale.	31	113	9	122	5	127	3	130
8	leje për përdorim burimi ujq për lundrueshmëri.								
10	leje për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për qëllime të tjera (që nuk përfshihen në formularët e tjerë).	4	4		4	1	5		5
16	autorizim për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për qëllime të tjera (që nuk përfshihen në formularët e tjerë).								
19	leje për nxjerrje dhe shfrytëzimi të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit për qëllime të ndryshme (që nuk përfshihen në formularët e tjerë).	11	36		36	10	46	6	52
11	autorizim për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për qëllime blegtorale kur shoqërohet me instalime tubacionesh dhe ndërtime objektesh.								
29	autorizim për përdorim burimi ujq nëntokësor për qëllime blegtorale kur shoqërohet me instalime tubacionesh dhe ndërtime objektesh.							1	1
12	autorizim për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për turizëm, argëtim, lundrim për argëtim.								
26	për leje për përdorim burimi ujq nëntokësor për turizëm dhe argëtim.		2		2	1	3		3
13	autorizim për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për kërkime, studime, që kanë për objekt ujin. <i>(nuk ka ekzistues si përdorim përpara vkm550)</i>								
14	autorizim për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për kërkime, studime që nuk kanë nuk kanë për objekt ujin.	""							

15	Kërkesë e institucioneve monitoruese të ujërave sipërfaqësor e nëntokësor dhe institucioneve shkencore për autorizim për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për kërkime, studime, eksplorime që ndikojnë në prishjen e ekuilibrave sasiorë dhe cilësor të ujërave.	"							
30	autorizim për përdorim burimi ujq nëntokësor për kërkime, studime, që kanë për objekt ujq.	"							
31	autorizim për përdorim burimi ujq nëntokësor për kërkime, studime që nuk kanë për objekt ujq.	"							
32	për autorizim për përdorim burimi ujq nëntokësor e institucioneve monitoruese të ujërave sipërfaqësorë e nëntokësorë dhe institucioneve shkencore për kërkime, studime, eksplorime që ndikojnë në prishjen e ekuilibrave sasiorë dhe cilësorë të ujërave.	"							
18	leje për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje ujq (pusn shpimi).	9	139	3	142	8	150	10	160
27	leje për përdorim burimit ujq kurativ, mineral, termomineral dhe gjeotermal.	5	12		12		12		12
28	autorizim për shfrytëzim ujq nëntokësor për qëllime familjare (jo ujq të pijshëm, sasi < 0.5 l/sek)								
37	leje për shfrytëzimin e materialeve inerte që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve me ose pa ujq.	4	6	5	11	5	12	1	10
33	autorizim për përdorim burimi ujq për ndërtimin, rindërtimin, apo shembjen për mbrojtjen e brigjeve, mureve, pritave e veprave të tjera në brigje.							1	1
34	autorizim për përdorim burimi ujq për veprimtari ndërtimore në brigje.	1	19	5	24	2	25	2	27
36	leje për përdorim burimi ujq për ndërtimin e strukturave ankoruese, portuale dhe ishujve artificialë në det.		4	1	5		5	2	7
39	leje/autorizim për veprimtari të tjera në brigjet dhe shtratit e burimit ujq.							1	1
35	autorizim për veprimtari mbrojtëse të përkohshme në rast emergjence.								

38	leje për rehabilitimin e trupave ujqorë. Aplikohet vetëm nga bashkitë dhe institucionet publike që e kanë si funksion në fushën e përgjegjësisë. *Kjo leje jepet vetëm në rastet kur objektivat mjedisore janë të përcaktuar për atë segment lumor në planet e menaxhimit.		5 rehab ne Shkumbin me vendim gjykate		5 rehab ne Shkumbin me vendim gjykate		5 rehab ne Shkumbin me vendim gjykate		5 rehab ne Shkumbin me vendim gjykate
40	autorizim për përdorim ose ripërdorim të ujërave të përdorura, përfshi aplikimin e tyre në tokë. <i>(nuk ka ekzistues si përdorim përpara vkm550)</i>								
41	autorizim për shkarkimin e ujërave të përdorur industrial.						1	1	
42	autorizim për shkarkimin e ujërave të ndotur.								
43	leje për ripërdorimin e ujërave të ndotur.								
44	leje/autorizim për shkarkimin e lëngjeve që mund të shkaktjnë infiltrimin ose akumulimin me kohë në ujërat sipërfaqësorë, shtretërit natyrorë ose artificialë, shtresat ujëmbajtëse ose ujërat nëntokësorë.								
45	rinovim të lejes/autorizimit. *Me këtë formular aplikohet vetëm në rastet ku kërkohet rinovim i një leje/autorizimi ekzistues, pa ndryshuar treguesit dhe parametrat e miratuar më parë. Në rast ndryshimi të këtyre parametrave subjekti duhet të bëjë kërkesë të re mbi leje/autorizim për përdorimin e burimit ujor, për veprimtarinë që kërkon të kryejë.	13				10		9	
46	transferim të lejes/autorizimit	1				4		2	
47	pezullimin e lejes/autorizimit	42 inerte		1		11		2	
48	ndryshimin e kushteve të lejes/autorizimit	2		1				2	
TOTAL									

ANEKSI II

1. A ekziston nje kuadër ligjor dhe rregullator i plotë dhe me ndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësi mes aktorëve të përfshirë?

Aktualisht, në RSH, vetëm 2 nga 7 basenet ujore (Baseni i Drinit dhe Semanit) kanë plane menaxhimi, të miratuar.

1. AMBU harton planet e menaxhimit të baseneve ujore, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të cilat zbatohen për një territor dhe periudhë të përcaktuar dhe rishikohen çdo gjashtë vjet. *Nga auditimi rezultoi se*, edhe pse kanë kaluar 10 vjet që nga hyrja në fuqi e Ligjit nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujorë ende nuk janë hartuar dhe miratuar Planet e Menaxhimit për basenet ujore Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin dhe Vjosë. Mungesa e planeve të menaxhimit të baseneve në fjalë, ndër të tjera ka lënë jashtë fokusit evidentimin dhe vlerësimin e ndikimeve të ndotjes në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore nga bujqësia, erozioni, hidrocentralet dhe mbetjet e ngurta.

ZABU nuk ka kryer, për asnjë basen ujqor, vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, dhe as analizën ekonomike të përdorimit të ujërave.

2. Zyra e Administrimit të Basenit Ujqor (ZABU) kryen për çdo basen ujqor përkatës vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, analizën ekonomike të përdorimit të ujërave, si dhe analiza pas monitorimeve të kryera nga subjektet e kontraktuara nga ministria përgjegjëse për mjedisin. Gjithashtu analizat dhe vlerësimet e përcaktuara më sipër do të kryhen pas miratimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe do të përditësohen rregullisht. Nga auditimi rezultoi se, nga të gjitha ZABU-të, nuk është kryer asnjë vlerësim i ndikimit në mjedis dhe as analiza të tjera sikundër kërkohen në përputhje me karakteristikat e baseneve respektive, duke mos siguruar kështu një bazë të shëndoshë për të zhvilluar më tej plane masash qe kanë për qëllim arritjen e objektivave mjedisore.

Shënim: Aneksi 2 është një format ndryshe i paraqitjes së gjetjeve/konkluzioneve/rekomandimeve sipas variantit të propozuar nga Institucioni Suprem i Auditimit të Norvegjisë i cili ka asistuar këtë auditim.

AMBU nuk ka përcaktuar normat e cilësisë së mjedisit, për ujërat nëntokësore, duke mos marrë asnjë masë për parandalimin e përkeqësimit të cilësisë së ujit.

Matësit automatik të përdorimit të burimeve ujor, nuk i nënshtrohen asnjë kërkesë të detyrueshme ligjore mbi elementët e sigurisë që ky aparat duhet të ketë, në mënyrë që të jap siguri mbi matjen e saktë të sasisë së ujit të përdorur.

3. Normat e cilësisë së mjedisit për ujërat përcaktohen për të gjitha ujërat, përfshirë edhe ujërat nëntokësore. Nga auditimi rezultoi se, AMBU nuk ka përcaktuar normat e cilësisë së mjedisit, për ujërat nëntokësore, por vetëm normat e cilësisë për përcaktimin e statusit kimik të ujërave nëntokësore. Ujërat nëntokësore janë burim potencial i ndotjes dhe ndikimeve të ndryshme në aktivitete si natyrore ashtu edhe njerëzore, ndaj është shumë e rëndësishme që për të patur një tablo të qartë të gjendjes së tyre fillimisht të përcaktohen normat e cilësisë së mjedisit edhe për to.

4. Për ujin e pijshëm Shoqëritë e Ujësjiellës Kanalizimeve në rregulloret e tyre të brendshme kanë përcaktuar se matësat e ujit duhet të vulosen dhe plumbosen nga specialistët e tyre. Nga auditimi rezultoi se, sa i përket burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore, nga vizitat në terren që grupi i auditimit ka zhvilluar, matësit automatik që janë gjetur në përdorim nuk plotësojnë asnjë element sigurie. I gjithë kuadri ligjor dhe rregullator lidhur me përdorimin e burimeve ujore nuk parashikon dhe nuk përcakton elementët e sigurisë që duhet të plotësojnë matësit automatik të ujit. Duke mos saktësuar elementët e sigurisë që duhet të kenë matësit automatik të ujit, risku i abuzimit me ujin rritet.

MTM dhe AMBU, ende nuk i kanë shpallur zonat në rrezik nga ndotja prej elementeve apo substancave të dëmshme, si *nitratet, fosfatet, produktet për mbrojtjen e bimëve, biocidet.*

5. Ministri përgjegjës për mjedisin, në bashkëpunim me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore harton aktet përkatëse nënligjore për shpalljen e zonave në rrezik nga ndotja prej elementeve apo substancave të dëmshme, si *nitratet, fosfatet, produktet për mbrojtjen e bimëve, biocidet* dhe i paraqet për miratim në Këshillin Kombëtar të Ujit. Nga auditimi rezultoi se nuk ka pasur asnjë bashkëpunim mes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, dhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore për marrjen e masave për shpalljen e zonave në rrezik nga ndotja prej elementeve apo substancave të dëmshme. Hartimi i akteve të mësipërme, fillimisht kërkon identifikimin e zonave në rrezik nga ndotja, i cili lidhet me rezultatet e monitorimit, përgjegjësi kjo e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Nga auditimi rezultoi se, elementët dhe/ose substancat që duhen monitoruar me qëllim identifikimin dhe shpalljen e zonave të tilla, aktualisht nuk përfshihen në programet e monitorimit të AKM (me përjashtim të nitrateve dhe fosfateve). Në mungesë të të dhënave për këto elementë, nuk është i mundur identifikimi dhe për pasojë as shpallja e këtyre zonave si të tilla.

6. Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të AMBU hartohet nga Drejtori i Përgjithshëm i saj dhe miratohet nga Kryeministri. Nga auditimi rezultoi se, kjo rregullore ende nuk është miratuar edhe pse është hartuar që në vitin 2019. Mungesa e një rregulloreje të miratuar, rrezikon të çënojë arritjen e objektivave dhe përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësi që ky institucion ka, në lidhje me menaxhimin e burimeve ujore.

Mungesa e përditësimit të VKM-së nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”, komplikon në tërësi procesin e monitorimit të burimeve ujore, duke mos ndarë qartë rolet dhe përgjegjësitë e subjekteve të përfshira në proces.

Ka mbivendosje kompetencash sa i takon inspektimit të burimeve ujore, i cili aktualisht kryhet edhe nga AKM edhe nga IKMT.

7. Në VKM nr.1189, datë 18.11.2009 óPër rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisitô përcaktohet se AKM monitoron treguesit dhe parametrat sa i përket cilësisë së burimeve ujore; ndërsa në Ligjin nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreô theksohet se ky monitorim duhet bërë nën mbikëqyrjen e AMBU-së. Nga auditimi rezultoi se, deri tani monitorimi vijon të kryhet nga AKM, pa përfshirjen e AMBU-së, kjo pasi AKM vijon të mbështete mbi një VKM të papërditësuar.

8. Përgjegjësitë funksionale të AKM, konsistojnë ndër të tjera në inspektimin dhe kontrollin tematik për respektimin e kërkesave ligjore në sektorin e ujrave. Nga ana tjetër, nga auditimi rezultoi se, prej datës 17.07.2019, në fakt është edhe IKMT (institucion varësie i Ministrisë së Brendshme) Inspektorati përkatës që mbulon inspektimin e burimeve ujore. Kryerja e të njëjtit funksion nga dy institucione të ndryshme, sjell konfuzion pasi ekziston mundësia që një subjekti të shkohet për inspektim dy herë; për të njëjtën shkelje të penalizohet 2 herë; etj. Sa më sipër implikon gjithashtu kosto financiare shtesë, pasi për të njëjtin funksion mbështeten me buxhet dy herë, dy institucione të ndryshme.

Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore nuk është populluar nga AKM me të dhënat e nevojshme mbi inventarin publik e të gjithë ujërave nëntokësore, sipërfaqësore dhe zonave të mbrojtura.

VKM nr. 177 datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse” nuk bazohet dhe nuk është i azhurnuar me Ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

9. Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore e cila është një platformë elektronike e krijuar në 2020 nuk është përditësuar në mënyrë të vazhdueshme. Të gjitha subjektet, që kanë në administrim burimet ujore, përfshirë edhe AKM duhet të popullojnë me të dhëna KKBUE. Nga auditimi rezultoi se, AKM, nuk ka populluar me të dhëna kadastrën; kjo pasi AKM nuk ka patur dhe nuk ka dijeni mbi VKM nr. 550, datë 15.07.2020. Mos përditësimi i inventarit publik (Kadastra) ku pritet të regjistrohen të gjitha të dhënat për ujërat nëntokësore, ujërat sipërfaqësore dhe zonat e mbrojtura e bën këtë platformë të papërdorshme nga autoritetet dhe institucionet publike, kombëtare e vendore, të përfshira në procesin e menaxhimit të burimeve ujore.

10. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit përgjegjës për mjedisin, miraton *normat teknike të shkarkimit në mjedis për ujin, për substancat e rrezikshme, për substancat dhe parametrat e tjerë*, në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e mjedisit, me qëllim parandalimin e përkeqësimit të cilësisë së ujit dhe mbrojtjen e mjedisit. Nga auditimi u konstatua se, këto norma ende nuk janë miratuar dhe vijohet me normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse sipas VKM nr. 177 datë 31.3.2005 (e hartuar rreth 6 vite përpara miratimit të ligjit për menaxhimin e burimeve ujore dhe atij për mjedisin).

Mos përditësimi dhe mos publikimi në kohë reale në Regjistrin Kombëtar të Autorizimeve dhe Lejeve për përdorimin e burimeve ujore nga ana e AMBU, nuk mundëson transparencën e plotë nga ana e portalit që administrohet nga AMBU lidhur me aktivitetet të cilat pajisen me autorizime dhe leje të tilla.

11. Nga verifikimi në faqen zyrtare të AMBU, u konstatua që Regjistri Kombëtar i Autorizimeve dhe Lejeve të Përdorimit të Burimeve Ujore nuk është i përditësuar me lejet dhe autorizimet deri në fund të vitit 2021 (madje deri në qershor 2022). Konkretisht, për periudhën shtator-dhjetor 2021 janë miratuar 28 Leje dhe Autorizime për përdorim të burimit ujor, të cilat nuk janë publikuar në Regjistrin Kombëtar të Lejeve.

2. A është mbështetur veprimtaria e institucioneve përgjegjëse me buxhete të mjaftueshme?

Aktivitetet e parashikuara për arritjen e objektivave strategjike për menaxhimin e ujit, nuk janë mbështetur me buxhetet e nevojshme, pasi për periudhën nën auditim janë alokuar 60% më pak fonde se ato të nevojshme referuar SKMIBU, çka përmban riskun e mos zbatimit me efektivitet të tyre.

12. Në SKMBIU u parashikuan 2,067,600,000 lekë për të përmbushur në mënyrë të plotë aktivitetet e lidhura me menaxhimin e burimeve ujore në Shqipëri. Nga auditimi rezultoi se për këto aktivitete u planifikuan në PBA, 826,628,000 lekë (ose 40% e fondeve të parashikuara në Strategji) dhe në fakt u alokuan nga MFE vetëm 645,176,000 lekë (ose 31% e fondeve të parashikuara në Strategji) dhe në fakt janë realizuar vetëm 645,176,000 lekë (ose 31% e fondeve të parashikuara në Strategji). Në kërkesat vjetore për buxhet, AMBU ka kërkuar alokimin e fondeve për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Strategji, kërkesa të cilat nuk janë miratuar nga MFE. Mungesa e fondeve përmban riskun e mos zbatimit me efektivitet të aktiviteteve të parashikuara në SKMBIU dhe në Planin e Veprimit. Në kushtet e mungesës së (i) target-ave të synuar, (ii) indikatorëve të mbështetur në analiza dhe (iii) Raporteve të miratuara të Monitorimit të Strategjisë (trajtuar në gjetjet nr. 13 dhe 14), grupi i auditimit **nuk mund të konkludojë në mënyrë të besueshme, mbi nivelin e zbatimit të Strategjisë, apo aktivitetet të cilat nuk janë realizuar për shkak të mungesës së fondeve.**

Idikatorët për matjen dhe monitorimin e aktiviteteve për cdo objektiv strategjik, janë të pamatshëm.

13. Nga auditimi u konstatua se treguesit e përgjithshëm të parashikuar në Strategji nuk ishin të matshëm.

-Krahas treguesve të përgjithshme, në SKMIBU parashikohet se duhet të përgatitet *óPasaporta e Indikatorëveó* nga AMBU, e cila shërben për të ofruar informacion të detajuar mbi treguesit, dhe duhet të shoqërojë raportin e monitorimit. Nga auditimi rezultoi se, AMBU nuk ka hartuar pasaportën e indikatorëve.

- Për periudhën nën auditimi AMBU ka përdorur indikatorë të pambështetur në analiza për të monitoruar implementimin e SKMBIU.

-Nga auditimi rezultoi se, në Strategji, nuk ishin parashikuar target-at e synuar; pra, AMBU nuk kishte përcaktuar target-et e synuar për aktivitetet e kryera prej saj, për periudhën 2018-2021.

Mungesa e treguesve të matshëm në nivel aktiviteti, si dhe mungesa e target-eve të synuar për vitet në të cilat shtrihet strategjia, nuk ofron siguri mbi aftësinë e tyre për të matur në mënyrë të drejtë progresin e arritur në drejtëm të menaxhimit të burimeve ujore. Kjo situatë nuk ofron siguri mbi realizimin e 12 aktiviteteve të raportuara si të zbatuar në masën 30-100%.

Për periudhën 2018-2021, nuk janë hartuar Raporte Vjetore të Monitorimit mbi implementimin e SKMBIU dhe Planit të parë të veprimit duke mos adresuar shkaqet që kanë cenuar zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë, siç është edhe mungesa e fondeve.

AMBU nuk ka arritur plotësisht arkëtimin e debitorëve, duke mos maksimizuar të ardhurat, të cilat mund të ishin përdorur për kryerjen e aktiviteteve që nuk janë kryer si pasojë e mungesës së fondeve (rreth 188,283 mije leke të pamblëdhur).

14. Monitorimi i vazhduar i SKMIBU është një nga aktivitetet kyç që duhet të ndërmerret me qëllim identifikimin e progresit të arritur në drejtim të qëllimeve, problematikat e hasura gjatë zbatimit të aktiviteteve dhe masat e nevojshme për tu ndërmarrë për të arritur objektivat. Në nivel institucional, strategjia monitorohet nga AMBU, e cila në fund të çdo viti harton raportin e monitorimit, ku duhet të përfshijë edhe progresin e arritur, problematikat e hasura, hapësirat për përmirësimin, etj. Nga auditimi rezultoi se, gjatë periudhës nën auditim nuk janë hartuar dhe nuk janë miratuar raportet e monitorimit të zbatimit të SKMIBU dhe Planit të parë të Veprimit të SKMIBU. Mungesa e raporteve të detajuara të monitorimit të zbatimit të SKMIBU, nuk ka siguruar identifikimin dhe adresimin në kohë të problematikave të lidhura me zbatimin e SKMIBU, duke mos i dhënë kështu fokusin e duhur një prej çështjeve më të ngutshme që ka cenuar zbatimin e tyre, siç është mungesa e fondeve.

15. Tarifat e përdorimit të ujit dhe pagesat për shpenzimet administrative mbledhen nga AMBU nëpërmjet ZABU-ve. Nga auditimi rezultoi se, AMBU nuk ka arritur të arkëtojë detyrimet e tarifave të përdorimit të ujit dhe shpenzimeve administrative për pajisjen me leje përdorim burimi ujor. Mos arkëtimi i detyrimeve ndaj AMBU ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në shumën **188,282,000 lekë**. Për periudhën 2018-2021 nuk janë arkëtuar 12,8 milionë lekë, çka dëshmon se rreth 93% e të ardhurave totale të munguara (188,282,000 lekë) i përket detyrimeve të trashëguara para vitit 2018.

AMBU nuk ka arritur të maksimizojë mbledhjen e të ardhurave të veta, nga mos faturimet, si pasojë e mos aplikimit për leje nga subjektet private dhe publike që përdorin burimet ujore (minimalisht 89,591,210 lekë të pa faturuar dhe pa arkëtuar).

16. Nga verifikimi i regjistrimit të lejeve të përdorimit të burimit ujor që administrohet nga AMBU, rezulton se asnjë nga 663 mjetet lundrues të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme Detare, nuk është i pajisur me leje përdorimi burimi ujor për lundrim.

AMBU nuk ka kryer asnjë kontroll për sa më sipër. Mos pajisja e tyre me leje përdorimi të burimit ujor, sjell **të paktën** rreth 35,139,000 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit si pasojë e mos pagesës së tarifës së pajisjes me leje në AMBU (663 mjete x 53,000 leke = 35,139,000 lekë).

17. Nga kryqëzimi i të dhënave midis AMBU dhe MBZHR rezultuan 93 subjekte që përdorin burimet ujore për akuakulturë, të pa pajisura me leje përdorimi nga AMBU. Subjektet e pa pajisura me leje përdorimi të burimit ujor nuk janë faturuar për shpenzimet administrative të pajisjes me leje, duke sjellë të ardhura të munguara nga shpenzimet administrative të regjistrimit **të paktën** rreth 2,464,000 lekë (93 subjekte x 26,500 tarifa e aplikimit për leje). Si pasojë, subjektet e pa pajisura me leje në AMBU as nuk janë faturuar për prodhimin dhe shitjen e peshkut, duke sjellë

të tjera të ardhura të munguara në vlerën 30,200,210 lekë (30,200,210 kg x 1 lekë) për tarifën e përdorimit të ujit. Në total, të ardhurat të munguara në buxhetin e shtetit përllëgariten **minimalisht** në shumën 32,664,710 lekë.

18. Në të gjithë Shqipërinë rezultojnë 567 burime ujore që përdoren për ujë të pijshëm nga Ujësjiellësit, të papajisura me leje përdorimi nga AMBU. Si të tilla, ato nuk janë faturuar për shpenzimet administrative të aplikimit për leje përdorim burimi ujor, duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhet në shumën **15,025,500 lekë** (567 burime x 26,500 lekë/aplikim për burim).

19. Nga vizitat e kryera në terren u konstatua që në fshatin Tregan, Elbasan rezultojnë minimalisht 50 subjekte të papajisura me leje përdorimi burimi ujor të

ujërave termale/gjeotermale në AMBU, duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhet si pasojë e mosfaturimit për shpenzimet administrative të pajisjes me leje, në shumën **5,250,000 lekë** (50 subjekte x 105,000 tarifa e aplikimit për leje).

20. AMBU nuk mban asnjë të dhënë mbi numrin e burimeve ujore që shfrytëzohen për qëllim turizmi/argëtimi (psh në rastin e pishinave), si pasojë të ardhurat e munguara nga mosaplikimi për pajisjen me leje për këto burime, nuk mund të llogariten (tarifa për aplikim për leje është 53,000 lekë/burim).

21. AMBU nuk ka informacion të saktë mbi numrin e burimeve ujore që shfrytëzohen për qëllim lavazhe. Si pasojë të ardhurat e munguara nga mos aplikimi për pajisjen me leje për këto burime, nuk mund të përllogariten. (tarifat për pajisjen me leje për një lavazh është **28,000 lekë**).

22. Nga informacioni i dhënë nga ZABU Vjosë, në territorin e basenit në administrimin e saj, ekzistojnë rreth 54 subjekte që ushtrojnë aktivitetet për lavazhe pa leje përdorimi burimi ujqor. Si pasojë e mos pajisjes së këtyre lavazheve me leje përdorim burimi ujqor, referuar VKM nr. 1014, datë 16.12.2020 *óPër miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative për kërkesat për përdorimin, shkarkimin e ujqit dhe ndërtimin e objekteve e veprave ujqore*” pika 7, rezultojnë **1,512,000 lekë** (54 x 28,000) të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit nga tarifa e pajisjes me leje përdorimi të burimit ujqor. Këtu nuk është përllogaritur tarifa e përdorimit të ujqit pasi në mungesë të lejes së përdorimit nuk ka të dhëna për sasinë e ujqit të përdorur.

23. MBZHR administron 21 kanale ujqitëse parësore dhe 7 rezervuare kryesorë për ujqitje, të cilët nuk janë të pajisura me leje përdorimi të burimit ujqor nga AMBU. Si pasojë e mos pajisjes së këtyre burimeve ujqore me leje përdorimi rezultojnë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit nga tarifa e pajisjes me leje përdorimi të burimit ujqor.

3. A kanë garantuar institucionet përgjegjëse mbikëqyrje të plotë ndaj përdoruesve të burimeve ujore?

Ka munguar bashkëpunimi mes AKM dhe AMBU, dhe degëve rajonale të tyre, duke lënë jashtë fokusit të monitorimeve, shqyrtimin e parametrave dhe treguesve të rëndësishëm për matjen e cilësisë dhe nivelit të ndotjes së burimeve ujore.

24. AMBU në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet e mjedisit duhet të hartojë programin e monitorimit lidhur me burimet ujore. Nga auditimi rezultoi se, AMBU nuk është përfshirë në asnjë monitorim të kryer nga AKM. Mos përfshirja e AMBU ka sjell mungesën e monitorimeve të një sërë parametrash dhe treguesish si si produktet për mbrojtjen e bimëve dhe biocidet, të cilat më pas shërbejnë për hartimin dhe përpilimin e Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore. Shkakët kryesore të cilat kanë çuar në këtë situatë është mos përputhja VKM nr.1189, datë 18.11.2009 me Ligjin nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujore

25. AKM duhet të kryejë monitorimin e treguesve të gjendjes dhe trysnisë që ushtrohet në mjedis nga burimet e ndotjes, në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. *Nga auditimi rezultoi se,* AKM nuk ka kryer asnjë monitorim të parametrave të kërkuar si niveli i fondit radioaktiv natyror dhe radioaktiviteti i ujërave, qëndrueshmëria e shtretërve të lumenjve, treguesit bakterialë, përmbajtjen e pesticideve si dhe përmbajtjes së komponimeve hidrokarburike, duke mos dhënë siguri mbi nivelin e ndikimit të tyre në cilësinë e burimeve ujore dhe shëndetin e njeriut.

26. Ka munguar bashkëpunimi mes ARM-ve dhe ZABU-ve për përgatitjen e programeve për parandalimin dhe shmangien e ndotjes së burimeve ujore pritëse nën juridiksionin e tyre, nga shkarkimet e lëngëta. Nga ana e tyre nuk janë marrë masa duke rritur kështu riskun që burimet ujore pritëse të jenë të një cilësie jo të mirë duke u prirur drejt ndotjes.

Si pasojë e mungesës së një metodologjie të përzgjedhjes së stacioneve, për monitorimin e burimit ujor, nuk japim dot siguri mbi besueshmërinë e të dhënave për cilësinë e ujit.

Strukturat e kontrollit dhe inspektimit të burimeve ujore prej disa vitesh operojnë më kapacitete shumë të ulëta, duke mos arritur të mbulojnë me kontrolle të gjithë territorin.

27. Nga auditimi rezultoi se AKM nuk ka parashikuar kriteret dhe metodologjinë që përdor, për përcaktimin e stacioneve ku do të kryhet monitorimi i secilit burim ujor (psh një lumë ose një liqen), si dhe frekuencën/shpeshtësinë e monitorimit, pasi ky proces vijon të mbështetet mbi Projektin CEMSA (projekt i vitit 2011), ku dhe ky i fundit nuk e ofron një informacion të tillë. Sa më sipër, ky proces nuk jep siguri nëse stacionet e përzgjedhura, janë përfaqësuese për cilësinë e ujit të burimit që po monitorohet.

28. AMBU, që prej miratimit të strukturës në vitin 2018, nuk ka arritur asnjëherë të funksionojë me kapacitet të plotë. Në AMBU (e cila ka 83 punonjës në total përfshirë edhe ZABU) rezultoi se nga 43 punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme janë 11 pozicione vakante dhe prekin sektorë që lidhen me Burimet Ujore, Zhvillimin dhe Inovacionin. Gjithashtu ZABU paraqiten me nivel të lartë vakancash, konkretisht: **(i)** 63% pozicione vakante në ZABU Shkumbin-Seman, p.sh. në Sektorin e Lejeve të Monitorim-Kontrollit i cili funksion me 60% të kapacitetit (zyrë kjo e cila mbulon rreth 400 përdorues të burimeve ujore, të shtrirë në një sipërfaqe prej 9801.8 km² -afërsisht 1/3 e territorit të Republikës së Shqipërisë, ku përqindja më e madhe e burimeve ndodhet në terrene të vështira malore); **(ii)** 50% vakanca në ZABU Vjosë; dhe **(iii)** 18%, në ZABU Ishëm-Erzen-Mat. Mungesa e burimeve njerëzore në ZABU dhe si pasojë edhe e ekspertizës, pamundëson mbulimin e plotë me kontrolle, të burimeve që administron secila zyrë. Shkak i identifikuar për vaknacat e krijuara mund të jetë edhe niveli i ulët i pagave në ZABU, pasi nga njëra anë kërkohen specialistë me profil të lartë si inxhinierë, hidrolog etj., dhe nga

ana tjetër niveli i pagave për këta specialistë është i ulët.

29. Në lidhje me kontrollin e subjekteve përdorues të burimeve ujore, rezultoi se për periudhën 2018-2020, ZABU-të kanë funksionuar pa një metodologji për hartimin e planeve vjetore të punës. Edhe pse metodologjia është miratuar nga AMBU në Dhjetor, 2022, ZABU-të kanë vijuar kontrollet pa u mbështetur te kjo metodologji. Si pasojë është e paqartë se mbi çbazë bëhet përzgjedhja e subjekteve për kontroll, mbulimi i territorit, mbulimi me ekspertizën e nevojshme të grupeve të kontrollit, frekuenca e kontrolleve apo logjistika e nevojshme për secilin kontroll.

Konstatohet mungesë logjistike për të vlerësuar në terren cilësinë apo normat e ujërave të shkarkuara.

30. AKM nuk disponon mjete dhe pajisje për të matur dhe vlerësuar **në terren** cilësinë apo normat e ujërave të shkarkuara nga subjektet që përdorin ujin, me qëllim parandalimin dhe shmangien e ndotjes së mjedisve ujore pritëse nga substanca të rrezikshme që shkarkohen përmes ujërave të ndotura.

Procesi i shkëmbimit të informacionit mes subjekteve të përfshira, lidhur me rezultatet e inspektimeve për aktivitetet e paligjshme për çështje që lidhen me burimet ujore, ka vend për përmirësim.

31. AMBU, për rastet ku konstaton shkelje gjatë zhvillimit të procesit të monitorim-kontrollit duhet të njoftojë strukturat përgjegjëse si IKMT dhe ARM. Pavarësisht, njoftimit të AMBU-së në strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin, në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, nuk parashikohet më tej, mënyra se si rezultatet e inspektimit do të raportohen në AMBU dhe do të përdoren nga kjo e fundit.

32. Nga verifikimi i Regjistrisë të Lejeve që administron AMBU rezulton se, për periudhën 2019-2021 janë pajisur me leje për përdorimin e burimeve ujore për qëllime të ndryshme 190 subjekte. Ndërkohë, për të njëjtën periudhë, nga AKM janë raportuar në AMBU, 749 subjekte të papajisur me lejen përkatëse për përdorimin e burimeve ujore, ndërsa AMBU për të njëjtën periudhë ka identifikuar 244 subjekte pa leje Kështu, për këtë periudhë, numri i subjekteve të identifikuar pa leje dhe që vazhdojnë

në mënyrë të parregullt është afërsisht 4 herë më i lartë se numri i subjekteve të cilave iu është dhënë leje.

33. MBZHR është autoriteti përgjegjës që jep të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës, nëpërmjet lidhjes së kontratës përkatëse me personat fizikë apo juridikë, për ushtrimin e këtij aktiviteti. Nga ana tjetër, AMBU jep lejen e përdorimit të burimit ujor për zhvillimin e akuakulturës. Nga të dhënat zyrtare të MBZHR rezulton se, në fund të 2021, **94 subjekte** ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e akuakulturës. Referuar të dhënave zyrtare të AMBU-së për të njëjtën periudhë, rezultoi se janë pajisur me leje për përdorimin e burimeve ujore për akuakulturë, **10 subjekte**, nga të cilat vetëm **1 subjekt** rezulton në listën e MBZHR. Situata më sipër tregon për moskoordinim të punës mes këtyre dy institucioneve.

35. Në zonën e Karaburunit ushtrojnë aktivitet privat një sërë subjektesh në sektorin e akuakulturës. ZABU Vjosë nuk ka mundur të kryejë kontroll të plotë për të verifikuar subjektet që operojnë në këtë zonë, pasi specialistët e ZABU-së nuk janë lejuar nga Reparti Ushtarak 2004, Pashaliman, Vlorë për të hyrë në territorin që administrohet nga ky Repart Ushtarak edhe pse në këtë territor ushtrojnë aktivitet privat një sërë subjektesh në sektorin e akuakulturës. Edhe pas kërkesës zyrtare së ZABU Vjosë drejtuar Repartit Ushtarak 2004, Pashaliman, Vlorë, situata paraqitet po njësoj.

REKOMANDIME

1. A ekziston nje kuadër ligjor dhe rregullator i plotë dhe me ndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësi mes aktorëve të përfshirë.

- 1.2 AMBU të marrë masa për të hartuar Planet e Menaxhimit për basenet ujore Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin dhe Vjosë në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore me qëllim menaxhimin e integruar të burimeve ujore që ndodhen në territorin e këtyre baseneve.

Në vijimësi

- 2.2 AMBU të marrë masa që nëpërmjet ZABU-ve të kryejë vlerësimin e ndikimit njerëzor në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe analizat ekonomike për përdorimin e ujërave, duke vendosur afate konkrete, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe eficiencë të burimeve ujore.

Në vijimësi

- 3.2 AMBU të përcaktojë normat e cilësisë së mjedisit për ujërat nëntokësore me qëllim parandalimin e përkeqësimit të cilësisë së ujërave nëntokësore duke patur në konsideratë përveç karakterit kimik ashtu dhe atë biologjik (baktereologjik).

Brenda datës 31.03.2023

- 4.1 AMBU të iniciojë rishikimin e kuadrit ligjor/rregullator me qëllim përcaktimin e saktë të elementëve të sigurisë që duhet të plotësojnë matësit automatik (sahatet) të përdorimit të burimeve ujore, me qëllim shmangien e abuzimit me përdorimin e tyre.

Brenda datës 31.12.2022

- 5.1 AMBU në bashkëpunim me AKM, të marrë masa për përfshirjen në programet e monitorimit të burimeve ujore, të matjes dhe vlerësimit të elementëve apo substancave të dëmshme, produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe biocideve. Pas rezultateve nga monitorimi, AMBU të hartojë aktet përkatëse nënligjore për shpalljen e zonave në rrezik nga ndotja prej elementeve apo substancave të dëmshme, si nitratet, fosfatet, produktet për mbrojtjen e bimëve, biocidet.

Brenda datës 31.12.2022 dhe në vijimësi

- 6.1 AMBU të ndjekë me prioritet dhe të drejtohet përsëri zyrtarisht Kryeministrit me qëllim miratimin e Draft Rregullores së Brendshme të funksionimit.

Brenda datës 30.10.2022

- 7.2 AKM në cilësinë e institucionit kryesor që duhet të hartojë dhe zbatojë Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit të bashkëpunojë me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe të iniciojnë përditësimin e VKM nr.1189, datë 18.11.2009 óPër rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit në mënyrë që ajo të jetë në përputhje Ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 óPër mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjin nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

Brenda datës 30.12.2022

- 8.1 AKM të marrë masa që të iniciojë ndryshime ligjore për të qartësuar dhe saktësuar rolin e saj në funksion të procesit të inspektimit me qëllim që të mos ketë përplasje kompetencash dhe funksionesh me IKMT.

Brenda datës 31.12.2022

- 9.1 AKM si një ndër institucionet kryesore që kanë të dhëna lidhur me burimet ujore të marrë masa për të populluar dhe përditësuar vazhdimisht me këto të dhëna, Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore.

Brenda datës 30.11.2022

- 10.2 AKM të drejtohet zyrtarisht Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me qëllim që kjo e fundit të marrë masa për të hartuar dhe përditësuar VKM nr. 177 datë 31.3.2005 óPër normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse, në përputhje me nenin 29 të Ligjit nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujore i ndryshuar.

Brenda datës 30.10.2022

- 11.1 AMBU të marrë masa që të përditësojë Regjistrin Kombëtar të Lejeve/Autorizimeve për të gjitha lejet/autorizimet e dhëna në periudhën shtator-dhjetor 2021, por edhe të tjera në vazhdimësi, në mënyrë që të sigurohet një transparencë në kohë reale lidhur me përdoruesit e burimeve ujore me autorizime/leje.

Brenda datës 30.10.2022 dhe në vazhdimësi

2. A është mbështetur veprimtaria e institucioneve përgjegjëse me buxhete të mjaftueshme?

- 12.1 MBU në cilësinë e monitoruesit të SKMBIU, të kryej analizimin në mënyrë të detajuar të aktiviteteve të parashikuara në Strategji, me qëllim për të konkluduar:

- mbi faktorët që kanë ndikuar negativisht në zbatimin brenda afateve të aktiviteteve. Në përfundim të analizës AMBU, duhet të konkludojë në mënyrë eksplicite mbi përqindjen e mos realizimit të Strategjisë, si rezultat i mungesës së fondeve;
- mbi aktivitetet të cilat mund të kryejnë prej institucioneve zbatuese pa nevojën e fondeve shtesë, dhe aktivitetet për të cilat është e nevojshme mbështetje buxhetore shtesë. Në rast se, rezultojnë diferenca krahasuar me kostimin e bërë në Planin e Parë të Veprimit, ato të reflektohen në Planin e ardhshëm të Veprimit, me qëllim për të siguruar një pamje sa më të drejtë të fondeve të nevojshme gjatë zbatimit të tij, çka do të ndihmonte edhe procesin e planifikimit të fondeve buxhetore.

Brenda 3 mujorit të parë të 2023

- 13.1 AMBU të hartojë Pasaportën e Indikatorëve, në të cilën duhet të përfshihen indikatorë të matshëm, si dhe *target*-et e pritshëm për vitet në të cilat do të shtrihet Plani i ardhshëm i Veprimit. Monitorimi i SKMBIU dhe Planit të Veprimit (PV) të bëhet mbështetur në Pasaportën e Indikatorëve dhe target-eve të synuar, për të siguruar rezultate të besueshme në drejtim të arritjes së objektivave të synuar.

Brenda datës 31.12.2022

- 14.1 AMBU të hartojë raportet vjetore të monitorimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Me miratimin e raporteve vjetore të zbatimit të SKMBIU nga K.K.U, AMBU të publikojë ato në faqen *web* të saj, me qëllim për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien.

Brenda datës 31.03.2023 dhe në vijimësi

- 15.1 AMBU të marrë masa për ndjekjen në rrugë ligjore të debitorëve, me qëllim arkëtimin e detyrimeve të pa paguara për të maksimizuar të ardhurat dytësore dhe bërë të mundur përdorimin e tyre për zhvillimin e aktiviteteve të domosdoshme në përputhje me objektivat strategjike të institucionit.

Brenda datës 30.06.2023 dhe në vijimësi

- 16.1 AMBU të marrë masa për identifikimin dhe verifikimin në kohë të të gjithë subjekteve që përdorin burimet ujore pa leje, për qëllime lundrimi, akuakulturë, ujësjellësit, ujëra termal/gjeotermalë, për argëtim/turizëm; lavazhe, etj, dhe referimin e tyre në inspektoratin përkatës për aplikimin e penaliteteve në rast se konstatohen shkelje. Në vijim, AMBU të procedojë për formalizimin e subjekteve që rezultojnë pa leje përdorimi të burimit ujore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Brenda datës 30.03.2023 dhe në vijimësi

3. A kanë garantuar institucionet përgjegjëse mbikëqyrje të plotë ndaj përdoruesve të burimeve ujore?

- 24.1 AKM dhe AMBU të bashkëpunojnë dhe të koordinohen midis tyre gjatë procesit të ardhshëm të monitorimit të burimeve ujore me qëllim përthithjen e të dhënave të nevojshme nga ana e AMBU e cila do të përdorë për hartimin e Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore dhe më gjerë.

Në vazhdimësi

25.1 Deri në përditësimin e VKM nr. 1189 datë 18.11.2009, AKM të marrë masa dhe të monitorojë vlerën e fonit radioaktiv natyror dhe radioaktivitetin e ujërave, qëndrueshmërisë së shtretërve të lumenjve, treguesve bakterialë, përmbajtjen e pesticideve si dhe përmbajtjes së komponimeve hidrokarburike.

Në vazhdimësi

26.1 ZABU-të në bashkëpunim me AKM (ARM-të) të marrin masa për të përgatitur programet për parandalimin dhe shmangien e ndotjes së burimeve ujore pritëse nën juridiksionin e tyre, me qëllim përmirësimin e cilësisë së burimeve ujore në juridiksionin e tyre.

Në vazhdimësi

27.1 AKM në bashkëpunim me AMBU, gjatë hartimit të programeve të ardhshme të monitorimit të burimeve ujore të përcaktojë saktë dhe qartë përzgjedhjen e pikave të stacioneve të monitorimit, numrit të tyre që janë të domosdoshëm për të dhëna të sakta e të besueshme, frekuencën dhe shpeshësinë e tyre.

Në vazhdimësi

28.2 AMBU të marrë masa të menjëhershme për të plotësuar të gjitha vakancat që ekzistojnë në organikën e saj. AMBU gjithashtu të kryejë një analizë/relacion mbi arsyet e mos plotësimit të këtyre vakancave ndër vite dhe mos të mjaftohet vetëm me kërkesa në DAP për plotësimin e këtyre vakancave. Rezultatet e këtyre relacioneve të përcillen në Kryeministri me qëllim korrigjimin e situatës duke synuar edhe rishikimin dhe përmirësimin e kushteve financiare për punonjësit e saj.

Brenda datës 31.12.2022

29.1 AMBU të marrë masa që planet vjetore të punës që përgatiten nga ZABU-të të jenë në përputhje me metodologjinë e hartuar nga AMBU duke saktësuar dhe përcaktuar numrin e kontrolleve që parashikohen për t'u kryer gjatë vitit, subjektet, shpërndarjen e stafit të ZABU etj. Planet vjetore pasi të dërgohen nga ZABU në AMBU, të marrin miratimin nga ana e kësaj të fundit.

Menjëherë

30.1 AKM të marrë masa për të pajisur me mjete dhe logjistikë të nevojshme inspektorët e Drejtorisë së Kontroll Inspektimit për të matur dhe vlerësuar saktësisht cilësinë apo normat e ujërave të shkarkuara nga subjektet që përdorin ujin.

Brenda datës 31.12.2022

31-32.1 AMBU të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të rritur e përmirësuar bashkëpunimin me strukturat inspektuese me qëllim rritjen e numrit të lejeve/autorizimeve të përdorimit të burimeve ujore.

Në vazhdimësi

33.1 AMBU së bashku me MBZHR të marrin masa dhe të bashkëpunojnë në vazhdimësi me qëllim saktësimin e numrit të subjekteve që operojnë në sektorin e akuakulturës me qëllim nxitjen dhe formalizimin e këtyre të fundit në përputhje me kuadrin ligjor të burimeve ujore dhe akuakulturës.

Në vazhdimësi

34.1 ZABU Vjosë, së bashku me AMBU të insistojnë dhe të marrin masa duke ju drejtuar organeve kompetente, me qëllim realizimin e kontrolleve nga ana e ZABU Vjosë të subjekteve që operojnë në sektorin e akuakulturës në zonën e Karaburunit.

Brenda datës 31.12.2022